Misin Braha

MISIONI I DJALLIT
(Misteri i një "kirurgu" sllavo-australian)

Redaktor: Besim R Cengu

Recensentë: Jonuz Hallaçi
Berat Batiu

Punoi në kompjuter: Edlira Braha

Ballina: Besnik Hallaçi

Shtëpia Botuese: Kristalina - KH

Tiranë 2013

Misin Braha

MISIONI I DJALLIT
(Misteri i një "kirurgu" sllavo-australian)

Tiranë 2013

Prolog

Në ditët e para të prillit 2012, një mik i mirë i Kukësit ishte takuar me disa shokë të Kosovës në Prizren ku kishin diskutuar për një libër që ishte përkthyer e botuar nga enti botues "*Koha*" në Prishtinë. Ai libër ishte shkruar nga Craig Juriseviç me titullin: "*Duart e përgjakura, kirurgu në luftë*". Ishte shkruar nga autori bazuar në kujtimet e tij nga koha e eksodit të shqiptarëve të Kosovës në vitin 1999 dhe është botuar në shkurtin e vitit 2010. Autori thotë se ka qenë në atë kohë (28 Prill-12 Qershor '99) në Kukës me detyrën e mjekut kirurg dhe se kishte ardhur nga Adelajde (Australi) në ndihmë të luftës së Kosovës.

Që në fillim Craig Juriseviç (faqe 6) shkruan se "*Rrëfimi i këtij libri është faktik*" dhe se "*me shumë përkujdesje janë verifikuar emrat, datat dhe detajet gjatë gjithë librit, por me që mbështetet mbi kujtesën, ndonjë gabim i paqëllimtë do të ketë ndodhur*". Më tej shkruan se "*Ndonjëherë, emrat e vërtetë janë zëvendësuar me të tjerë, për t'i mbrojtur njerëzit që mund të pësojnë hakmarrje*", ndërsa më tej vazhdon se "*Sjellja dhe të folurit e secilit person në këtë libër janë të sakta, pavarësisht se sa me kujdes janë kamufluar*".

E pak më poshtë fraza: "*Botuesi nuk merr asnjë përgjegjësi ose barrë juridike për pasaktësitë…, megjithatë u falënderohemi të gjithë atyre që mund të plotësojnë librin me informata shtesë*".

Pasi e lexuam librin nga faqja e parë deri tek ajo e fundit kemi vërejtje serioze dhe kundërshti të forta, sepse kur shkruhet se "*rrëfimi i këtij libri është faktik atëherë argumentet e vetëm duhet të jenë faktet e të vërtetat, jo fantazitë, shpifjet, gënjeshtrat dhe të pavërtetat*".

Ky është motivi kryesor që më shtyu të marr vendimin të hulumtoj, të dokumentoj dhe të shkruaj e gjej

fakte, bazuar në të dhënat dokumentare të pakundërshtueshme të arkivit të spitalit të Kukësit, të dëshmive të punonjësve të këtij institucioni human që kanë punuar e kanë shërbyer në atë kohë tejet të vështirë sidomos në pikën kulmore prej periudhës 27 mars deri më 12 qershor 1999. Kam mbledhur dokumente dhe të dhëna nga institucione të ndryshme të Kukësit si nga pushteti vendor, nga organet e policisë dhe të prokurorisë, kam shfrytëzuar filmimet dhe fotografimet e mediave të shumta që kanë qenë në Kukës për atë periudhë dhe kam marrë shumë dëshmi nga shqiptarët e ardhur nga Kosova, nga të sëmurë e të plagosur që kanë qenë të shtruar në spital, nga familjarë dhe të afërm të tyre. Jam takuar mbas shumë vitesh me prindër fëmijësh që janë shtruar e janë mjekuar në spitalin e qytetit të Kukësit në periudhën 27 mars deri më 12 qershor 1999.

Pothuajse për më shumë se një vit jam marrë me verifikimin dhe saktësimin e çdo ngjarje, çdo veprimtarie dhe të çdo fakti për të qenë i saktë dhe i vërtetë, i sigurt në kundërshtimin tonë kundrejt gënjeshtarit Juriseviç dhe ngjarjeve e trillimeve që ka shkruar në librin e tij.

Sa i përket entit botues "*Koha*" mendojmë se ka thënë një të vërtetë që na ndihmon edhe ne, kur shkruan se "*Botuesi nuk merr asnjë përgjegjësi ose barrë juridike për pasaktësitë*" duke i vërejtur ato pasaktësi realisht. E për ne ato pasaktësi fillojnë që në faqen e parë deri tek faqja e fundit e librit.

Mendojmë se do të ishte më e drejtë që "*Koha*" t'u falënderohet jo vetëm atyre që mund ta plotësojnë librin me informata shtesë, por sidomos atyre që me fakte, më të vërteta dhe vetëm të vërteta ta hedhin poshtë me neveri librin e Juriseviçit. Libër i cili është bazuar jo vetëm në pasaktësitë, por çka është më irrituese e revoltuese është mbështetur vetëm në ngjarje që kurrë nuk kanë ndodhur.

I – Hyrje

Historia e popullit shqiptar është mijëravjeçare dhe e mbushur me luftëra kundër pushtuesve që kanë synuar territoret tona e kanë lakmuar pozitën e volitshme në gadishullin ballkanik. Populli shqiptar ka luftuar gjithnjë brenda kufijve të tij dhe asnjëherë nuk ka sulmuar e pushtuar vende dhe popuj të tjerë. Luftën e popullit shqiptar për çlirimin e bashkimin e të gjitha trojeve etnike shqiptare në një shtet të vetëm shqiptar e kemi amanet të përhershëm të brezave dhe mbetet objektivi themelor për çdo shqiptar kudo ku jeton e punon në të katër anët e globit. E në këtë luftë, kombi shqiptar historikisht ka pasur dhe ka ndihmën dhe përkrahjen e vendeve të botës demokratike.

Kështu ndodhi edhe në vitin 1999, kur fashizmi modern serb dhe kryefashisti Millosheviç bëri gjenocid dhe spastrim etnik në Kosovë duke shpërngulur me forcë, me vrasje, përdhunime, e me shkatërrim rreth një milion shqiptarë etnikë të Kosovës, shumica e të cilëve u deportuan dhunshëm në kufirin e dhunshëm shqiptaro-shqiptar dhe u strehuan në Republikën e Shqipërisë.

Kombi shqiptar po kalonte çaste tejet të vështira të ekzistencës së tij në sytë e gjithë botës në mes të Evropës së fundshekullit të XX. Serbomëdhenjtë menduan se kishte ardhë dita e çasti vendimtar që Kosovën ta kishin të tyren pa shqiptarët! Por shtetet demokratike të botës kuptuan gjithçka. U bindën se kush është djalli e kush është engjëlli, ndaj popujt e tyre u radhitën në krah të popullit shqiptar. U pa qartë si drita e diellit se popullit shqiptar po i shkelej çdo e drejtë, po i vriteshin burrat, gratë, pleqtë e fëmijët, duke rrezikuar shfarosjen e tij në trojet e veta etnike dhe sigurisht që këtë nuk e pranon askush.

U ngrit në këmbë gjithë bota, në radhë të parë SHBA, aleati ynë historik, shtetet e fuqishme më demokratike të

Evropës si Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe pjesa dërmuese e vendeve të BE duke aktivizuar në luftë kundër ushtrisë së Serbisë NATO, Aleancën më të fuqishme ushtarake të kohërave. Më në fund e drejta është me popullin shqiptar.

Kukësi në vitin 1999

Kombi shqiptar u ndodh përballë katastrofës humanitare si pasojë e numrit të jashtëzakonshëm e të ardhurve nga Kosova të dëbuar dhunshëm prej shtëpive e trojeve të tyre kryesisht në Kukës dhe më thellë në qytetet e tjera të Shqipërisë për një periudhë tejet të shkurtër kohore.

Organizatat Ndërkombëtare si OKB-ja, UNHCR-ja, OBSH-ja, KRYQI I KUQ, shoqatat humanitare nga të katër anët e botës, ekipe mjekësore nga shumë shtete me pajisje dhe aparatura moderne, me medikamente e me materiale mjekimi dhanë një ndihmë të madhe në përballimin e gjendjes së krijuar nga të ardhurit e deportuar me dhunë në Kukës. Qeveri dhe organizma të ndryshme ndërkombëtare, shoqata te shumta, shumë shpejt ndërtuan kampe të shumta

për të ardhurit në Kukës duke siguruar për to edhe sasi të nevojshme ushqimesh dhe sigurimin e disa shërbimeve jetike për to. Të gjithë këto veprime konkrete humanitare të koordinuara me mjaft efikasitet bënë të shmanget një katastrofë humanitare dhe të tejkalohet kriza më e rëndë njerëzore pas Luftës së Dytë Botërore.

Populli i Kukësit u bë shpresa e madhe e të ardhurve, ndërsa Morini u bë porta e shpresës së për të gjithë shqiptarët e gjendur në pragun e katastrofës. Të gjithë familjet kuksiane strehuan në shtëpitë e tyre vëllezërit shqiptarë të Kosovës dhe në ditët e para të krizës i ushqyen me rezervat e tyre ushqimore duke ndarë çdo gjë me ta.

Në këtë qytet i cili u bë i famshëm në atë kohë u vendosën selitë e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare. U vendosën me qindra gazetarë, reporterë e fotografë të mediave më të rëndësishme botërore si BBC-ja, CNN-i, ABC-ja, NBC-ja, media televizive prestigjioze nga Franca, Italia, Gjermania, Suedia, Belgjika, Zvicra, Austria, Amerika Veriore, Amerika Jugore, Azia...e gjithë bota!

Ekipet mjekësore në kampet e strehimit të të ardhurve si dhe disa spitale fushore të ngritura në Kukës dhanë një ndihmë të madhe në përballimin e situatës së ngarkuar shëndetësore, sidomos në gjysmën e dytë të muajit prill të vitit 1999 e në vazhdim deri në përfundimin e luftës në Kosovë dhe kthimin e shqiptarëve në trojet e tyre etnike.

II – Spitali i Kukësit – shtëpia humane e shqiptarëve

Është realitet dhe e vërtetë e pamohueshme se barrën kryesore të shërbimit shëndetësor në periudhën e eksodit masiv të shqiptarëve në vitin 1999 e ka mbajtur spitali rajonal "*Meriman Braha*" Kukës në planin e ndihmës shëndetësore. Ky institucion tepër i rëndësishëm ka kryer me nder, sukses e profesionalizëm të plotë detyrën duke zgjidhur

situata tejet të komplikuara e duke përballuar ngarkesa të jashtëzakonshme. Gjithë kjo punë e jashtëzakonshme falë përkushtimit e gatishmërisë së mjekëve, infermiereve, punonjësve të tjerë shëndetësore dhe stafit drejtues të spitalit.

Prej datës 27 mars deri më 12 qershor 1999 rezulton se në spitalin dhe polikliniken e qytetit të Kukësit kanë kërkuar ndihmë mjekësore 147.244 persona, prej të cilëve 2.950 janë shtruar në spital ndërsa të tjerët janë trajtuar ambulatorisht me mjekime të ndryshme. Në spitalin e Krumës janë trajtuar me ndihmë mjekësore 14.859 persona. Në shtëpinë e lindjes në Kukës kanë kërkuar ndihmë mjekësore 3.850 gra e janë shtruar 465 prej tyre. Kanë lindur 351 fëmijë kosovarë. Nga të shtruarit në spital të Kukësit 270 vetë i janë nënshtruar operacionit. Këto të dhëna flasin për mbingarkesën e spitalit të Kukësit. Bazuar në këto shifra të dokumentuara një në çdo tre të ardhur në Kukës ka kërkuar ndihmë mjekësore dhe e ka përfituar atë. Çdo ditë në Kukës (shtëpi të lindjes) kanë lindur mesatarisht tetë foshnje, nga dy-tri lindje që kanë qenë jashtë krizës së eksodit të vitit 1999.

Tejet i jashtëzakonshëm për rolin e spitalit të Kukësit është fakti i aplikimit të një sasie shumë të madhe gjaku në ndihmë të sëmurëve të shtruar në atë periudhë. Është siguruar sasia e mjaftueshme e gjakut dhe janë aplikuar konkretisht 199 njësi gjaku për të gjitha rastet kur e ka kërkuar gjendja e të sëmurëve. Vetëm duke ditur se kjo sasi gjaku (199 njësi) është aplikuar nga data 29 mars deri më 31 maj (kur dhe ka qenë e nevojshme), pra për 64 ditë kur për vitin paraardhës (1998), dmth, për 365 ditë janë aplikuar 253 njësi gjithsej. Me një llogari të thjeshtë rezulton se në kohën e eksodit në spital janë aplikuar tri njësi gjaku në ditë, ndërsa një vit më parë rezulton 0.7 njësi gjaku në ditë. Për të bërë të mundur dhe për të siguruar sasinë e duhur të gjakut kanë punuar me kujdes e përkushtim Kadire Brasha e Raze Zhubi.

Ato janë kujdesur jo vetëm për ta siguruar atë, por edhe për ta ruajtur në kushte teknike të një niveli të lartë. Me urdhër të qeverisë shqiptare të kohës erdhi në spitalin e Kukësit nga Qendra Kombëtare e Gjakut e Tiranës një sasi prej 51 njësi që i shtohet sasisë prej 60 njësi që u sigurua në Kukës.

Në mirënjohje të thellë e me respekt të veçantë do të përmendim emrin e mjekut shqiptar të Kosovës, dr. Baki Hajdarit, i cili ka qëndruar në çdo kohë në spitalin e Kukësit dhe ka punuar me përkushtim në sigurimin e sasive të konsiderueshme të gjakut, gjithsej 88 njësi gjaku. Kështu u dha kontribut i veçantë në trajtimin mjekësor të ushtarëve të UÇK në radhë të parë e gjithë të sëmurëve që kanë pasur nevojë për gjak.

Të gjithë punonjësit e spitalit të Kukësit, nga 27 marsi deri më 12 qershor kanë qenë "banorë të përhershëm" të tij çdo ditë duke nderuar veten, familjet e tyre dhe popullin e Kukësit të cilit i përkasin. E në realizimin me sukses të detyrës kanë dhënë ndihmë edhe mjaft faktorë nga gjithë bota demokratike. Në këtë kohë të rëndë sociale spikatin shoqatat e specialistët që nga të katër anët e botës erdhën në Kukës për ndihmë dhe që populli i Kukësit i nderon me gjithë zemër për punën e palodhur. Ata janë shumë, por ne po i përmendim vetëm disa prej tyre si dr. Uillin, mjeku amerikan që dha një kontribut duke ndihmuar si kirurg në sallën e operacionit të spitalit kolegët e tij kuksianë, dr. Dukagjinin, shqiptaro-amerikani që si anestezist-reanimator, gjithnjë ishte i gatshëm dhe i palodhur në sallën e operacionit. Nuk do t'i harrojmë kurrë dy mjeket pediatre angleze që punuan në pavijonin e pediatrisë së bashku me ne duke dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e shërbimit për fëmijët e sëmurë. Ne mjekët e pediatrisë dhe gjithë punonjësit nuk do t'i harrojmë Terezën e Lenën që erdhën nga Anglia e punuan me ne në Kukës me përkushtim e me cilësi profesionale.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE
V E N D I M
Nr. 10 date 22.01.2001.

Per dhenien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkise Kukes Z. Williard NOES

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme pasi shqyrtoi relacionin dhe projekt vendimin te paraqitur nga keshilltaret mbi dhenien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkise Kukes Z. *Williard NOES*, mbeshtetur ne ligjin nr. 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32,pika "m".

V E N D O S E:

I. T'i jepet titullin "Qytetar Nderi" i Bashkise Kukes Z. Williard NOES me motivacionin "Per kontributin e madh qe dha ne sektorin e shendetesise gjate menaxhimit te krizes Kosovare ne periudhen Prill-Qershor 1999"

II. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Keshillit Bashkise

III. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

PER KESHILLIN E BASHKISE
K R Y E T A R I
Astrit HAZIRI

Williard NOES, qytetar nderi i Kukësit

Sinqerisht kërkojmë falje për ndonjë emër të nderuar e të respektuar që nuk na kujtohet sot, por të jenë të sigurt se gëzojnë nderimin dhe respektin e çdo kuksiani, të çdo punonjësi të spitalit të Kukësit, të çdo të sëmuri apo familjari për kontributin e tyre human.

III – Misteri i një ardhje të beftë

Dhe tani "*kujtojmë*" edhe Craig Juriseviçin, që vendosi me 27 Prill 1999 të largohet nga Adelajde e Australisë dhe të vijë në Kukës për të ndihmuar si kirurg në krizën e Luftës së Kosovës. Megjithëse me vonesë e mori vendimin (një muaj më vonë se të tjerët) për të ardhur në Shqipëri dhe në Kukës. Ne, në atë kohë e kemi mirëpritur dhe e kemi respektuar për sakrificën e tij. Juriseviçi si "*specializant i kirurgjisë kardio-torokale të spitalit*

Mbretëror të Adelajdes" me karrierën dhe me përvojën mjekësore të mëparshme duke qenë prezent në luftëra dhe në konflikte ushtarake rajonale, sidomos në Gaza, mes dilemash dhe kundërshtish më në fund vendosi të vijë në Shqipëri ku ishte transportuar situata e rëndë sociale dhe në Kosovë ku luftohej. Megjithëse kishte shumë arsye që të mos vinte, sepse po bënte një jetë të rehatshme dhe të qetë: sapo ishte martuar për herë të dytë (katër muaj më parë) dhe Dona (shoqja II) donte ta kishte gjithnjë pranë: djali 5 vjeçar Xheksoni kishte nevojë për babanë, prandaj siç thotë vetë Juriseviçi "t'i thosha jo Kosovës" ishte e vështirë! Me sa shkruan Jureseviçi ne kuptojmë se do të ishte më e vështirë t'i thojë "*PO*" Kosovës dhe t'i lije gjithë ato të mira se sa t'i thojë "*JO*" dhe të vije në luftë. Këtë dilemë të vështirë pak më poshtë mundohet ta sqarojë kur thotë se "*Kjo mbase tingëllon si diçka perverse*", por gjithsesi e vendosi të vijë në Kosovë. A thua ka një shkak më të fortë, një faktor më të rëndësishëm, apo një mision... enigmatik. Juriseviçi kundër çdo realiteti e plani jetësor të tij që synon ta realizojë!? Do ta shohim në vijimësi se ç'thotë në librin e tij me kujtime.

Në fakt sapo ta lexosh librin nxjerr menjëherë konkluzionin e drejtë se autori flet shumë pak për veten, sidomos për origjinën dhe jetën e tij, aq pak sa vetëm në faqen 14 (të botimit shqip) shkarazi dhe pa u vënë shumë re shkruan: "*Gjyshi im, slloven nga ana e nënës, kishte mbijetuar...*" Duket mjaft e çuditshme kur njeriu e bazon origjinën e tij vetëm në nënën e gjyshit të tij pa përmendur babanë e gjyshit. Por nejse Juriseviçi e di vetë se si duhet të identifikohet apo çfarë origjine ka.

Qysh në fillim (f.15), duke u munduar t'i japë rëndësi vetes me qëllim që të vihet sadokudo në qendër të vëmendjes së lexuesit, shfaq, edhe mendime specifike kur shkruan se "*çdo komunitet e ka hisen (pjesën) e vet të hajnave, banditëve, narkomanëve e njerëzve që nuk zbatojnë rregullat*

e shoqërisë e shtetit, ashtu siç ka dhe shumë njerëz me vullnet sinqerisht të mirë"!? E pak më poshtë shkruan se "*unë e kam një respekt të posaçëm shpirtëror për drejtësinë*" pa harruar të deklarojë qartë: "*Nuk dua t'i luftoj serbët, por dua t'i ndaj disa muaj të jetës sime për të shëruar një pjesë të dëmit që e kanë shkaktuar ata*".

Duke harruar me dashje apo pa dashje, se drejtësia, (që Juriseviçi e respekton posaçërisht) duhet të veprojë dhe vepron në radhë të parë mbi ato që e shkaktojnë dëmin. Në rastin konkret vrasjen, djegien, plagosjen, gjenocidin dhe spastrimin etnik që u bëhet shqiptarëve të Kosovës, siç dhe ka vepruar Gjyqi Ndërkombëtar në Hagë ndaj kriminelëve serbë. Juriseviçi siç e shkruan vetë: "*Nuk do t'i luftojë*!" Po pse, Juriseviçi nuk do të luftojë serbët!? Këtë ne nuk e dimë, ashtu siç edhe nuk e dimë qëllimin e ardhjes se tij në Kukës.

Kontributi i tij për të shëruar një pjesë të dëmit që e kanë shkaktuar ata (serbët-M.B.) ndaj shqiptarëve nuk është as më shumë e as më pak se një vrimë në ujë krahasuar me gjenocidin, spastrimin etnik, vrasjet, përdhunimet, shfarosjen e një populli nga trojet e tij nga serbët kriminelë.

IV - Misioni i turpit

Qysh në momentin e parë sa zbret në tokën shqiptare, kuptohet se Juriseviçi s'ka ardhur si "*vullnetar*" i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, as si mjek kirurg "humanitar". Sipas të gjitha gjasave, ai ka marrë përsipër apo ia kanë ngarkuar mbi supe një mision që nuk ka asnjë lidhje me humanizmin e vërtetë dhe as me profesionin e nderuar dhe të respektuar të mjekut. Ka marrë përsipër misionin e djallit.

Me të zbritur në aeroportin e Tiranës (aeroport ndërkombëtar, që atë periudhë ishte vënë në dispozicion të NATO-s nga ana e qeverisë së Shqipërisë) dukej njeri specifik, disi i veçantë dhe si i tillë shikonte me një sy krejt

tjetër këtë vend ku erdhi. Si duket ishte i "*përgatitur*" të shihte vetëm ato që e kishin urdhëruar të shihte. Kirurgu australian nuk e pa diellin që po i verbonte sytë, nuk vërejti njerëzit e vërtetë, nuk e shikoi mjedisin real, ashtu si ishte, (edhe me të metat, por gjithsesi edhe me të mirat), por vërejti një aeroport (që vetë e emërtoi aeroport) e që sipas tij nuk ishte i tillë. Kjo ardhje e kësaj natyre tek po lexoja me vëmendje librin me kujtime të Juriseviçit më kujton mbërritjen e gjeneralit të ushtrisë së vdekur të Ismail Kadaresë në po këtë aeroport rreth gjysmë shekulli më parë, por në rrethana krejt të tjera. Kirurgu ynë kishte po ato ndjesi, po atë antipati për tokën që shkeli, për njerëzit, për drurët, për ndërtesat…Një lloj si gjenerali i famshëm edhe ky "*kirurg*" enigmatik prej Adelajdes së Australisë! Çudi, çfarë ngjashmërie!! Madje edhe koha ato ditë kur zbarkoi ishte me shi njëlloj si te Gjenerali i Kadaresë. Dhe dihet se ditët e rënda plumb me shi e re të ulëta që të kufizojnë shikimin ku nuk ta çojnë mendjen, ku nuk ta fluturojnë atë se janë të bezdisshme, të lodhshme e të gjata. Si është e mundur që në një aeroport ndërkombëtar, (që ishte vënë në dispozicion të NATO-s dhe që edhe menaxhohej nga NATO-ja) Juriseviçi sheh "*qen endacakë*", sheh "*pula të plakura*" sheh "*mace të holla*"... Interesant, na çuditi krejt!

Pse nuk mundi të shohë ndonjë njeri normal ky njeri i huaj!? A mos vallë avioni që e zbriti në Tiranë kishte brenda tij vetëm "*njeriun*" Juriseviç!? Një "*humanist*" si Juriseviçi po i dhimbsej shumë qeni endacak, të vetmin që e takoi sapo vuri këmbët në tokë, sepse vetëm ai (qeni endacak) e "*priti miqësisht*" duke u marrë erë këpucëve të tij. Ku i dihet, ndoshta Juriseviçi kishte të drejtë të çuditej sepse kishte menduar krejt ndryshe. Askush nuk e priti në aeroport kundër parashikimit të vet. Ka menduar se me lule do ta presin mijëra vetë. Do të mbulohej me brohoritje dhe me thirrje eksituese të njerëzve që e prisnin me padurim: "*Po*

vjen shpëtimtari"! "*Tani ta shikojnë serbët*"! He mendje, mendje! Nuk thotë populli shqiptar kot se budallai e ka kokën si njeriu! Edhe Juriseviçi kokën si ne e kishte, por andrallat i kishte krejt të tjera…

Por sidoqoftë, në atë mjedis nuk i shpëtoi asgjë, përcaktoi me saktësi sasinë dhe cilësinë e njerëzve. Përcaktoi atmosferën e aeroportit me hollësi dhe po me saktësi doli në përfundimin se raporti i atyre njerëzve që ndodheshin aty në atë çast ishte tre me një në favor të gazetarëve! Madje ai psikologjisi çdo gjë me kujdesin e përkushtimin më të madh në detajet më të imta. E si njeri tejet i vëmendshëm, pas pak kohe vëren një fenomen të veçantë kur shkruan se "*Kushdo duket si refugjat ose duket se është nisur në linjë të frontit – mercenarë të përgatitur për të luftuar kundër serbëve*"(!) Çfarë intuite e lindur! Çfarë parashikimi gjenial e përfundimi ekzakt! Një gjë nuk po kuptonte mjeku kirurg: në fakt ai po vepronte në kundërshtim të plotë me natyrën e misionin e mjekut. Vetëm një mjek nuk mund të mendojë, të shprehet e të konkludojë si "*mjeku*" Juriseviç.

Lexuesi i vëmendshëm i librit qysh në fillim e kupton se Juriseviçi e ka një mision të posaçëm. Ka një detyrë me shumë rëndësi e peshë, një objektiv serioz e të rëndë krejt tjetër, jashtë profesionit të nderuar të mjekut. Abuzimi i vazhdueshëm me bluzën e bardhë të profesionit të nderuar në funksion të realizimit të misionit të tij misterioz do të ndeshet hap pas hapi, ditë pas dite e çast pas çasti, deri sa ai të largohet nga Kukësi dhe nga Shqipëria. Për këtë kishte ardhur e s'kish se si të ndodhte ndryshe. Kristalizimi i këtij përfundimi del krejt qartë kur mbyll faqen e fundit të librit.

Juriseviçi që kur shkeli në tokën shqiptare e tradhëton veten kur shkruan se "*qeni i merr erë*" sepse, siç duket edhe vetë qeni e kuptoi se ato këpucë të mira të tij kishin brenda tyre këmbët e një njeriu që fsheh diçka. Në fakt, gjatë shfletimit të kujdesshëm të librit me kujtime kupton

menjëherë se në ato këpucë ishin fshehur këmbët e gjarprit, këmbët e një njeriu të djallëzuar e konspirativ që kishte ardhur me një mision krejt të kundërt me atë që kishte deklaruar publikisht.

E thotë vetë se ”*askush nuk ka dalë të më presë*” dhe se “*pos qenit të shëmtuar duket se askujt tjetër nuk i interesoi*”. Në fakt Juriseviçi nuk duhej të çuditej pasi toka shqiptare dhe populli shqiptar në historinë e tij shumëshekullore ka pritur miq e armiq, ka përcjellë miq e armiq dhe është mësuar t'i dallojë mirë miqtë dhe armiqtë. Jeta e vështirë deri në kufijtë e mbijetesës këtë popull e ka pajisur me zgjuarsinë për të njohur njerëzit. S'është faji i tokës shqiptare që dallon menjëherë cilindo që shkelë mbi të, që fsheh diçka, që vjen me mision të mirë apo të keq! Përkundrazi, historia e ka mësuar popullin shqiptar dhe vendin e tij të shqiponjave që ta bëjë dallimin e vlerësimin dhe mikun ta presë me nderime e me respekt, ndërsa armikun me përbuzje kur vjen si “*mik*” dhe me luftë kur vjen si armik e si pushtues.

Rrugës për në Tiranë nga aeroporti i Rinasit, syri i vëmendshëm i Juriseviçit regjistron çdo gjë që i intereson për misionin e tij, nuk i shpëton asgjë. Regjistron në trurin e tij çdo pjesë të natyrës shqiptare, çdo rrugë, çdo shtëpi, çdo rrugicë, çdo poq të thyer, çdo bunker, çdo “*palë sy që kthehet për të na shikuar derisa kalojmë*” (sikur sytë e shqiptarëve e kishin pritur Juriseviçin me padurim). Ai bën krahasimin e rrugëve që sheh me rrugët e Evropës: me Boulevardin Saint Germain, me Via Veneto, me Regent Street…për të “evidentuar më qartë” mjedisin shqiptar aq sa ta urreje.

Duket se s'ka emocione sepse me siguri njeh çdo gjë për Shqipërinë dhe shkruan se “*ajo që m'i ngjallë emocionet më së shumti janë vuajtjet e refugjatëve kosovarë*”, sepse në një vend si ky epitafi do te ishte :“*Vdiq duke pritur*”.

Të zbresësh në tokën shqiptare, në një tokë që kurrë më parë nuk e ka shkelur dhe të shprehësh një dëshirë ogurzezë, një dëshirë kriminale, para së gjithash nuk mund të jetë sjellje e një njeriu normal. Kjo nuk është as në moralin e një njeriu që e deklaron veten mjek. Nga ana tjetër është dëshirë e njeriut me shpirt të zi e zemërkazëm që ngjan më shumë me djallin që jo vetëm duhet ta ketë parë përpara por dhe e mban të fshehtë, e për më tepër është i ngarkuar me urrejtje që nuk e dimë se nga ku i buron.

Del pak lakuriq kur shprehet në libër se "*përpiqem t'i eliminoj përshtypjet dhe observimet negative që nuk më ndihmojnë dhe nuk i bëjnë mirë "MISIONIT*". A thua cilit mision!? Misionit human, apo një misioni tjetër!? Vetëm djalli sheh një ngjyrë; të errëtën, të zezën! Zoti ka krijuar shtatë ngjyra kryesore dhe shumë ngjyra të ndërmjetme për ta zbukuruar tokën, detin e ajrin duke e bërë natyrën të jetë e bukur, e hijshme dhe tërheqëse në shërbim të njerëzve.

Juriseviçi duket shumë i disiplinuar në realizimin e misionit të tij misterioz, sepse në çdo moment, situatë e mjedis lidhet vetëm me komponentë negativë. Megjithëse e kupton se i bën dëm misionit, ai objektiv dhe qëllim ka vetëm misionin që i kanë ngarkuar, misionin e djallit.

Edhe më tej Juriseviçi e përshkruan Tiranën vetëm zi, me rrugët e errësuara, veturat e vjetra, motoçikletat (njëlloj sikur e përshkruan gjenerali i Kadaresë rrugëtimin nëpër shi në Tiranë rrugës për në hotel "*Dajti*") dhe "*një golf i përplasur ikte me shpejtësi sepse një njeri me armë po shtinte kundër tij tri metra larg*". Por këto përshkrime imagjinare të Juriseviçit ngjajnë disi me trazirat e marsit të viti 1997 (s'dimë se kush ia ka mësuar ato histori të kaluara dy vite më parë), por nuk ngjajnë aspak me prillin e vitit 1999. Pikërisht kur populli shqiptar, kishte plot një muaj që ndodhej para një rreziku kombëtar, e, historikisht shqiptarët para një rreziku të përbashkët janë bashkuar gjithnjë, kanë

falur gjaqet, kanë falur mosmarrëveshjet dhe ngatërresat. Në këtë mot të lig të historisë, shqiptarët e kanë lidhur besën për bashkim e për fitore. Fundi i shekullit të XX po jua shpërblen më në fund gjakun e derdhur për liri e sovranitet. Një qind vjet po priste lirinë, e nuk kishte se si të ndodhte ndryshe…

Juriseviçi mendjen e ka diku tjetër; të afrohet në vijën e frontit me Serbinë dhe të vendoset në Kukës në verilindje të Shqipërisë. Atje ia kërkon misioni i tij misterioz. Ngul këmbë fort në përshkrimin e datës 28 prill 1999 duke huazuar ditët e trishta të muajit mars të vitit 1997 (!) kur shkruan se "*njerëzit nuk udhëtojnë rrugëve nëpër Shqipërinë rurale*". Dhe më tej "banditët janë pronarë të fshatit dhe gjithë ato që kanë ardhur në Shqipëri për ndihmë - mjekët, punëtorët humanitarë, vozitësit, ekipe administrative keqtrajtohen ose vriten për para". Shihet açik se kemi të bëjmë me një mendje haluçinante, me një mendje të sëmurë që ngatërron vitet, datat, njerëzit…Shkenca e mjekësisë njeh raste sëmundjeje mendore të kësaj natyre.

Kuptohet se sa i informuar është Juriseviçi për gjendjen e Shqipërisë për vitin 1997. Mund të ketë lexuar para se të vijë në Shqipëri, copëza historish për ne… Por që nuk i ka të qarta. Ai në fakt shkruan për datën 28 prill 1999, kur bëhet fjalë tamam për ditën e parë të tij në Shqipëri dhe është absolutisht e çuditshme pse i transferon ngjarjet dy vjet më vonë se ato kanë ndodhur realisht!? Çudi!! Nuk mund të rrijë pa shkruar edhe se "*Krimi i organizuar është industria e vetme në rritje në Shqipëri*", të cilën ia thotë Juriseviçit një zyrtar i IMC-s! Pallavra! Duket se Juriseviçi ka marrë mbi supe një barrë të rëndë dhe mundohet ta mbajë me doemos. Sidoqoftë do të ishte tejet e rëndë për një mjek (!) që vjen jo nga Evropa, jo nga rajoni, por nga Australia që ndodhet jo vetëm në hemisferën jugore të globit, por edhe në skajin më të largët nga Shqipëria. Vjen nga prapa diellit si i thonë. Për

ne duket e qartë: Juriseviçi është më shumë se një mjek, ose edhe më saktë, vetëm një mjek nuk është.

Me siguri Juriseviçi është trajnuar para se të zbriste në aeroportin e Tiranës, pasi nuk ka si shpjegohet ndryshe. S'kishte si ta dinte ai, s'kishte si ta zbulonte ai që sapo kishte shkelur tokën tonë se "*qeveria s'bën pesë para punë, shumica e posteve të qeverisë lokale dhe qendrore janë pronë private e banditëve me lidhje të ndyra*" duke konkurruar me dinjitet e profesionalizëm edhe shërbimet inteligjente më të fuqishme"! Na e merr mendja se këto të dhëna e "*fakte*" për Shqipërinë, Juriseviçi i ka pasur në xhep dhe ka zbritur bashkë me to. Ato i duheshin për të realizuar misionin e tij të djallit. Besonte se i duheshin për të bindur "*opinionin se në Shqipëri s'ka shtet, s'ka qeveri, s'ka ligj, s'ka institucione, por ka vetëm krim, banda, dhunë, vrasje, kanibalizëm...*"

Çfarë shkruan në libër e zeza mbi të bardhë, planet i ka bërë mirë se "*faktet*" ja kanë mësuar mirë. Do t'i duhen që pas dhjetë vjetësh t'i paraqesë para opinionit si të vërteta dhe kështu të mund të bëhet i besueshëm në përpjekjen e tij për të vërtetuar tezën e djallit se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"(!) "*Faktet*" dhe "*dëshmitë*" janë mbledhur me kujdes e me djallëzi nga disa shqipfolës që mban rrotull vetes. Deklaratat e tyre sipas tij do të vërtetojnë përpjekjet maksimale të Juriseviçit për të realizuar objektivin e tij kriminal se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*!".

Por fatmirësisht në atë kohë në Shqipëri nuk ishte vetëm "*doktori sllavo-australian*" Juriseviç. Për hir të së vërtetës ishte e gjithë bota, njerëzit që kishin pësuar fatkeqësinë, populli shqiptar që i priti me aq dashuri e humanizëm. Ishte prezentë vazhdimisht dhe intensivisht e gjithë media botërore. Nuk harrohen fjalët e presidentit çek Vaslav Havel, i cili i frymëzuar prej solidaritetit të shqiptarëve në përballim të ngjarjeve dramatike të asaj kohe

thoshte kumbueshëm për ta dëgjuar i gjithë planeti: "*edhe unë sot ndjehem shqiptar*". Mbi të gjitha në Shqipëri ishte dhe është Zoti i Madh! Sa i madh qëndron njerëzori Havel përballë liliputit Juriseviç, i cili ëndërron se me këtë libër do të njihet edhe në industrinë e filmit në Holliwud! Shpejt "*harron*" se sapo u fut në Kukës ishte në merak se ku strehoheshin dhe ku ushqeheshin gjithë ata gazetarë e reporterë që ishin në Kukës dhe nuk i "*sheh*" ato kur do të nxijë e të errësojë Kukësin dhe popullin e Kukësit.

"*Kirurgu i famshëm*" në librin e tij bën edhe gabime që ngjajnë me lajthitjet. Kur niset nga Tirana për në Kukës me dorën e tij shkruan se "*pesë vetë hipim në helikopterin që do të na çojë në Kukës - tre zyrtare të UNHCR-s dhe nja dy shqiptarë të përfshirë në punë refugjatësh që nuk po i bie në fije*". Duke harruar veten e vet (të gjashtin e helikopterit), kjo "*histori*" e Juriseviçit ngjan plotësisht me përrallën e vjetër ruse të pesë Pjetrave: gjatë numërimit, secili prej tyre harronte të numëronte veten e tij!

Sa më shumë faqe që lexon në këtë libër-paçavure, aq më shumë bindesh në qëllimet e këtij shqiptarofobi me mendje të çoroditur. Helikopteri ulet në afërsi të kampit "*Italia 1*" dhe Juriseviçi thotë se aty strehohen 40 mijë refugjatë kosovarë. Mendjen e ka diku tjetër (!) kur shkruan se "*kufiri është nja dhjetë kilometra në lindje - pre e lehtë për artilerinë e rëndë serbe dhe predhat serbe. Edhe pse jemi ende në Shqipëri, asnjeri me të cilin flas nuk dyshon se serbët do të mund të bombardonin kampin po qe se do ta shihnin të dobishme për punë strategjie*". Si gjithnjë, "*harron*" apo i pëlqen të harrojë se Shqipëria është këtu ku është dhe këtu ka qenë e do të jetë përjetësisht. A thua se në të vërtetë Juriseviçi mendon se kishte vetëm artileri të rëndë serbe e nuk kishte artileri të rëndë e makineri luftarake në Shqipëri!?

Sapo futet në Kukës e përshkruan atë realisht kur thotë se "*rrugët, shtigjet, bulevardet, sheshet dhe çdo pëllëmbë tokë ishte plot njerëz, çadra, automjete, plot të rritur, fëmijë, të rinj e të reja, me një zhurmë të jashtëzakonshme nga automjetet e shumta në lëvizje e me pluhur kudo*". Dhe menjëherë e nxjerr përfundimin që do: "*nuk ka evidencë të mjaftueshme të pashpresës dhe traumës psikologjike, por jam i sigurt se kjo është e pashmangshme*". Se ku e dinte ky njeri i porsaardhur në qytetin që ishte shndërruar në konakun e shqiptarëve të dëbuar dhunshëm se nuk paska evidencë një zot e di. Pastaj na u prish gjiza ne shqiptarëve, se Juriseviçi dëshiron pashpresën në vend të shpresës. Aspak. Shqiptarët tanimë e dinin rrugën e tyre drejt lirisë e prosperitetit.

Jam i sigurt se Juriseviçi nuk e di, ose nuk do të dijë se shqiptarët janë kombi i Skënderbeut që ka mbrojtur jo vetëm shpresën dhe jetën e kombit të vet, por edhe shpresën e jetën e kombeve të Evropës duke luftuar me heroizëm kundër hordhive osmane. Duhet ta dijë Juriseviçi se shqiptarët janë kombi i Nënë Terezës që është simboli i shpresës për mbarë njerëzimin. Nuk ka se si të mos e dijë, përderisa ai interesohet edhe për gjëra të imta edhe të parëndësishme.

Në ditët e vështira dhe rrethanat delikate, pikërisht kur Kosova po korrte frytet e përpjekjeve më shumë se njëqind vjeçare shqiptarët kanë aleatë të fuqishëm. Kanë SHBA-t, BE-n, NATO-n. Autori i librit e di mirë këtë. Bile shprehet në libër duke e parandjerë fitoren e shqiptarëve dhe humbjen e sigurt të serbëve. Por ka një "merak të vogël" se shqiptarët pas fitores "*do të formulojnë strategji për t'u hakmarrë kundër serbëve*". Sipas tij "*shqiptarët me padurim presin ditën, kur me çizmet e tyre do t'ua shkelnin fytin armiqve të tyre*"(!) Kushdo që e lexon me kujdes librin e shikon këtë ide tinëzare për të nxitur hakmarrjen patologjike,

ide që e ngacmon dhe ngre kokën dhe e dekonspiron doktorin sllavo-australian. Këtë merak e këtë hall autori e ka prej fillimit e deri në fund, ndërsa shqiptarët luftojnë për lirinë e nëpërkëmbur, sakrifikojnë e japim jetën për idealet e larta të lirisë duke kryer e realizuar çdo gjë me të drejtë të ZOTIT.

Shqiptarë të dëbuar nga trojet e tyre

Heronjtë shqiptarë, historikisht, kanë dhënë jetën në mbrojtje të trojeve dhe kufijve të tyre. Në asnjë rast të vetëm nuk kanë qenë agresorë dhe nuk kane synuar trojet e territoret e të tjerëve siç kanë bërë shovinistët fqinjë. Autori i librit nuk e di, ndaj i duhet kujtuar se në fillim të shekullit XX, pikërisht treva ku ka shkelur, vendi që po mban gjallë ditë e natë më shumë 200 mijë vetë, Luma e Kuqe shpartalloi ushtrinë serbe në betejën e saj historike të nëntorit 1912. Në atë betejë ushtria serbe la në fushën e luftimit 12 mijë ushtarë të vrarë (disa burime thonë 16 mijë).

Juriseviçi dhe çdo "*viç*" tjetër duhet të dijë se ata ushtarë serbë u vranë në zemër të tokës shqiptare. Pikërisht për këtë nuk është faji i shqiptarëve për atë katastrofë të pësuar në ushtrinë serbe. Është faji i vetë serbëve shovinistë që erdhën për t'u vrarë në Lumë si shovinistë, agresorë dhe pushtues.

Juriseviçi duhet të mos e harrojë kurrë se shqiptarët dhe lumjanët në këtë rast në dallim nga serbët (hakmarrës patologjikë që masakruan e vranë edhe pleq, gra e fëmijë në barkun e nënës), ushtarët pushtues serbë i vranë por robërit i trajtuan njerëzisht. Edhe të vrarët i varrosën njerëzisht sepse shqiptarët tradicionalisht janë dinjitozë. Zoti dhe natyra ishin aleatë me lumjanët në atë betejë që me të drejtë u konsiderua si Beteja e Termopileve. E Zoti zakonisht ndihmon të drejtit.

Sidoqoftë Juriseviçi hyri në qytetin e Kukësit, në vendin e mikpritjes e bujarisë së pashembullt. Në qytetin e shpresës së madhe. Në qytetin më të përmendur të botës (në atë periudhë), në qytetin e dhimbjes më të madhe njerëzore për kombin shqiptar dhe jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë njerëzimin. Ky ishte opinioni dhe realiteti i Kukësit shqiptar për të gjithë.

V - *"Eksploratori humanist"*

Çfarë vëren "*mysafiri*" i ri Juriseviç sapo futet në Kukës? Vëren ato që i kishte mësuar më parë se të vinte këtu, që i kishte me vete. Ai shkruan që "*Kukësi është i tmerrshëm, i padashuri dhe i padashur, i pashpresë si një zemër e thyer*" duke dalë kundër vlerësimit real të Kukësit që i kishte bërë gjithë bota politike dhe mediatike, bota humanitare. Në Kukës duke filluar nga 27 marsi 1999 e deri më 28 prill 1999 (kur vjen Juriseviçi), kishte me qindra gazetarë nga e gjithë bota, përfaqësues mediatikë të mediave më prestigjioze. Ishin prezentë një numër i madh shoqatash,

selitë e organizmave ndërkombëtare kryesore si OKB-së, UNHCR-së, OBSH-së, KRYQI I KUQ si dhe me mijëra të ardhur nga Kosova si të dëbuar dhunshëm. Kukësi u vlerësua dhe u pagëzua si qyteti i paqes, i shpresës, i mikpritjes. Shembull i lartë i bujarisë dhe i sakrificës për të pritur, strehuar e ushqyer të ardhurit nga Kosova, gazetarët, reporterët dhe të gjithë organizmave ndërkombëtare duke përballuar me sukses eksodin biblik. Kukësi e përballoi me sukses të plotë katastrofën humanitare, e shmangu atë katastrofë të tmerrshme që e kishin ideuar dhe përgatitur fashistët modernë serbë në mes të Evropës. Kjo është e vërteta e Kukësit në vitin 1999. Këtë të vërtetë, s'ka Juriseviç, s'ka Millosheviç…s'ka asnjë "*viç*" tjetër as në Serbi e as në botë që ta mohojë e ta ndotë me jashtëqitje gojore.

Çdo gjë është e dokumentuar, filmuar dhe fotografuar nga e gjithë bota që përbëjnë faktin e madh, argumentin e pamohueshëm se çfarë po ndodh në këtë vend. Për çdo gjë mund të shpifë e mund të abuzojë me lirinë e shprehjes Juriseviçi, por që të arrijë të konkludojë aq shpejt (vetëm me një të parë) sapo ve këmbën në Kukës se "*qeveria lokale nuk i shpenzon paratë atje ku normalisht do të duhej*" na duket një e dhënë "*falas*" për një spiun, informator ordiner që gjithsesi nuk do të rrinte pa e paguar çdo të dhënë tjetër që do t'i duhej për të realizuar misionin e tij të djallit se sipas idesë së tij fikse "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"! Gjithnjë planet i ka të bëra dhe shfrytëzon çdo detaj, çdo fjalë e çdo të dhënë për t'ia arritur objektivit. Qysh kur futet në Kukës shkruan se "*Milaimi (përkthyesi i tij) i shpjegon Juriseviçit se Kukësin e kontrollonin kriminelët lokalë dhe se asgjë nuk mund të kryhet po qe se nuk paguhen paratë*"(!) Nëse është e vërtetë kjo që shkruan autori turpi është për Milaimin. Përsa i përket Juriseviçit turpi është fund e krye. Në Kukës janë të gjithë mediat botërore dhe e duan rrëfimin,

por cilin rrëfim, - pyet Juriseviçi - dhe shënon atë përgjigje që do vetë: "*Sa njerëz vdesin*?"

Çudi! Pse shkrues djalli e mjeku monstër kërkon të vdekur!? Pse e kërkon vdekjen dhe jo jetën!? Mediat botërore kishin një rregull logjik e standard profesional, një raportim njerëzor për situatën tejet të ndërlikuar në Kukës. Ato njoftonin gjendjen normale: Sa refugjatë vinin çdo ditë në Kukës, sa strehoheshin në kampet e ngritura në Kukës, sa në banesat e qytetarëve të Kukësit, sa ishin nën qiell të hapur, sa transportoheshin në qytete të tjera të Shqipërisë, sa ushqime dhe barna ishin siguruar për to, sa kampe strehimi janë ngritur nga UNHCR-ja, shteti italian, gjerman, EBA, Bashkia e Kukësit…

Ky informacion ishte i përditshëm i shoqëruar me kronika televizive dhe me fotografi në gazetat e shumta. Nuk pati asnjë rast që të mos informohej publiku edhe për rastet e vdekjeve që kanë ndodhur në atë kohë kryesisht vdekje natyrale. Kishte edhe aksidentale (shumë rrallë) apo ndonjë vrasje nga zonat drejtpërdrejt në luftimet në afërsi të kufirit ku zhvillohej përpjekje midis njësiteve të UÇK-s dhe të ushtrisë serbe. Forcat ushtarake serbe vranë në vijën e kufirit në Morin edhe një gazetar të huaj (nga Kili që punonte për një kanal televiziv spanjoll). Gjithsesi ishte rasti i vetëm fatmirësisht dhe mediat e dhanë lajmin sipas skemës së zakonshme që tashmë ishte pranuar konsensualisht prej tyre, e para jeta e pastaj vdekja! Ndërsa Juriseviçi përmend dhe do vdekjen në fillim e pastaj jetën megjitëse nuk e përmend fare! Dmth, çdo gjë e do dhe përshkruan bythëmbrapsht. Duke lexuar librin ne nuk e marrim vesh për çfarë misioni ka ardhur në Kukës; për të mbrojtur jetën a për të ndihmuar vdekjen!? Ta shikojmë, por të gjitha veprimet e tij të çojnë te misioni i djallit.

Edhe "*merakun*" e Juriseviçit nëse Kukësi mund t'i mbajë gjallë ato gazetarë (ka sy aq të mëdhenj sa e kupton se

janë shumë për Kukësin), se ku janë strehuar e çfarë hanë ia heq Milaimi i cili i jep një "*të dhënë*" (s'besoj falas) kur i thotë se "*E dini një gjë? Këtu mezi gjen ushqim njeriu, por nëse do një kallash apo 10 gr. kokainë hiç s'është problem*". Edhe sikur të ishte "*përgjegjësi*" apo "*menaxheri*" i trafikut të armëve ose i narkotikëve në Kukës do të duhej të nguronte sado pak që t'ia thoshte një të huaji që sapo e ka takuar që ka ardhur nga Australia shumë e largët, një të dhënë aq haptazi dhe pa asnjë frikë. Duket disi e pabesueshme, madje paradoksale! Aq më enigmë mbetet interesimi: pse i duhej "*doktorit-kirurg*" informacioni i menjëhershëm për kallashë e kokainë! A e ka vrarë mendjen a thua Milaimi për këtë!?

VI – "*Njohja*" me punën në spitalin e Kukësit

Pas këtyre dy informatave të shpejta, Juriseviçi do të interesohet më në fund edhe për spitalin e Kukësit, sepse helbete ishte edhe "*doktor*"!

"*Detyra ime e menjëhershme (realisht të menjëhershme ishin të dhënat që mori nga Milaimi. M.B.) është inspektimi i spitalit lokal, ta vlerësojë kapacitetin për operacione dhe t'ia nis punës*". - shkruan Juriseviçi në libërpaçavuren e tij.

Mirë që u kujtua më në fund edhe për spitalin e Kukësit, edhe pse besojmë se nuk ka aq by... ta inspektojë spitalin. Është krejt jashtë loje. Sepse e kupton vetë që edhe pse e ka mundësinë ta vizitojë, të takojë drejtuesit, të prezantohet si mjek kirurg (gjithnjë me anë të dokumenteve) dhe të ofrojë çdo ndihmë që mundet pranë autoriteteve drejtuese të spitalit dhe kolegëve kirurgë vendas për shkak të vrullit të punës e ngarkesës nuk arrinte të informohej. Mjekët e këtij spitali janë aktive ditën e natën. Vizitojnë të sëmurët, u shërbejnë me përkushtim atyre, mjekojnë dhe operojnë të sëmurët në zbatim të detyrës së tyre funksionale pa pasur

nevojën e Juriseviçit. Ata nuk ia patën ngenë t'i jepnin informatat që do ai. Kjo situatë shumë e ngarkuar për spitalin e Kukësit kishte filluar plot një muaj më parë (më 27 mars 1999) dhe jo sot kur ky njeri erdhi në Kukës (28 prill 1999).

Më poshtë shkruan se "*sytë dhe veshët e mi po konsumojnë aq shumë gjëra demoralizuese, sa që edhe një herë po lutem që të mund ta kontrolloj*" (!) duke na çuditur me ato "*sy*" që akoma nuk e kanë parë spitalin e Kukësit dhe me ato "*veshë*" që akoma nuk e kanë dëgjuar as edhe një fjalë nga asnjë punonjës i spitalit të Kukësit.

Mendja e sëmurë, meqë e sheh veten jashtë loje i fabrikon gjërat demoralizuese duke ngarkuar me faj sytë e veshët. Kjo situatë e njeriut në fakt është gjendje anormaliteti. Tenton ta prezantojë veten si "*shpëtimtari*" i situatës e kjo shihet në çdo faqe të librit. Por në të njëjtën kohë harron se është kujtuar me vonesë diku më shumë se një muaj më vonë se të tjerët. Dhe kësisoj në këtë situatë tragji-komike bëhet vetvetiu qesharak pa filluar punën për arritjen e misionit të tij "human". Që në fillim duket kot përpjekja e tij për tu integruar në jetën aktive të spitalit të Kukësit mirëpo interesantja është se nuk e kupton.

Njerëz të tjerë, njerëz të mirë me ndërgjegje dhe përgatitje profesionale të lartë nga të katër anët e botës vërshuan në Kukës që në ditët e para të krizës. Ndër ta ishin mjekë të nderuar e të respektuar dhe punonjës të tjerë shëndetësor që u vunë në dispozicion të strukturave drejtuese të spitalit të Kukësit duke dhënë kontributin e tyre në realizimin sa më të mirë të shërbimit mjekësor.

Ky kontribut i tyre do të mbetet i paharruar jo vetëm në mendjet dhe zemrat e mjekëve, infermiereve dhe punonjësve të tjerë të spitalit, por edhe në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që janë mjekuar në spitalin e Kukësit në atë periudhë të vështirë. Do të jenë kurdoherë të respektuar në mendjet dhe zemrat e të gjithë familjarëve dhe

të afërmve të sëmurëve në mendjen dhe zemrën e gjithë popullit shqiptar i cili ka ditur dhe di ta vlerësojë dhe ta respektojë ndihmën e dashamirësve të vërtetë ashtu siç ka bërë gjatë gjithë historisë së tij. Por, kuptohet që misioni i Jureseviçit kërkon që spitalin e Kukësit ta shihnin të tjerët sikur donte ta shihte vetë ai dhe jo si është realisht. Shkurt e pastër, halli i autorit të librit është që spitalin e Kukësit ta paraqiste jo si spital, por si një mjedis ku njeriu nuk bashkëjeton me të. Mendja e sëmurë, ndërgjegjja e çorientuar, shpirti i zi katran e kishte projektuar që më parë se si do ta "*shihnin*" të tjerët spitalin e Kukësit (për ta përshkruar pas dhjetë vjetësh në paçavuren që e quan libër). Në librin paçavure shkruan se "*spitali i Kukësit është një ankth i vërtetë. Vetë ndërtesa është një rrënojë që ende po shkatërrohet, me dritare të thyera, me dyer të varura ...Ende pa hyrë në ndërtesë së bashku me Milaimin, spitalit i vinte era varrë gangrenoze, qelb të patrajtuar që ma turbullon barkun sikur mishi i kalbur*".

Kolektivi i sallës së operacionit

Çfarë dashakeqësie! Thotë gjëra që as vetë nuk i beson. Budallallëqe me brirë nëse Flaka (Flaka Surroi – M.B.) e ka përkthyer saktë në gjuhën shqipe. Nuk mund të besojë kush se i ka hundët më të specializuara se kushdo për të dalluar prej së largu erërat më të këqija duke i specifikuar me një hollësi të jashtëzakonshme. Sepse asnjë tjetër, veç autorit, (duhet pyetur edhe Milaimi se mos ka cilësi të nuhatjes si ai) nuk e vërteton atë që ka zhgarravitë në paçavuren që po i themi libër për spitalin e Kukësit. Në fakt çdo gjë është e dokumentuar rigorozisht e me një rregull strikt për të pasur zili, e fotografuar dhe e filmuar nga të gjithë mediat botërore (që kanë qenë prezentë në Kukës) si në mjediset brenda dhe jashtë në oborr apo jashtë mjediseve të spitalit. Mjeku Juriseviç me këto që shkruan është bluza e zezë e mjekësisë. Spitalin e Kukësit e kanë vizituar mediat më prestigjioze të botës. E kanë vizituar personalitetet më të larta të OKB-s, UNHCR-s, KRYQIT TË KUQ, OBSH-s, BE... E kanë vizituar drejtues të shumë shteteve apo të organizmave ndërkombëtare si Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara Kofi Anan, Komisionerja e Lartë për Refugjatët Sadako Ogata, Kryeministri Italian Maximo d'Alema, Presidenti i këtij vendi Oskar Luigji Skalfaro, drejtori i Bankës Botërore...dhe asnjë prej tyre dhe asnjë tjetër që e ka vizituar spitalin e Kukësit në atë kohë nuk e ka ndjerë "*erën e keqe dhe të qelbur*" të Juriseviçit.

E së largu dallon përsëri atë që ka planifikuar të dallojë kur shkruan se "*nja tridhjetë refugjatë po presin para emergjencës nën diellin përcëllues nuk duket që asnjeri ka ndonjë shpresë*". Por fantazia arrin deri në atë shkallë sa të bën të dalësh me të vërtetë kundër natyrës njerëzore dhe intelektuale. Pse dhe për çfarë arsye?

Sepse atë ditë, më 28 prill 1999, kur Juriseviçi sheh refugjatët në "*diellin përcëllues*" para urgjencës së spitalit

nuk ka pasur diell në Kukës. Rrjedhimisht s'ka pasur as para urgjencës së spitalit. Gjithë atë ditë në Kukës ka pasur reshje shiu dhe ka qenë mot i ftohtë. Pra, s'ka pasur diell fare, pa lëre më diell përcëllues jo se jo. Në librin e Petrit Palushit "*Kukësi në 79 ditë*" botuar në vitin 1999, në faqen 62, kur bëhet fjalë për datën 28 prill 1999 shkruhet se duke biseduar me gazetaren Blerina Halili "*po diskutojmë për kohën dhe motin meqenëse 'në Kukës bie shi' njerëzit janë të mërzitur, por jo pse bie shi e shumica janë pa kulm mbi krye, por se NATO-ja e ka hapësirën më errët për të vepruar kundër objekteve serbe*". Edhe në librin e Besim R. Cengut me titull "*Përmasat e mbijetesës*" botuar në 2003 (një libër i shkëlqyer që pasqyron me përpikmëri çdo ngjarje në Kukës) për çdo ditë, për çdo institucion, për çdo kamp, për çdo hapësirë, për çdo të dhënë dhe evidencë në atë kohë. Në faqet 166-168 shkruhet se "*Koha me shi që po mbretëron këto ditë prilli dhe në ditët e para të majit, vështirëson jetën e të dëbuarve me dhunë nga trojet e tyre etnike veçanërisht të atyre që janë jashtë pa asnjë mbrojtje*".

Por edhe qytetarët e Kukësit, të ardhurit nga Kosova dhe të ardhurit nga të katër anët e botës në Kukës nuk besojnë se e kanë parë "*diellin përcëllues*" të Juriseviçit më 28 prill 1999, as më 29 e 30 të këtij muaji që t'ia përcëllonte tridhjetë refugjatët e sëmurë para urgjencës së spitalit. E kupton edhe vetë se ato që i shkruan në paçavure nuk janë të vërteta, por siç duket autori është "*lidhur shkurt*" i detyruar në misionin e tij të vështirë përderisa del kundër natyrës edhe kundër të gjithë njerëzve nëpërmjet kësaj gënjeshtre me bisht dhe të trashë madje. Mbi 200 mijë të dëbuar me dhunë nga trojet e veta etnike që janë stabilizuar në Kukës e dinë fort mirë pasi ngjarjet e vështira në jetën njerëzore mbahen mend gjatë. Të gjithë ata fëmijë, pleq, burra e gra në Kukës e kanë ndjerë mbi trupin e tyre të ftohtin dhe shiun. Por jo diellin përcëllues të stisur prej Juriseviçit. Kështu nuk i shërbehet

misionit, por përkundrazi i shërben diskreditimit të vetvetes me "*argumente*" e "*fakte*" që mendja diabolike e Juriseviçit shpik.

Çdo njeri e lexues mund ta hajë e ta marrë për të vërtetë të pabesueshmen. Por e vërteta është e tillë se është objektive, pavarësisht nga ne dëshirës dhe vullnetit tonë. Absurditeti i imagjinatës së autorit shkon deri aty sa nëpërmjet gojës të shoqëruesit të afërt e të bindur Milaim përshkruan në paçavure sikur pak metra larg urgjencës së spitalit "*Po kalbet një lopë e coftë me kofshët e këputura. Mizat dhe buburrecat sillen vërdalle mishit të cofëtinës sa për ta kompletuar imazhin e kësaj kalbje neveritëse*". E shoqëruesi i afërt e besnik i tij vazhdon "*të shpjegojë*" se disa ditë më parë, refugjatët në kërkim të ushqimit dhe të ndihmës mjekësore, kishin ardhur deri në oborr të spitalit dhe meqë ua refuzuan trajtimin dhe ushqimin ato iu hodhën lopës dhe ia këputën kofshët për të mbijetuar! E nga "*shpjegimi*" i Milaimit, Juriseviçi thotë se "*nuk jam i sigurt se lopa do të ketë cofur para se të copëtohej*". E po kjo është tejkalimi i të gjitha imagjinatave që pjell mendja njerëzore! Unë nuk kam koment për këtë "*fakt*" të tij. Nuk kam kohë të humbas për të. Imagjinata e shfrenuar e "*kirurgut*" sllavo-australian kalon çdo kufi, çdo logjikë…Vetëm hienat ushqehen me cofëtina. Njeriu (i vërteti, që Zoti e ka falë) as mund ta çojë në mend që llojin e tij ta barazojë me kafshën e urryer që quhet hienë. Vetëm një "*njeri*" cofëtinë si paçavureshkruesi Juriseviç arrin ta përcaktojë dhe ta shprehë atë për qenien më fisnike të Zotit, qenien njerëzore.

Shqiptarët e dëbuar me dhunë të ardhur në Shqipëri e kryesisht në qytetin e Kukësit megjithëse ishin në kushte tejet të vështira jetese, nën qiell të hapur, në çadra të improvizuara, në oborre shkollash, në mes pallateve, në rrugët dhe sheshet, në kushte atmosferike të këqija, në shi e në të ftohtë mbijetuan mrekullisht. Jo vetëm kaq ato kanë

pasur vështirësi në disa shërbime bazë (nuk mund të bëjmë të paditurin, "*por duhet qëndruar me këmbë në tokë*") por arritën të përballojnë vështirësitë e të mposhtin tragjedinë. Ata gjatë gjithë asaj periudhe të ligë asnjëherë dhe në asnjë rast nuk kanë vuajtur për bukën e gojës siç pretendon teveqeli i bindur Milaim dhe padroni i tij Juriseviç.

Në ditët e para të eksodit, qytetarët e Kukësit vunë në dispozicion të ardhurve nga Kosova të gjitha rezervat ushqimore e konditat familjare. Këto rezerva, bashkë me ndihmën e shoqatave humanitare që ishin në Kukës para krizës realisht e shmangën katastrofën dhe krizën humanitare që aq shumë e dëshironin dhe kërkonin serbët. Pak kohë më vonë (pas javës së parë), shteti shqiptar, bota demokratike u dynd në Kukës nga të katër anët e botës. E gjithë bota demokratike u gjend shpejt në krah të shqiptarëve se e panë të drejtën e tyre.

Kombi i Skënderbeut e i nënë Terezës ishte në vështirësi të jashtëzakonshme. U ndodh në prag të krizës e katastrofës që u shkaktua prej synimeve shoviniste e gllabëruese të Serbisë kryefashiste millosheviçiane. Kampet e strehimit, ndihmat ushqimore, ndihmat në barna dhe materiale mjekësore, ndihmat me veshmbathje dhe krijimin e kushteve sa më optimale për të ardhurit ishin realitet i asaj kohe. U ngritën kampe nga UNHCR-ja, nga shteti italian, gjerman, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bashkia e Kukësit si dhe nga shumë shoqata ndërkombëtare që ishin prezente në Kukës. E sa për lopën e coftë, mbetet t'ia lëmë në prehrin e mendjen e Juriseviçit i cili përmes atij përshkrimi kujton se e bën më interesant librin.

Duke shfletuar me kujdes e vëmendje librin konsolidojmë bindjen se e keqja nuk është vetëm në ndërmarrjen e guximshme misionare misterioze të autorit. Çudia është se Juriseviçi orvatet t'i futë shpifjet edhe në gojën e disa shqipfolësve me të cilët ai vendos marrëdhënie

të shkëlqyera shumë shpejt e shumë kollaj pa asnjë mund e vështirësi. Në çdo hap që bën i ka në krah për të arritur objektivin djallëzor e kriminal se sipas tij "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*!". Pikërisht për këtë nga ata që autori përmend dhe manipulon përmes tyre pritet reagimi por më kot. Heshtja e tyre flet shumë dhe provon një "*marrëveshje xhentëlmene*" që në substancë është njëqind për qind djallëzi. Siç shihet nuk do të thyhet akulli heshtjes edhe pse ka kaluar më se një vit prej botimit të këtij libri kujtimesh. Prandaj është mirë të dëshmojë dr. Rogeri për "*lopën e coftë*", sepse ai (Rogeri) ka ndihmuar në emergjencën e spitalit për çdo gjë deri dhe në vendosjen e koshave për hedhjen e mbeturinave me dorën e tij dhe jam i sigurt se nuk e ka parë "*lopën e coftë*" dhe nuk ka dëgjuar për të. Për këtë do t'ia bëjmë të ditur botimin e Juriseviçit.

Kur për herë të parë merr kontakt zyrtar me drejtorin e spitalit dhe kur ky i fundit e fton të futet në urgjencë, duket shumë qartë se Juriseviçi sheh ato që i ka planifikuar t'i shohë ato gjëra e objekte që i duhen t'i shohë dhe jo urgjencën siç është realisht në të mirat e padyshim edhe me të metat e mangësitë e vështirësitë. Ai sapo futet në urgjencë (në prani të drejtorit të spitalit) "*sheh*" dhe shkruan që "*dhjetë ose më shumë refugjatë të plagosur janë të shtrirë mbi dysheme, disa me gjysmëvetëdije, e, njëri mbase i vdekur*". Duke përshkruar këtë tabllo imagjinare krupndjellëse në urgjencë ai shpif si derri. E them me kompetencën e një prej mjekëve që e ka gdhirë e ngrysur në spital në shërbimin e njerëzve në nevojë se asnjëherë në asnjë ditë të asaj periudhe në urgjencë nuk kanë ardhur përnjëherësh dhjetë apo më shumë të plagosur, me përjashtim të datës 31 maj 1999 për të cilën do të flasim në veçanti për shumë arsye.

Nga shfletimi i dokumentacionit (në regjistrat dhe kartelat e të sëmurëve) të urgjencës për datat 28 e 29 Prill

1999 nuk vërtetohet se ka pasur të plagosur, aq më pak për tokë, sepse ka dhoma pranimi dhe shtretër të mjaftueshëm, madje dhe më tepër të sëmurë. Sikur t'i ketë rënë në dorë dhe ta ketë lexuar librin dr. Rogeri këto gënjeshtra e trillime do t'i kishte përbuzur. Jam i sigurt për këtë, se broçkulla të tilla nuk i ha askush.

Por Juriseviçi bën përpjekje të përgatisë opinionin se në spitalin e Kukësit nuk ka asnjë lloj shërbimi ndaj të sëmurëve. Për më tepër as shërbim të thjeshtë njerëzor, pa bërë fjalë për shërbim mjekësor. Është fakt se në urgjencën e spitalit pos Juriseviçit kanë qenë prezent në çdo kohë edhe persona të tjerë. Janë shoqëruesit dhe familjarët e të sëmurëve, vizitorë të ndryshëm, gazetarë, reporterë e fotografë të mediave lokale, kombëtare e botërore. Mjekë e infermierë dhe personel tjetër shëndetësor që hedhin poshtë shpifjet e gënjeshtrat e Juriseviçit. Duke u ballafaquar me dokumentacionin e urgjencës dhe duke i thirrë kujtesës ish kryeinfermierja e urgjencës Bege Dafku si dhe infermierët Afrim Dogjani, Astrit Tota, Dervish Ferati, Drita Islami, Bukurie Domi...i hedhin poshtë me neveri shpifjet e Jureseviçit i cili merr përsipër e guxon ta mbushë paçavuren vetëm me shpifje, gënjeshtra e të pavërteta. Si është e mundur të shkruajë për të plagosur (dhjetë) pikërisht ditën kur s'ka pasur asnjë të tillë!? Ç'e shtyn të gënjejë kaq paturpshëm!? Apo ndoshta ia do skenari i filmit që ëndërron të bëhet në Holliwud dhe që do ta bëjë të famshëm! Në bazë të dokumentacionit të përditshëm në spital nuk asnjë të plagosur. Kjo është e vërteta absolute e asaj dite. Kjo është e vërteta, o njerëz që lexoni këtë libër që bazohet në fakte të gjalla e kërkime në dokumentacionin e përditshëm, të kontaktit me punonjësit e përkushtuar që kanë lidhë fatin e jetës me ketë institucion shërbimi shëndetësor.

Ne, që kemi qenë dëshmitarë të përhershëm në spital, qytetarët e Kukësit, të ardhurit nga Kosova dhe të huajt që e

kanë vizituar urgjencën e spitalit dhe të gjithë të sëmurët që janë trajtuar në urgjencë, dëshmojmë kolektivisht njëzëri të kundërtën. Nuk janë e as do të jenë shqiptarët ashtu siç dëshiron t'i paraqesë një mjek e njeri ordiner aspak profesionist në një paçavure. Nuk duhet harruar kurrë se tradita e shqiptarit është besa e burrëria, dashuria e humanizmi, bashkëjetesa e mirëkuptimi. Shqiptari për shqiptarin jep çdo gjë. Jep edhe jetën sidomos kur dikush i kërkon besë e strehë, sikurse besa e streha që kërkuan vëllezërit te vëllezërit e vet. Dhe kështu u bë: u gjet streha, u gjet besa, u gjet komunikimi njerëzor e tejkalimi i së keqes. Kjo ka ndodhur historikisht me shqiptarët, kjo ndodhë edhe sot, kjo do të ndodhë gjithnjë se jemi një gjak e kemi një gjuhë, kulturë, traditë, territor e një komb, pavarësisht se me forcë e me intriga sot jemi të ndarë në pesë shtete jo për fajin tonë.

VII – Tentativë dëshpëruese vetëm për të *"nxirë"*

Juriseviçi në librin e tij mundohet gjithnjë ta paraqesë shqiptarin siç do vetë. Prandaj është i detyruar të "*shohë*" një shqiptar tjetër, një shqiptar që e bën shqiptarin të vuaj, që nuk vlerëson e respekton veten e tij. Një shqiptar imagjinar sipas koncepteve të kokës së tij. E sheh në këtë rast si plaçkë për grabitje (!). Më kot mundohet e përpëlitet. Nuk ka ndodhë, nuk ndodhë e, as nuk do të ndodhë kjo me shqiptarët. Historia e racës shqiptare është e njohur. Shqiptarët kanë sakrifikuar çdo gjë deri dhe jetën e tyre për të gjitha ata që e kanë kërkuar ndihmën dhe mbështetjen e tyre në kohë të vështira. S'ka si të jetë ndryshe kjo ndihmë e mbështetje për njeri-tjetrin, shqiptari për shqiptarin.

A nuk është populli shqiptar i vetmi në Evropë që gjatë Luftës së Dytë Botërore i strehoi, ushqeu dhe i mbrojti hebrenjtë? Cili popull në Evropë e bëri atë që bënë

shqiptarët? Po sot a nuk po çuditet bota për atë që po bëjnë shqiptarët për vëllezërit e tyre të Kosovës, kur po ndajnë me ta çdo gjë, banesën, ushqimin, shërbimet, kujdesin mjekësor, kujdesin njerëzor e çdo gjë tjetër? A nuk dhanë jetën e tyre duke njomur me gjak tokën e Kosovës shqiptarët e Shqipërisë? A nuk luftuan se bashku si vëllezër të një gjaku për çlirimin e Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare nën robërinë serbe? A nuk ishte gjaku i Indrit Carës nga Kavaja, i Halit Cokës nga Kukësi, i Tahir Sinanit nga Tropoja, Astrit Sulit nga Berati...dhe sakrifica e qindra e mijëra bijve e bijave të Shqipërisë që luftuan përkrah vëllezërve të tyre për çlirimin e trojeve etnike shqiptare? Si është e mundur që vëren edhe ndonjë shqiptar që nuk i shërben shqiptarit kur e ka në besë? Vetëm djalli e bën një përpjekje të tillë. Këtë e bën vetëm një dashakeq që ëndërron dhe me ëndrrat e tij të errëta tenton dëshpërimisht të mbush mendjen e atyre që e lexojnë.

Njeri i kualifikuar e specializuar, siç duken gjasat deri tani jo për mjekësi, por për misionin e djallit, Juriseviçi gënjen e shpif me qëllim. Shpikje të papara e të padëgjuara kur nxin faqet e librit edhe ashtu katran kur shkruan se "*Cena e ka truprojën e vet të armatosur një bandit të sertë me një arnë në sy, me një xhaketë të keqe ngjyrë lëkure, pantallona dhe çizme me lëkurë gjarpri i armatosur me AK 47...*" (!). Ha, ha ha ha ha ha ha ha, na mbyti gazit! Budallallëqe të kësaj natyre e mase asnjëherë nuk kam lexuar në asnjë libër deri më sot!

Çdo njeri në Kukës, në spital të gjithë ato që kanë pasur rastin ta takojnë drejtorin e spitalit, i gjithë personeli i spitalit dhe të huajt që kanë punuar në atë kohë në spital nuk e pohojnë atë që thotë Juriseviçi. Madje të shukatur prej çudisë e hedhin poshtë me neveri sepse drejtori i spitalit përveç shoferit të makinës së tij nuk ka pasur kurrë njeri tjetër me vete gjatë punës dhe veprimtarisë së tij ditore. E

shoferi i tij është i njohur, konkret, me emër e mbiemër. Ka punuar atëherë dhe punon edhe sot shofer ambulance. Është vendas që moti dhe jo vetëm se nuk ka pasur as nuk ka arnë në sy apo në ndonjë pjesë tjetër të trupit, por ka gëzuar dhe gëzon edhe sot shëndet shumë të mirë.

Juriseviçi me këtë libër-paçavure vetëm se po i bie legenit. Veçse tingullin e atij legeni nuk e dëgjon askush po vetes së tij. Është e drejta tij t'i bjerë, por harron se i bie vetëm në një melodi dhe kësisoj bëhet i bezdisshëm, monoton e krejtësisht i pabesueshëm. Mjerani nuk di melodi tjetër pos melodisë së djallit dhe me historitë e veta përçudnuese është bëra tanimë edhe objekt talljeje. Më poshtë vazhdon se "*Mjeku po i copëton muskulin dhe ligamentet e ekspozuara në dorën e lënduar nga shpërthimi me një palë gërshërë të thjeshta, përderisa infermierja e mban djaloshin 6-7 vjeçar me forcë duke ia krisur nga një shuplakë sa herë që dhimbja e bën të qajë e të bërtasë*".

Është mjaft e çuditshme se si kjo "*skenë juriseviçiane*" ndodh në prani të drejtorit të spitalit dhe të "*doktorit*" sllavo-australian, bile pa çarë kokën as për normat më elementare njerëzore e tekniko-profesionale. Madje as për përgjegjësitë ligjore që ka mjeku dhe çdo personel tjetër mjekësor në ushtrimin e profesionit të tij. Nga kjo skenë që vetëm mendja e Juriseviçit e fantazon dilet në përfundimin që i pëlqen dhe ngazëllehet ku në paçavure shkruan se "*mjeku po qe se donte të torturonte qëllimisht fëmijën nuk ka mundur ta bënte në mënyrë të prekshme si tash*"(!) Si ia merr mendja këtij "*njeriu*" që e ka emrin Crajg Juriseviç të shpifë aq kriminalisht e që shkruan një të ashtuquajtur libërpaçavure me titullin "*Gjak në duart e mia*".

Nuk thotë asnjë të vërtetë. Ndryshe, thotë çdo gjë veç të vërtetës. Pse themi kështu? Sepse mjeku kirurg për të cilin shpif autori skandaloz vërtet "*kriminalisht*" punon në spitalin e Kukësit që nga viti 1972 (tani në vitin 1999 plotëson 27

vjet si kirurg në detyrë) dhe përvoja e tij kirurgjikale është e gjatë. Puna e tij është vlerësuar dhe rezultatet i ka pasur të lakmueshme për çdo kirurg. Sa për sqarim të lexuesit e themi me përgjegjësi të plotë se dr. Mustafa (për të cilin shpif Juriseviçi) ka punuar gjithnjë me përkushtim e cilësi të admirueshme. Ai punon edhe sot me të njëjtën cilësi dhe gëzon respektin e kolegëve dhe gjithë punonjësve të spitalit, gëzon respektin dhe mirënjohjen e gjithë qytetarëve të rrethit të Kukësit dhe më gjerë.

Kirurgu ynë ka punuar e punon me ndërgjegje të lartë e me profesionalizëm dhe nuk ka ndodhur asnjëherë që të manipulojë të sëmurë pa anestezi (aq më pak tek fëmijët). Kurrë nuk ka ndodhur që kirurgët e spitalit të Kukësit të përdorin instrumente të tjera gjatë operacionit veç atyre që përdoren në të gjitha sallat e operacioneve në të gjithë botën. Nuk ka përdorë në asnjë rast të vetëm, në asnjë rrethanë, asnjë kirurg i Kukësit gërshërë të zakonshme në punën e tij. Mbi të gjitha nuk ia lejon profesioni e për më tepër ndërgjegje. Ku mbetet pastaj "*Betimi i Hipokratit*"? Edhe një fakt tjetër duhet që ta themi: mjeku për të cilin trillon paçavureshkruesi aq pafytyrësisht sikur "po e torturonte qëllimisht fëmijën" gjatë gjithë kohës që punon ka qenë e mbetet korrekt në punë, i përpiktë në zbatimin e disiplinës tekniko-profesionale dhe zbatues fanatik i rregullave në sallën e operacionit. E pohojnë njëzëri të gjithë mjekët e infermierët që kanë punuar e punojnë me të, bile duke u "*ankuar*" pak se nuk bën asnjë lëshim asnjëherë. Nuk ka ndodhur kurrë (as në kohën e diktaturës) që mjeku ne fjalë të ketë lejuar të hyjë në mjedisin e sallës së operacionit asnjë person i jashtëm, veç punonjësve të sallës kur zhvillohej një operacion për asnjë arsye. Nuk është lejuar të hyjë në sallë asnjë, as drejtori i spitalit, as mjekë të tjerë të spitalit apo drejtues të institucioneve të rëndësishme qoftë edhe të prokurorisë apo policisë...Ky është rregulli. Kjo është e

vërteta që e dinë të gjithë. Prandaj askush nuk e beson se një palokirurg sllavo- australian paska hyrë në sallën e operacionit gjatë manipulimit kirurgjikal (operacionit) dhe bile ia paska "*marrë*" të sëmurin për ta mjekuar vetë duke e "*bindur*" kirurgun kuksian aq shpejt! Çfarë gallate! Këtë nuk e ha askush.

Gjatë periudhës së eksodit (27 mars-12 qershor 1999), në qytetin e Kukësit, fatmirësisht, nuk është dëgjuar asnjë krismë arme. As në dasma madje që natyrisht janë bërë pasi jeta vazhdonte normalisht pavarësisht situatës së jashtëzakonshme. Shqiptarët u bashkuan me njëri-tjetrin shpirtërisht, moralisht e fizikisht para rrezikut që i kanosi në vitin 1999.

E themi edhe një herë se në Kukës askush nuk ka dëgjuar asnjë krismë arme. Asnjë gazetar, reporter, fotograf, media lokale, kombëtare apo botërore që ishte instaluar nis e sos në Kukës nuk ka dëgjuar asnjë krismë. Po kështu edhe asnjë përfaqësues i organizmave apo shoqatave të shumta ndërkombëtare që ishin të pranishëm në Kukës që në ditët e para të krizës e deri në përfundimin e saj.

Vetëm veshët e të paudhit Juriseviç kanë dëgjuar krisma arme herët në mëngjes që e kanë zgjuar nga gjumi (çuditërisht zgjuan vetëm Juriseviçin) dhe ai menjëherë e kupton se ishin breshëritë e banditëve që kishin plagosur për vdekje djaloshin dhjetë vjeçar kosovar. Dhe a e dini pse e qëlluan? Për t'i grabitur paratë! E kujt? Një fëmijë dhjetë vjeçar jetim pa baba, pa nënë, pa vëlla, pa motër. Se ku i kishte ato para që t'ia grabisnin banditët vetëm Juriseviçi e dinte. Askush tjetër! S'ke ç'bën! Edhe Don Kishoti "luftoi" në kohën e tij dhe breza të tërë lexojnë historitë e tij të qëndisura nga Servantesi i madh! E njejta vazhdon edhe sot, Don Kishotë të rinj, modernë, të përgatitur e të kualifikuar në shkallën më të lartë për të "*luftuar*" me cilindo vetëm për të arritur qëllimin. Vetëm për të përmbushur me çdo çmim

misionin e djallit qoftë edhe me çmimin e turpit e vetëm turpit. Don Kishotë, por edhe Sanço Pança që i rrinë afër e i bëjnë temena duke nëpërkëmbur personalitetin e atë pak moral që kanë.

Më tepër se dyqind mijë banorë të Kukësit, asnjë media lokale, kombëtare apo ndërkombëtare që ishin në Kukës (27 mars -12 qershor 1999) nuk e kanë parë, dëgjuar, regjistruar e përshkruar atë "*tragjedi*" allajuriseviçiane të djaloshit dhjetë vjeçar kosovar me qëllim grabitjen e parave.

I vetmi është Juriseviçi dhe dëshmitari i tij i përhershëm, Milaimi, i cili duhet të bëhet i gjallë e të shprehet ndryshe nuk ndryshon nga Juriseviçi dhe është njëlloj si ai përderisa ka zgjedhur deri tani këtë qëndrim. Megjithëse një ngjarje e tillë nuk ka ndodhur kurrë në Kukës, të çudit fakti që Juriseviçi dhe Milaimi megjithëse fëmija "*vdes*" shumë shpejt (shyqyr që s'është vdekje e vërtetë) gjejnë kohën dhe bëjnë një bisedë të rëndësishme, më të rëndësishme se vetë jeta e fëmijës sepse u duhet të arrijnë në "*përfundimin*" se shqiptarët e Shqipërisë "*kanë shumë pak simpati për kosovarët*" gjë të cilën e shpreh i pari teveqeli (Milaimi) duke e lidhur atë mossimpati me periudhën e ish Jugosllavisë (megjithëse Jugosllavia tashmë kishte shumë vite që ishte shpërbërë dhe nuk ekzistonte si shtet) (!). Dhe çudia e teveqelit vazhdon: pa e pyetur fare Juriseviçi (siç bën zakonisht) kësaj here Milaimi ka marrë zjarr dhe i deklaron copë atij se "*shqiptarët e Shqipërisë mendojnë se kosovarët e kanë pasur të lehtë nën sundimin e Titos*" krahasuar me shqiptarët nën sundimin e Hoxhës (!). "*Kështu që nuk i duam kosovarët. Këto kanë pasur më shumë para dhe pak më shumë liri. Shumë shqiptarë mendojnë se kosovarëve po u bëhet mirë. Kjo është çmenduri, por kështu mendojnë. Refugjatët që vijnë këtu trajtohen si qentë*".

Turp e krim së bashku për të dy, edhe për Juriseviçin edhe për Milaimin! Ç'farë trillimi skandaloz! A thua se kjo

qenka e vërtetë? Pse e thotë Milaimi apo pse e dëshiron Juriseviçi? Mbetet në dorën e Milaimit t'i përgjigjet njërës nga pyetjet që i duket më e lehtë (gjithnjë nëse do ai). Po qëndroi indiferent ai është fajtor dhe përgjegjës. Por kjo është një barrë tejet e rëndë për një kuksian në fakt. Asnjë qytetar kuksian nuk e beson këtë turp për një bashkëqytetar të tij dhe jo vetëm, por edhe për asnjë qytetar shqiptar ku jeton e punon në të katër anët e botës!

Më tej Juriseviçi shkruan se me ndihmën e Milaimit e dërgon fëmijën e plagosur për vdekje në spital drejt në sallë të operacionit (sikur salla ishte me dyer të hapura, sepse e paska parandjerë ardhjen e një të plagosuri në gjendje shumë të rëndë!).

"*Vetëm disa çaste pritje*", - shkruan Juriseviçi dhe "*në moment një mjek arrin: Ylber Vata, mjek i përgjithshëm i spitalit. I madh, i gjatë, në të katërdhjetat, i cili duket se është ndryshe*". Kuptohet lehtë që Juriseviçi ka planifikuar që sot (ditën e dytë në Kukës) të takojë një mjek ndryshe dhe e takon! Dhe për qejfin apo dëshirën e tij parashikimi i del sepse "*Vata e merr kokën e djaloshit dhe i flet me zë të butë gati duke kënduar. Po i thotë se do ta shërojë dhe se do ta kthejë te nëna në shtëpi*" - pështpërit Milaimi e më pas përktheu përgjigjen e djalit: "*Thotë se nëna, babai dhe vëllezërit i kanë vdekur*". E pas këtij përshkrimi, menjëherë e vendosin djalin në tavolinën e operacionit, i japin anestezinë e me shpejtësi ia hapin abdomenin. Por siç shkruan Juriseviçi "*plumbat e qëlluar nga distancë e afërt ja kanë copëtuar mëlçinë e megjithëse Vata dhe unë përpiqemi maksimalisht për ta ndaluar rrëkenë e gjakut, na vdes në tavolinën e operacionit*". Faktet njerëzore (mjekët, infermieret dhe punonjësit e tjerë të sallës nuk vërtetojnë të ketë pasur një plagosje të tillë të rëndë të një fëmije dhjetë vjeç kosovar as gjatë asaj dite as para e as pas asaj dite. Bile as para as pas ardhjes së Juriseviçit në Kukës. Më saktë, rast i tillë nuk ka

ndodhur asnjëherë! Asnjë ndërhyrje e tillë kirurgjikale nuk është kryer në sallën e operacionit dhe as që mund të kryhej siç përshkruan Juriseviçi vetëm nga Vata dhe ai (!) pa ekipin e plotë të sallës së operacionit, ekip absolutisht i dosmosdoshëm duke përfshirë mjekun anestezist-reanimator dhe asistentet e instrumentisten për një rast të tillë të urgjencës ekstreme. Një ndërhyrje e tillë "*heroike*" kirurgjikale nuk është bërë asnjëherë nga Vata e Juriseviçi. Këtë "*ndërhyrje*" të imagjinuar nga mendja e ç'ekuilibruar e hedhin poshtë me neveri të gjithë mjekët dhe infermieret e sallës së operacionit që kanë punuar e punojnë edhe sot. Natyrisht se dr. Vata e ka plotësisht në dorë sqarimin e këtij rasti të operacionit që nuk është kryer kurrë, ndryshe përngjason me Juriseviçin si dy pika uji dhe kryejnë të njëjtin mision, misionin e djallit.

Sinqerisht, asnjë shqiptar nuk do të dëshironte një ngjashmëri të tillë. Edhe një herë jemi të detyruar ta themi se dr. Vata e ka në dorë të reagojë ose të heshtë si deri më sot. Një heshtje që flet shumë në fakt. Edhe "*trajtimin e atij fëmije kosovar jo si njeri, por si një copë mishi*" vetëm një "*njeri*" si Juriseviçi e bën. Njeriu normal jo. Një mjek jo se jo. Pse e themi këtë? Sepse fëmija është i paidentifikuar. Pa emër pa mbiemër, pa iniciale (të paktën). Pa asnjë të afërm pranë e pa asnjë njeri tjetër të mjedisit ku banonte që të interesohet për të, pos "*doktorit*" nga Australia e largët që iu gjend jo vetëm kaq afër duke ia kryer të gjitha "*shërbimet*" për të arritur qëllimin. Në fakt për të "*dokumentuar*" misionin e tij të errët. Juriseviçi nuk është i vetëm në përcjelljen e fëmijës në botën tjetër, sepse ka "*dëshmitarë*" dr. Vatën dhe Milaimin përkthyesin (i cili për çudinë e madhe ishte në sallë të operacionit!). Këto dy "*dëshmitarë*" të asaj dite janë edhe sot të tillë në gjuhën mjekësore do të quheshin sot "*dëshmitarë kronike apo të kroniçizuar*"). Mirëpo për këtë ngjarje imagjinare sigurisht heshtja sipas një

shprehje të mençur, do të thotë, miratim. Në rastin konkret fjalës mençuri i shtohet vetëm një "*bisht*" dhe bëhet mençuri menderosëse apo mençuri e menderosur.

Jemi të detyruar ta përsërisim edhe një herë se atë operacion imagjinar të Vatës e Juriseviçit nuk e pohon asnjeri nga mjekët anestezistë-reanimatorë. Asnjeri prej tyre nuk mund të merrte pjesë në një operacion që s'është bërë kurrë. As dr. Rexha, dr. Emini, dr. Arbeni dhe as dr. Dukagjini nuk kanë marrë pjesë në operacion. Për të vetmin shkak: nuk mund të marrësh pjesë në një operacion kur nuk ka patur operacion. Asnjë nga infermieret e sallës (as Sadetja, Ilmia, Besa, Medinja, Nazmia e as Flora) nuk kanë marrë pjesë në një operacion që nuk është bërë kurrë.

Më poshtë Juriseviçi shkruan se i vjen keq për dr. Vatën kur infermierja (asnjëra prej tyre nuk ka marrë pjesë në atë operacion) i paska thënë atij se "*dr.Vata ka humbur një numër të madh fëmijësh kohët e fundit. Kërkon mirëkuptim për shqetësimin që po përjeton*". Duket sheshit se Juriseviçi i ka nxjerrë nga mendja dhe goja e tij e fjalët e infermieres dhe i ka shkruar në paçavure si fjalët e të saj. Sepse ato fjalë i nevojiteshin, ndryshe nuk mund të funksiononte e të bëhej i besueshëm krahasimi i Vatës së mirë me Cenën mafioz e të pashpirt! E thotë qartë dhe e shkruan se "*ta kuptosh këtë pikëllim* (të Vatës-M.B.) *është e lehtë. Të përpiqesha ta kuptoja Cenën dhe atë kasapin derisa e trajtonte atë djaloshin dje-jo, dhe as që do të përpiqen madje*". Duket si një sukses i misionit të Juriseviçit, sepse dje (28 prill '99) takoi "rastësisht" një mjek kasap, një mjek të pashpirt, një mjek kriminel. Ndërsa sot (më 29 prill '99) po "*rastësisht*" takoi një mjek të përsosur, njerëzor, një profesionist të aftë që jo vetëm do ta ndihmonte në ditët në vazhdim Juriseviçin, por ç'ka do të jetë më e rëndësishme do t'i duhet jo vetëm në spital, por edhe më gjerë për problemet e qytetit, të rrethit, të rajonit… Sepse gjithnjë Juriseviçi i ka

kërkuar, i ka marrë dhe i ka ndjerë ndihmën dhe këshillat e Vatës sa ka qëndruar në Kukës. Juriseviç shfrytëzon mjeshtërisht çdo detaj, është ose jo i vërtetë. Mjafton që argumenti t'i shërbejë misionit të tij. Mjafton që ai ta ketë në mendje një ngjarje që nxin, një ngjarje që përlyen përpjekjen titanike të një populli të tërë.

Më tej vazhdon gallata allajuriseviçiane, shfrenimi i fantazisë së tij primitive deri aty ku nuk ta merr mendja. Sytë e tij djallëzorë shohin një "*dërrasë të zezë*" në sallën e operacionit, e cila ishte e vendosur "*mbi aparatin e narkozës*" siç shkruan ai. Në atë dërrasë të zezë dr. Vata kishte shkruar "*emrat e kosovarëve që ishin pranuar në spital mbrëmë deri në mëngjesin e sotëm*". "*Shumica e tyre,* - i thotë Vata, - *janë plagë me armë zjarri*". Dhe padiskutim Vata kërkon ndihmën e Juriseviçit duke i folur plot delikatesë kur i thotë: *"A do të kishit kohë të më ndihmonit? Ju lutem më thoni 'jo' nëse jeni i lodhur*". Çuditërisht në atë sallë operacioni, që sipas Juriseviçit ngjan me një kovaçhane, "*doktori*" sllavo-australian pranon ta ndihmojë Vatën për operacionet e planifikuara duke rrezikuar suksesin (absolutisht i rrezikuar është çdo pacient që operohet në sallën e operacionit *"konsensuale*" Vata-Juriseviç). Sepse së bashku me materialet dhe instrumentet sterile të operacionit bashkëjeton dhe "*dërrasa e zezë*" dhe "*shkumësi*" që shkruan në dërrasë emrat e pacientëve imagjinarë të planifikuar për operacion (!) Të arrish deri në këtë pikë është një guxim prej të çmenduri. Është as më shumë e as më pak se të deklarohesh kriminel me të thënë e me të shkruar!

Çast pune në sallë

Asnjeri me mend në kokë e me sy në ballë nuk e ka parë atë "*dërrasë të zezë*" në sallën e operacionit mbi aparatin e narkozës. Nuk e ka pare asnjë mjek që ka punuar në sallën e operacionit (fatmirësisht aty nuk ka punuar vetëm Vata e Juriseviçi). Nuk e ka parë asnjë infermiere që punon gjithë ditën e natën aty. Asnjë mjek i huaj nuk e ka parë "*dërrasën*" e Juriseviçit, asnjëherë. Nuk ka pasur dërrasë të zezë as shkumës në sallën e operacionit që kur është hapur për herë të parë në spitalin e Kukësit të Vjetër në vitin 1952 nga mjeku kirurg i nderuar i paharruar dr. Dhimitër Shyti, e deri më 29 prill 1999. Vetëm sytë djallëzor të Juriseviçit e shohin atë dërrasën e imagjinuar. Është shumë interesante të shpjegohet se si dr. Vata ka shkruar në "*dërrasën e zezë*" të Juriseviçit me "shkumësin" e Juriseviçit por me dorën e vet! Fol njëherë, o dr. Vata! E ke një detyrim profesional, njerëzor e patriotik. A e kupton se e ke një barrë shumë të rëndë mbi kurriz?

Si mund të besohet "*heroizmi*" i paimagjinueshëm duke konsideruar se njerëzit janë aq naivë sa t'i besojnë

"*heroizmit*" të tij!? E ai vijon e shkruan si për ironi se "*operojmë 16 orë rresht pa ndërprerje*". Imagjinata e shfrenuar e autorit ecë përpara pa u ndalur: "*Pacientja e parë është një vajzë 11 vjeçe e copëtuar nga një raketë serbe. Ende po i rrjedh gjak nga plaga e parregullt prapa gjurit dhe nuk ka lëkurë, copëza të arteries poplitea, yndyrën tendonin e këmbës dhe ligamentet. Nuk i ka katër gishtërinj të dorës së djathtë. Gjirin e majtë e ka të shkatërruar, kurse syrin e djathtë të shpërthyer. Ja amputoj (pres) vajzës këmbën e majtë mbi gju dhe dorën e djathtë mbi bërryl. Më duhet t'ia heq edhe syrin, nuk mund të 'shpëtohet'. Punojmë me aso shpejtësie saqë e huqa plagën hyrëse të një shrapneli të vogël të një burri, pjesën e poshtme të këmbës të cilën e kisha amputuar (prerë) më herët. Më duhet ta kthej me urgjencë për t'ia hapur abdomenin (!) mëlçia rridhte gjak. Përderisa merrem me trajtimin e tij, përpiqem të bëj orarin për pacientet e tjerë. Do të detyrohem t'i lë të vdesin ato që nuk mund të shpëtohen, por pa dhimbje dhe brenda mundësive që ofron spitali. E urrej veten për këtë, por po qe se jua dedikojmë kohën atyre që nuk kanë shpresë ato që mund t'i shpëtojmë do të vdesin para se t'i marrim në duar. Ky është brutaliteti i triazhimit në zonën e luftës*".

Duket se Juriseviçi dhe Vata po "*punojnë*" me "*ritëm*" e me "*intensitet të jashtëzakonshëm*" për të shpëtuar jetë njerëzish që po shkojnë drejt vdekjes së sigurt e të pashmangshme. Por edhe në ato rrethana të jashtëzakonshme biseda midis tyre vazhdon e qetë. Sepse bisedohet për problemet më të zakonshme e më të përditshme të Kukësit. Kur shkruan se "*Vata është shumë i sinqertë për kufizimet e veta pranon se po jep maksimumin, punon me vullnetin e një zelati (i zellshëm) dhe pa ankesën më të vogël*". Kurse për veten e tij Juriseviçi shkruan se "*kam ardhur nga rehatia e një shteti te pasur, aq larg nga ky stres represiv i të punuarit*

në një spital me administratë të korruptuar dhe të jetuarit krah për krah me hajna, banditë e dilerë droge".

Kur lexojmë ato që ka shkruar Juriseviçi, se ka punuar 16 orë rresht dhe ka kryer nëntë operacione nga të cilat tetë të suksesshme dhe vetëm një i vdekur në sallën e operacionit jemi të detyruar të shfletojmë me durim, me kujdes e me përgjegjësi të gjithë dokumentacionin e spitalit të Kukësit (kartelat klinike, regjistrin themeltar të shtrimeve në spital, regjistrin e shtrimeve për çdo pavijon, regjistrin e daljeve dhe çdo dokument tjetër plotësues). Të shfletojmë e të vlerësojmë të dhënat e veprimtarisë së sallës së operacionit si dhe të pavijonit të kirurgjisë dhe të reanimacionit për periudhën e krizës së rendë të eksodit të shqiptarëve të Kosovës në pranverën e vitin 1999. Duhet bërë kjo punë nga ne se tani ky komiku Juriseviç i ka thyer krejt drurët. Veç dokumentacionit që thamë kemi takuar të gjithë punonjësit e sallës së operacionit, pavijonit të kirurgjisë dhe të reanimacionit që kanë punuar në atë periudhë dhe ekzaktësisht atë kohë konkrete. Shumica e punonjësve shëndetësor punojnë edhe sot dhe janë fakt i gjallë. Dokumentacioni i plotë i sallës së operacionit dhe i pavionëve të spitalit ruhet në arkivin e spitalit që kur ky institucion është hapur e në vazhdim. Nga ana jonë është studiuar me vëmendje dokumentacioni për periudhën 27 mars 1999 deri më 12 qershor 1999, duke shfletuar çdo faqe, duke lexuar çdo rresht, duke evidentuar çdo veprimtari, duke pasqyruar çdo operacion me hollësi, për të pasqyruar e saktësuar se sa operacione janë kryer. Sa operacione ka kryer secili kirurg. Cilët kanë qenë asistentët (ndihmësit) në operacione. Cilët kanë qenë anestezistët. Cilët kanë qenë instrumentistët...duke i ballafaquar në çdo rast të dhënat jo vetëm nga kartelat klinike si dokumente bazë shkencor e ligjor për çdo të sëmurë që trajtohet në spital, por edhe me regjistrin e operacioneve që mbahet në sallën e operacionit e

ku pasqyrohet e dokumentohet çdo ndërhyrje kirurgjikale dhe që përputhet me pasqyrimin dhe dokumentimin e kësaj ndërhyrje në çdo kartelë klinike. Të gjitha të dhënat tona dëshmojnë se janë të sakta. Janë të pakundërshtueshme. Si luan as topi.

Dihet nga të gjithë punonjësit e shëndetësisë, institucionet e drejtësisë, institucionet ligjzbatuese dhe nga administrata shtetërore kudo në botë (natyrisht edhe në Shqipëri) se dokumenti bazë për çdo të sëmurë që shtrohet në spital është KARTELA KLINIKE. Kjo kartelë ka vlerën jo vetëm të dokumentit bazë shkencor e teknik, por edhe vlerën e dokumentit ligjor. Nuk e besojmë se Juriseviçi nuk e ka ditur këtë gjë (çdo mjek e di). Aq më tepër sot, kur ka marrë përsipër të gënjejë e të shpif në një libër kujtimesh.

Nga këqyrja e vëmendshme dhe me përgjegjësi e dokumenteve (kartela, regjistra e raporte të tjera) të pacienteve të shtruar në pavijonin e kirurgjisë dhe të reanimacionit nga 27 marsi deri më 12 qershor dalin të dhëna dhe fakte shumë të sakta e të pakundërshtueshme që nuk përputhen në asnjë rast të vetëm. E përsërisim, në asnjë rast të vetëm, me shpifjet, fantazitë dhe gënjeshtrat e Juriseviçit, me "*heroizmin*" e tij kirurgjikal dhe me "*punën*" dhe "*sakrificat*" e jashtëzakonshme të çiftit Juriseviç-Vata. Secili e ka të pasqyruar e të dokumentuar punën e tij aq sa ka arritur të bëjë. As më shumë e as më pak nuk ia shton apo nuk ia pakëson ndokush. Kjo është e vërteta. Kush ka pretendime është i lirë që të flasë e të japë versionin e tij. Nuk vërtetohet në asnjë dokument që më 29 prill 1999 të jetë punuar në sallën e operacionit 16 orë rresht, e as të jenë kryer nëntë operacione nga asnjë mjek. As nga dr. Mustafa. As nga dr. Ylberi. As nga dr. Shaqiri. Edhe mjekët anestezistë - reanimatorë, dr. Rexha, dr. Emini, dr. Arbeni e dr. Dukagjini, e hedhin poshtë gënjeshtrën e Juriseviçit. Edhe infermieret e sallës së operacionit Sadetja, Ilmija, Besa,

Medinja, Nazmija e Flora, e mohojnë njëzëri atë që shkruan Juriseviç. I vetmi dëshmitar që "vërteton" Juriseviçin mbetet dr. Vata. Askush tjetër. Por ai hesht, hesht…Hesht dhe heshtja e tij flet. Edhe nëntë operacionet nuk vërtetohen nga asnjë dokument. As në kartelat klinike. As në regjistrat e sallës se operacionit. As në regjistrat e pavijonit të kirurgjisë. As në regjistrat e reanimacionit. Askund! …Dhe dr. Vata hesht dhe vetëm hesht…!

VIII - Po cili është realiteti konkret?

Në këtë periudhë (27 mars - 12 qershor 1999) në pavijonin e kirurgjisë janë shtruar gjithsej 493 të sëmurë, prej të cilëve 270 ose 55% i janë nënshtruar operacionit që do të thotë se mesatarisht janë kryer tre operacione në ditë. Ky është fakti. Kjo është e vërteta. S'del dot ndryshe. Është e bezdisshme kur e përsërisim, por shumë herë i kemi kërkuar nëntë operacionet e çiftit Juriseviç-Vata, por kurrë nuk i gjetëm. Nuk i gjetëm për të vetmin fakt: ato operacione nuk janë bërë kurrë.

Disa ditë më vonë pasi e kisha lexuar librin në një diskutim me kolegë kirurgë që punojnë sot në spital dhe në sallën e operacionit të spitalit, doli se në sallën e operacionit të spitalit të Kukësit me kapacitetin njerëzor që ka në organike si dhe me sasinë e pajisjeve dhe aparaturave në dispozicion (tavolina apo shtrati i operacionit, aparati i anestezisë, ndriçimi i domosdoshëm dhe hapësirat e kufizuara) nuk mund të kryhen nga një kirurg nëntë operacione për 16 orë rresht. Është krejtësisht e pamundur në kushtet konkrete të sallës së operacionit në spitalin tonë. Edhe në klinikat dhe sallat e operacionit më moderne në botë operacionet (dhe ato më të thjeshtit) nuk mund të kryhen nga një kirurg i vetëm, por nga një ekip i caktuar i plotësuar rigorozisht me specialistë, duke filluar me kirurgun kryesor,

asistentët apo ndihmësit e tij, anestezist-reanimatorin, instrumentistin apo punonjës të tjerë shëndetësor ndihmës të domosdoshëm për mbarëvajtjen e operacionit dhe përfundimin e suksesshëm të tij. Unë për t'i ngacmuar pak kolegët i pyeta me shaka se po të funksiononte spitali i luftës (spitali nën tokë) a do të mund të realizoheshin nëntë operacione në ditë? Dikujt nuk i pëlqeu shumë kjo pjesë e bisedës, por unë u tregova një ngjarje që kisha jetuar vetë shumë vite më parë.

Në vitet 1980-1983 kam kryer detyrën e shefit të shëndetësisë të rrethit të Kukësit dhe po në atë periudhë filluan punimet për ndërtimin e spitalit nëntokësor. Atë kohë i thuhej spitali i luftës. Ndërtimi i këtij spitali u bë në kuadrin e plotësimit të gjithë punimeve nëntokësore të qytetit të Kukësit, i cili siç ishte mbi tokë ishte dhe nën tokë. Çdo objekt mbi tokë, çdo institucion mbi tokë ishte ndërtuar dhe funksiononte dhe nën tokë. Ishte psikologjia e kohës atëherë. Çdo pallat kishte të ndërtuar vendstrehimin poshtë tij. Para viteve 90-të shpesh i kemi parë gjatë alarmeve për të provuar gatishmërinë dhe kapacitetin e tyre në rast lufte. Kështu që edhe spitali i ri në Kukësin e ri (mbi tokë) që u përurua në maj të vitit 1974 u përforcua me spitalin nën tokë apo me spitalin e luftës. Interesante ishte në atë kohë fakti se kapaciteti i spitalit mbi tokë ishte 240 shtretër, ndërsa ai i spitalit nën tokë ishte 300 shtretër. Ishte i pajisur me hapësira dhe mjedise mjaft të bollshme në shërbim të sëmurëve në kohë lufte. Midis atyre që spikatnin në projektin e tij ishin ndërtimi dhe pajisja e tri sallave të operacionit.

Dr. Mustafë Mustafa, dr. Keti dhe Sadete Bala

Kur e vizituam një ditë spitalin nën tokë (vetëm pak kohë para se të vihej në funksionim), së bashku me disa drejtues vendorë dhe një i deleguar prej pushtetit qendror të asaj kohe, ndërsa inxhinieri i zbatimit të objektit na raportonte për kapacitetin, pavijonet, shërbimet, pajisjet dhe funksionimin e spitalit mua më bëri përshtypje fakti se ky objekt shëndetësor mbi tokë ka kapacitet 240 shtretër ndërsa ai nën tokë 300 shtretër. Ndaj e pyeta se pse spitali nën tokë e ka kapacitetin më të madh se ai mbi tokë, e pastaj shtova se pse spitali nën tokë duhet të ketë tri salla operacioni ndërsa ai mbi tokë ka vetëm një sallë operacioni? Përfaqësuesi nga Tirana ma hodhi dorën në qafë dhe më pyeti se sa vjeç isha. Kur i thashë se jam 36 vjeç ai me tha: "*Uroj të mos e arrish atë kohë, por dua të them se lufta është e pashmangshme. Trojet shqiptare janë të copëtuara, kombi ynë është i ndarë...Ky spital, është spitali i luftës dhe duhet të jetë i gatshëm qysh sot*".

IX – Dita tragjike e 31 majit 1999

Vetëm më 31 maj 1999 e kuptova realisht përgjigjen që më pat dhënë "*i madhi*" i asaj kohe në vitin 1983 për spitalin që kishim ndërtuar nën tokë.

Ka qenë një ditë e zezë, një ditë e keqe për spitalin, për qytetin e Kukësit, për gjithë qytetarët e Shqipërisë që ishin në në këtë qytet, për gjithë shqiptarët kudo që jetonin e punonin. Më 31 maj 1999 artileria e ushtrisë së Serbisë ka goditur forcat e UÇK-së që zhvillonin luftime në rajonin midis fshatrave Cahan dhe Pogaj dhe fshatrave përtej kufirit shqiptaro-shqiptar në zonën e Hasit e konkretisht në fshatrat Gorozhup e Planejë. Atë ditë forcat e UÇK-së patën shumë të plagosur dhe disa të vrarë. Me shpejtësi të gjithë punonjësit e spitalit të Kukësit u mobilizuan si asnjë herë tjetër. Duhej përballuar një volum pune i paparë deri në atë ditë. Me automjete të ndryshme u paraqitën në urgjencën e spitalit mbi 15 të plagosur, prej të cilëve 11 në gjendje shumë të rëndë. Një automjet i ushtrisë shqiptare solli katër ushtarë të UÇK-së të vrarë në fushën e luftimit. Të plagosurit menjëherë iu nënshtruan trajtimit mjekësor duke vënë në funksion dy sallat e operacionit (edhe te ORL-së) dhe duke mobilizuar gjithë personelin, infermiere dhe punonjës të tjerë shëndetësor. Meqenëse kapaciteti i sallës së operacionit nuk i përballonte gjithë atë fluks të madh të plagosurish dhe gjendja e tyre ishte shumë e rëndë, pa humbur kohë disa prej tyre u dërguan në spitale të tjera që funksiononin në Kukës. Një pjesë e tyre që u konsideruan më rëndë u nisën për në Tiranë. Më konkretisht dy të plagosur u dërguan në spitalin fushor në kampin italian. Dy të plagosur të tjerë u dërguan në spitalin fushor tek kampi i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe katër të plagosur u nisën për në Tiranë me anë të helikopterëve të qeverisë shqiptare dhe të UNHCR-s. Në sallën e operacionit të spitalit të Kukësit u operuan me

sukses tre të plagosur shumë rëndë. Ata iu nënshtruan ndërhyrjes kirurgjikale menjëherë pa asnjë vonesë. Vetëm organizimi i përsosur i shërbimit mjekësor në spitalin e Kukësit, përkushtimi dhe profesionalizmi i kirurgëve dhe i gjithë personelit mjekësor, ndërhyrjet e shpejta operatore dhe kujdesi i veçantë evituan vdekje të sigurta. Ky shërbim i menjëhershëm u bë faktori themelor që i tha vdekjes, ndal. Edhe të plagosurit e tjerë që u dërguan me shpejtësi në spitalet e kampeve që ishin në Kukës, por edhe ato që u dërguan në Tiranë mundën ta përballojnë vdekjen. Por edhe falë gatishmërisë dhe profesionalizmit të mjekëve dhe infermiereve që punonin në atë spital. Shqiptarët e dëbuar dhunshëm nga trojet e tyre do tu jenë gjithnjë mirënjohës mjekëve që shërbyen në atë kohë tragjedie njerëzore për ndihmën dhe kontributin e tyre të rëndësishëm në përballimin e gjendjes së rëndë sociale së vitit 1999. Dhe të mendosh se të gjithë ai aktivitet, gjithë ajo zhdërvjelltësi dhe organizimi i përsosur në menaxhimin e situatës më të vështirë shëndetësore që spitali i Kukësit ishte ndeshur ndonjëherë, përballimi me sukses të plotë dhe me rezultate absolutisht të shkëlqyera i asaj situate nga mjekët, infermieret, punonjësit e tjerë shëndetësore dhe stafi drejtues, flet qartë se spitali i Kukësit jo vetëm se e ka mbajtur peshën më të madhe të shërbimit shëndetësor, por e ka përballuar me sukses të plotë me rezultate të lakmueshme për çdo spital tjetër kudo që funksionon. Data 31 Maj e vitit 1999, puna e spitalit të Kukësit në atë ditë tejet të rëndë, më e rënda me të cilin ishte përballur spitali ndonjëherë, hedhin poshtë me neveri e me përbuzje shpikjet monstruoze, gënjeshtrat dhe akuzat kriminale të Juriseviçit. Dita e 31 majit e vitit 1999 e nxjerr atë lakuriq para opinionit duke ja hequr hamendjet e tij ogurzeza që shpik dhe fantazon paturpësisht.

***

Të kthehemi tek "*operacionet*" e Vatës dhe të Juriseviçit më 29 prill 1999 dhe deklarojmë se absolutisht i pavërtetë, absolutisht i trilluar është "*operacioni*" i vajzës 11 vjeçe që gjoja e ka bërë Vata e Juriseviçi. Bazuar në fakte kokëfortë që janë në arkivin e spitalit asnjë vajzë 11 vjeçe nuk është operuar jo vetëm me atë lloj operacioni që shpikë autori, por as me ndonjë operacion tjetër në asnjë ditë të asaj periudhe. Këtë e themi me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore sepse i kemi kontrolluar dhe i kemi analizuar disa herë kartelat klinike, regjistrat e sallës dhe të pavijoneve emër për emër, mbiemër për mbiemër dhe jo vetëm të moshës 11 vjeçe por që nga mosha 7 vjeç deri në 15 vjeç dhe nuk e kemi gjetur vajzën imagjinare të Vatës dhe Juriseviçit. Bile as djalë të moshës 7 vjeç deri në 15 vjeç nuk ka ndodhur të jetë operuar më 29 prill 1999. Apo jo, o dr. Vata?

Realisht kirurgun e aftë dhe të kualifikuar puna dhe mbingarkesa edhe mund ta lodhë, por kurrë nuk mund ta çojë në gabime teknike të asaj shkallë që mund të rrezikojë jetën e të sëmurit. Mjeku dhe kirurgu i vërtetë e viziton dhe e riviziton disa herë të sëmurin që do të operojë. I sëmuri vizitohet në momentin e shtrimit me kujdes e me hollësi për të gjitha organet dhe sistemet dhe çdo gjë shënohet në kartelën klinike të pacientit. I sëmuri vizitohet përsëri në pavijon dhe përsëri para se të futet në operacion, ku shënohet çdo gjë në kartelë dhe pasi plotësohet me analizat dhe ekzaminimet e domosdoshme duke u konsultuar detyrimisht me anestezistin, pastaj i vjen radha operacionit. Janë elementare për një mjek këto që them. Ky është një rregull që asnjë herë nuk shkelet, kjo është një procedurë që askush nuk guxon të mos e zbatojë.

Dhe këtë duhet ta dijë edhe Juriseviçi po qe se vetëm pak mjek mund të jetë. Ndryshe, jo nga lodhja se punon gjatë e pa ndërprerje, por nga paaftësia dhe me keq akoma pakujdesia apo neglizhenca për të vizituar me kujdes dhe për

të diagnostikuar saktë një të sëmurë që do të operohet, mund të çojë në rrezikimin ose humbje të jetës së pacientit. Turp i madh, kur në paçavuren e vet autori shkruan se "*punojmë me aso shpejtësie sa që e huqa plagën hyrëse të një shrapneli të vogël te një burrë, pjesën e poshtme të këmbës se të cilit e kisha amputuar më herët. Më duhej ta kthej me urgjencë për t'i hapur abdomenin*". Hajde kirurg hajde!

Fat i madh është se Juriseviçi realisht nuk mund të ndikojë për keq në shëndetin e të sëmurëve. Kjo për arsye se të sëmurët dhe të plagosurit që i "*mjekon*" dhe i "*operon*" nuk janë të vërtetë. Ato që përrallisë ai nuk janë reale. Janë vetëm në kokën e tij. Prandaj edhe në rastin që e huqi plagën mos u merakosni nëse do ta hapte më herët apo më vonë apo s'do ta hapte fare abdomenin (barkun) e të sëmurit imagjinar, të sëmurit që s'është i vërtetë, të sëmurit që nuk ekziston. Të ëndërrosh të bësh një operacion kirurgjikal nuk është njëlloj sikur e bën vërtetë operacionin kirurgjikal. Por këtë nuk e di "*kirurgu*" sllavo-australian. Kaq!

Duam t'ia kujtojmë edhe Vatës duke ia përsëritur se për një kirurg të vërtetë, operacionet që i "*bën*" në ëndërr nuk janë njëlloj si operacionet që i bën në sallën e operimit. A mos vallë i keni ëndrrat e njëjta me Juriseviçin? Fol një herë? I dehur nga "*suksesi*" i "*punës*" së tij (punë siç e kemi provuar nuk ekziston dhe nuk vërtetohet me asnjë dokument e asnjë dëshmitar) në orën 02.00 të natës del nga spitali, pasi kontrollon dhe pacientin e fundit, niset në këmbë nën dritën e yjeve për në banesë. '"*Jam i dërmuar, por plotësisht i gëzuar që më në fund po e punoj punën për të cilën kam ardhur. Ndalem nën yjet duke u kënaqur me qetësinë, heshtjen*", - shkruan Juriseviçi. Por vetëm të kujtojmë motin e ftohtë e me shi të atyre ditëve e sidomos të asaj dite e nate për të cilën shkruan "*doktori*" sllavo-australian dhe kështjella Juriseviç shkërmoqet në çast! Në kohë të keqe, në kohë të ftohtë dhe me shi nuk besojmë se dikush i sheh yjet në qiell

veç djallit (larg qoftë siç thonë plakat). Në Kukës banonin në atë periudhë rreth 200 deri në 300 mijë njerëz, në një hapësirë që ishte për 20 deri në 25 mijë banorë. Prandaj të ardhurit nga Kosova ishin të detyruar të vendosen kudo. Në sheshet, në rrugët, në hapësirat midis pallateve, në oborret e shkollave, në sheshet para institucioneve në trotuare, në Zabel (midis lisave) dhe kudo ku gjendej një copë tokë e lirë. Kishte lëvizje të jashtëzakonshme të njerëzve (të ardhur dhe vendas) të automjeteve të shumta të institucioneve, të mediave kombëtare e ndërkombëtare, të organizatave dhe shoqatave (të ardhura nga të katër anët e botës) që ishin vendosur në Kukës, të ambulancave të spitaleve që u hapën në kampet e refugjatëve, të automjeteve të shumta të ushtrisë dhe policisë dhe ne jemi dëshmitarë, se në atë kohë, asnjë njeri i ndodhur në Kukës nuk e kishte privilegjin të shijonte qetësinë dhe heshtjen as ditën e as natën, pos Juriseviçit. I vetmi që duket se e ka "*qetësinë*" dhe "*heshtjen*" dhe që i ka "*vështruar*" edhe yjet në qiellin e mbuluar me re të dendura dhe në kohë me shi është djalli Juriseviç!

Një gjë nuk e kuptojmë se ç'ndjen e çfarë frike ka kur thotë se "eca 30 metrat e fundit drejt banesës duke ia premtuar vetes disa fraza që përfunduan në tri fjalë të thjeshta: "*Mos vdis, idiot*"! Çdo njeri i vëmendshëm dyshon se ky njeri (Juriseviçi- M.B.) diçka fshihte, sepse ka aq shumë frikë nga një aksion humanitar (!) për të cilin duhet të jetë krenar e ballëlart e jo të frikësohet aq sa të kujtojë vdekjen orë e çast! Dhe kjo frikë kaq e madhe, sapo ka ardhur në Kukës (saktësisht ditën e dytë në Kukës) të bën të mendosh se Juriseviçi dhe frika kanë udhëtuar së bashku që kur u nisën nga Adelajde për në Kukës.

Domosdo që misioni i tij i vërtetë nuk është misioni humanitar. Është një mision tjetër tejet i vështirë dhe i rrezikshëm për këllqet e një "*doktori kirurg*". Prandaj mbijetesa e shtyn t'i thotë vetes "*Mos vdis, idiot*". Të

nesërmen në mëngjes zgjohet herët, por me dhimbje koke, pavarësisht se kishte fjetur "*për mrekulli*". Bie në sy "*interesimi i veçantë*" i Juriseviçit për pacientët e operuar dje të cilët ai i do të vdekur, të keqtrajtuar ose të torturuar. Dhe çuditërisht ashtu i gjen kur kthehet në pavijon herët në mëngjes. Fillimisht viziton sallën e operacionit, të cilën e përshkuan bash ashtu si ia do shpirti i tij i zi dhe misioni djallëzor që ka marrë përsipër. Pa pikë turpi e përgjegjësie njerëzore shkruan se "*Një myk i gjelbër me ngjyrë hiri e ka kapluar gjithë vendin dhe njëri mur është spërkatur me gjak të tharë prej dyshemesë e deri në lartësinë një metër*" (!) Thua se salla të ketë qenë ndonjë vend masakrimi, apo thertore. Vetë tavolina e operacionit sipas tij është e drurit, jo stabile dhe e pamundur të dezinfektohet. "*Instrumentet, ato vegla pune që dje më dhanë gjithë atë kënaqësi, janë mbushur me ndryshk, punoja me aq shumë shpejtësi e përdorja gjithçka që më përplasej në dorë*". Shiko deri ku i shkon fantazia! Nuk thotë asnjë të vërtetë, por vetëm shpif, gënjen e fantazon kur shkruan për sallën e operacionit, për tavolinën e operacionit, për instrumentet që përdoren në sallë dhe për aparaturat e pajisjet e saj duke përlyer ndërgjegjen e tij me shprehje që bien ndesh me shprehjet që thotë një njeri me tru normal e me ndërgjegje normale. Salla e operacionit është një mjedis krejt i veçantë i çdo spitali dhe rigorozisht plotëson disa standarde që askush nuk guxon të mos i plotësojë e të mos i zbatojë. Salla e operacionit e spitalit të qytetit të Kukësit është projektuar e ndërtuar nga inxhinierë specialistë të kualifikuar. Kështu jo vetëm se i plotëson të gjitha standardet e detyruara nga anën ndërtimore dhe funksionale, por edhe për pajisjet dhe aparaturat bashkëkohore për të realizuar me sukses gamën e operacioneve për një spital rajonal. Salla e operacionit monitorohet rreptësisht për ngarkesën mikrobiale me përgjegjësi të lartë jo vetëm profesionale, por edhe ligjore,

duke u dokumentuar çdo gjë me saktësi. Sa për instrumentet e ndryshkura të Juriseviçit, çdo mjek, çdo infermier, çdo punonjës tjetër në spital (si kudo në botë) e ka të qartë krimin që bën nëse në ndërhyrjen kirurgjikale do të përdoren instrumente të ndryshkura. Sidomos të ndryshkut të shpikur allajuriseviçjan. E pavërteta nuk mund të shërbehet si e vërtetë në asnjë rrethanë dhe nga asnjë njeri normal. Kjo mund të bëhet vetëm nga një kriminel, i cili mision të vetëm ka krimin. Mund të bëhet vetëm nga Juriseviçi, "*humanisti*" me bluzë të bardhë e me shpirt katran. Kur "*punon*", kur "*kryen*" operacione, kur është me Vatën nuk e shikon ndryshkun. Nuk e sheh as plagën hyrëse (shpuese) në barkun e pacientit. Madje as që i intereson t'i shohë. Krejt ndryshe qëndron puna kur i mbledh mëndët në funksion të misionit të vërtetë që i është ngarkuar. Vetëm atëherë vëren e shënon çdo detaj, bile edhe kur nuk është detaj real.

Si nuk e paska ditur Juriseviçi (çudi si nuk ia paska thënë dr. Vata e Milaimi) se spitali i Kukësit është rikonstruktuar dhe është pajisur me aparatura moderne! Sidomos salla e operacionit ka qenë në kohë rikonstruksionesh në qendër të vëmendjes. Pas vitit 1994 të gjitha pajisjet dhe aparaturat e spitalit janë zëvendësuar me pajisje e aparatura të reja të prodhimit gjerman. Duke filluar nga tavolina e operacionit, aparati i anestezisë, ndriçimi dhe çdo gjë tjetër e domosdoshme për një sallë operacioni bashkëkohore. Me kërkesën dhe insistimin e qeverisë shqiptare, qeveria gjermane financoi rikonstruksionin dhe pajisjen e spitalit të Kukësit me përparësi dhe kjo u bë. U bë sepse, siç thotë specialisti me përvojë i investimeve në Ministrinë e Shëndetësisë, inxhinier Kristo Harxhi "*duhet të ishim të përgatitur për situata të pritshme dhe mbingarkesën e spitalit të Kukësit në një konflikt të parashikuar ushtarak në Kosovë*". Investimet u kryen në vitet 1993-1994 dhe ra në sy jo vetëm impenjimi maksimal i qeverisë së Shqipërisë,

por edhe interesimi i veçantë i shtetit gjerman u duk mjaft qartë në atë kohë duke ndjekur e kontrolluar nga afër punimet me specialistë të kualifikuar. Të gjithëve na kujtohet se vetë ambasadori i Gjermanisë e ka vizituar spitalin e Kukësit gjatë kohës së rikonstruksionit dhe të instalimit të pajisjeve dhe të aparaturave të ardhura nga vendi i tij. Nuk besojmë se Juriseviçi s'është i njohur me financimet e qeverisë gjermane për pajisjen e spitalit të Kukësit, por edhe nëse e di këtë fakt, është i detyruar që në paçavure të shkruajë "*tavolina e operacionit është prej druri...*". Sepse në këtë mënyrë misioni i tij ia dikton. Mirëpo nuk e beson njeri në botë për ato që shkruan. Nuk beson njeri në botë se shteti gjerman prodhon tavolinë operacioni prej druri apo instrumente operacioni të ndryshkura. Por megjithatë ato fjalë helm për investimet në spitalin e Kukësit nga paçavureshkruesi Juriseviç, njerëzit e thjeshtë, punonjësit e spitalit të Kukësit dhe të gjithë qytetarët e Kukësit i janë mirënjohës popullit dhe shtetit gjerman për këtë ndihmë bujare.

Jemi të bindur se nuk ka Juriseviç, e as "*viç*"-ër të tjerë në botë që të mund ta nxijnë atë ndihmë që bëri të mundur jo vetëm rikonstruksionin e godinës së spitalit të Kukësit por edhe pajisjen me aparatura e instrumente të fjalës së fundit. Një shpifje që kalon çdo cak, një shpifje monstruoze. Një rrenë me bisht pa kufi që të indinjon, të revolton e të bën të vjellësh. Juriseviçi pasionant negativ nuk përmbahet, por shkruan më tej se "*të dyja infermieret e caktuara të punojnë në sallë sot hynë brenda. Gati as që më regjistrojnë bile. Të dyja i përshtaten shumë mirë mjedisit dekadent të sallës. Njëra është e dehur kurse tjetra nuk mund t'i mbajë sytë hapur, krahët i ka përplot me vraga injeksionesh*" (!!) O Zot, a nuk e sheh se në këtë tokë ka edhe njerëz të paskrupullt, të padinjitet e zvarranikë? Mirëpo ja që paska edhe të tillë, paska edhe Juriseviçë!

Gjithkush që e lexon këtë libër qesh, qesh hidhur dhe e flak poshtë këtë libër krejtësisht të pavlerë. Kush është ajo mendje kuksiani e shqiptari që beson në një ëndërr të mendjes së tij? Asnjë infermiere, asnjë punonjëse e spitalit të Kukësit nuk ka qenë përdoruese e alkoolit dhe e drogës. Asnjë infermiere e sallës së operacionit nuk ka përdorur kurrë as alkool e as drogë. Asnjë infermiere e asnjë punonjëse e spitalit të Kukësit as atëherë e as sot nuk është përdoruese e alkoolit e drogës dhe kjo lidhet me traditën, moralin e praktikën tonë të rregullt jetësore. Të fyesh e të shpifësh kaq rëndë, të akuzosh nënat dhe motrat tona të shtrenjta, punonjëset tona të ndërgjegjshme, infermieret tona të afta, të përgatitura, të gatshme në çdo çast pa asnjë pretendim për të shërbyer me cilësi e kompetencë profesionale, është jo vetëm krim, por edhe zemërligësi. Zoti i Madh dhe e vërteta historike me fakte kokëfortë e ndëshkon ashpër librin dhe autorin e tij. E ndëshkon me harresën dhe përçmimin për të.

Ato infermieret që i ka parë në ëndërr si të dehura e të droguara, janë edhe sot në punë si punonjëse shëndetësore plot dinjitet të nderuara e të respektuara. Ashtu sikurse janë nëna dhe edukatore të mrekullueshme të fëmijëve të tyre. Të tilla kanë qenë gjithmonë dhe gëzojnë respektin dhe nderimin nga gjithë qytetarët e Kukësit. Ato janë bijat që e nderojnë popullin e Kukësit. Kanë emër dhe mbiemër, nuk janë anonime si në mendjen e tij skizofrenike. Ato quhen: Sadete, Ilmije, Besa, Medine, Nazmije e Flora dhe ndjejnë jo vetëm keqardhje, por edhe urrejtje të thellë e të ligjshme për "*njeriun*" që me bluzë të bardhë, me bluzën shumë të nderuar e të respektuar të mjekut ka kryer një mision të lig. Mision të poshtër e djallëzor për t'i treguar botës se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"! Jemi të detyruar ta identifikojmë Juriseviçin me termin "*njeriu*" sepse prezenca e tij në sallën e operacionit vetëm një herë si asistent i Vatës

nuk i ka dhënë askujt mundësinë që t'ia mësojë emrin asistentit e njëkohësisht "*shefit*"! Nuk është faji i Sadetes, Ilmijes, Besës, Medines, Nazmijes, Florës e Xhemiles pse s'ia mësuan emrin Juriseviçit në atë kohë.

X -Aventura e "*kirurgut*" vazhdon

Të kthehemi tek "*pacientet e operuar*" një ditë më parë prej tij dhe dr. Vatës. Do të shohim sesi djallit i dalin ëndrrat si të vërteta! Ai shkruan se "*nisem nga repartet për të shikuar ç'po ndodh me pacientët tanë, në mos i kanë hedhur apo bartur diku. Prej asaj që kam parë edhe kjo është e mundur*". Vetëm disa orë në spital i duhet të shohë Juriseviçi dhe të dalë në përfundimin që do, në përfundimin që ia kërkon misioni i tij kriminal. Të gjithë mendojmë se Juriseviçit i dalin ëndrrat si të vërteta. Për shkak se ai "*punon*" dhe "*lufton*" në funksion të detyrës së tij misterioze. Prandaj atij i mjafton t'i planifikojë ëndrrat që duhet t'i shohë e t'i "*shohë*". Për t'i shitur ëndrrat si të vërteta; ky është zanati i tij kryesor. Kështu që s'ka si mos t'i gjejë repartet, "*një hendek vuajtjesh dhe kundërmimi*", kur vetë i ka parë në ëndërr. Dhe shkruan më tej shpjegimin e ëndrrës së vet në mënyrën më "*shkencore*" duke vazhduar të shkruajë në paçavure se "*duket si Ferri i Dantes, por me dallim që këta njerëz nuk po dënohen për mëkatet e tyre...*", e më tej "*shtrat pas shtrati plagë që keqësohen, shtrat pas shtrati dhimbje dhe pa shpresë. Korridoret janë gati të zymta dhe pa ajër. Ky është një version i Ferrit, pa dyshim. Më keq s'ka ku shkon*". Një mjedis dhe atmosferë e tillë kirurgjie kafkiane në spitalin e Kukësit nuk ka ekzistuar asnjëherë. Është përsëri shprehje dufi urrejtje. Fantazi dhe imagjinatë e dalë prej skutave të errëta të mendjes diabolike të Juriseviçit për ta shitur si mall në tregun e poshtërsisë!

Njerëzit që kanë jetuar në atë kohë në Kukës, të sëmurët që kanë qenë të shtruar, vizitorët e përditshëm në spital, mediat e shumta lokale, kombëtare e ndërkombëtare nuk e kanë parë asnjëherë as "*Ferrin e Dantes*" e as "*Ferrin imagjinar të Juriseviçit*". Po të ishte ndryshe s'do të ishte e mundur që asnjeri, asnjë personalitet dhe asnjë media të mos e vërente e të mos e bënte publike "*katastrofën*" që e paska parë vetëm syri i i keq e i vëmendshëm i shkruesit të këtij libri. Por Juriseviçit i duhet ta "*shohë*" se s'bën, është i detyruar ta shohë. Prandaj dhe e "*sheh*" dhe e shkruan në paçavure. Është stili i tij, stili i tij i detyruar. Asnjë personalitet ndërkombëtar, asnjë përfaqësues i institucioneve apo organizmave ndërkombëtare (OKB-ja, OBSH-ja, NATO-ja, BE-ja, SHBA-t, UNHCR-ja) nuk e kanë parë në atë kohë "Ferrin e Dantes" as "*Ferrin e Juriseviçit*" jo për inatin e tij porse kurrë nuk ka ekzistuar realisht! Jashtëqitja nga goja e Juriseviçit nuk ka të ndalur duke konkurruar me diarrenë kolerike kur më tej shkruan "*qëndroj pranë shtratit të një djaloshi katër vjeçar, i cili më shikon; e ka këmbën e majtë të amputuar nën gju, ndërsa krahun e djathtë nën bërryl. Nën shtrat një grua që duket se është nëna, po e lëkund trupin e vdekur të një fëmije më të vogël mbase një vjeç e gjysmë. Do të ketë vdekur natën. Mbase nuk e di që fëmija i ka vdekur. Apo mbase e di por e ka humbur aftësinë për të reaguar*". Përralla të denja për një aventurier sharlatan. Mendon e shpreson se me këtë stil shkrimi dhe imagjinate mund të mbushë mendjen e ndonjë institucioni autoritar kinematografik për ndonjë film. Mendon e shpreson se do të bëhet i famshëm duke marrë nëpërkëmbë dinjitetin e një populli të tërë. Çfarë maniaku mostër! Nejse. Asnjë dokument zyrtar i arkivit të spitalit, asnjë punonjës i kirurgjisë, vizitor a media nuk e vërteton atë skenë allajurisheviçiane atë skenë aq tronditëse e cila thjesht asnjëherë s'ka ndodhur. Nuk rezulton të jetë shtruar e të jetë

operuar në pavijonin e kirurgjisë asnjë fëmijë me amputim, as të këmbës e as të dorës. Kjo nuk ka ndodhur jo vetëm në "*ditët*" e Juriseviçit në Kukës por as që nga 27 marsi deri më 12 qershor 1999. Bile as më parë e as më pas atyre datave. Kjo është e vërteta dhe vetëm e vërteta.

Një mjek kardio-kirurg (siç prezantohet Juriseviçi) i ardhur nga Australia shumë shpejt i transformuar në një kirurg që vetëm "*krasitë*" njerëz dhe vetëm pret aq shumë këmbë e duar në pacientët e tij imagjinarë. Aq sa që ky lloj "*doktori*" i paparë e dëgjuar duhet të pajiset me një dokument shtesë apo "*diplomë*" ku të shkruhet: "*Mjek kirurg, prerës duarsh dhe këmbësh me shumicë dhe pakicë*". Po ku ia zë goja e ia bën dora të flasë e të shkruaj për këmbë e duar të prera.

Për periudhën 27 mars - 12 qershor 1999, në sallën e operacionit të spitalit të Kukësit janë kryer vetëm tri amputime (prerje) nga të cilat asnjë prej tyre tek fëmijët. E theksojmë, asnjë tek fëmijët. Edhe në tre rastet e amputimit, vetëm njeri prej tyre, i sëmuri kosovar me inicialet S.J. vjeç 71, me nr. kartelë 2277 është amputuar nga dr. Vata më 26 maj 1999, e që çuditërisht, në kartelë, kur dokumentohet me shkrim operacioni shkruhet edhe emri i Juriseviçit. Theksojmë emër i shkruar fiktivisht sepse Juriseviçi kishte dhënë dorëheqjen si mjek i IMC dhe ç'ka është më e rëndësishme as dr. Rexha (anestezisti), as Besa (instrumentiste në atë operacion) dhe as ndonjë infermiere tjetër e sallës së operacionit nuk e pohojnë se Juriseviçi t'i ketë asistuar dr. Vatës në atë ndërhyrje kirurgjikale. Edhe një herë na duhet të themi se atë ditë, më 26 maj 1999 duket se vetëm dr. Vata e mban mend "*prezencën*" e Juriseviçit në operacion. Autori "kirurg" ka harruar se pikërisht atë ditë kishte dhënë dorëheqjen si mjek kirurg vullnetar i IMC-s dhe kishte vendosur të shkonte "*vullnetar*" në krah të UÇK-së. Nuk mund të kryente më dy funksione njëherësh; "*krasitësh*"

këmbësh e duarsh dhe "*vullnetar*" i UÇK-së! Apo jo? Jo për t'i mbushur mendjen Juruseviçit por për të pohuar të vërtetën e asaj kohe, jemi të detyruar të përsërisim se nga shfletimi i çdo kartele klinike, nga rakordimi i çdo kartele me regjistrin e shtrimit të pavijonit të kirurgjisë e të reanimacionit, rezulton se në periudhën 27 mars-30 qershor 1999 në sallën e operacionit janë kryer vetëm tri amputime (prerje) dhe në tri rastet pacientet kanë qenë meshkuj të moshës madhore (22, 60 e 71 vjeç). Janë amputuar vetëm këmbë dhe jo duar. Një pacienti i është prerë këmba e djathtë, një pacienti tjetër i është prerë këmba e majtë dhe të tretit i janë prerë të dyja këmbët. Siç del nga dokumentacioni dhe nga dëshmitë e punonjësve që kanë punuar në sallë, në kirurgji e në reanimacion nuk është bërë asnjë amputim as i këmbës as i dorës në asnjë fëmijë. Absolutisht në asnjë fëmijë!

Një gjë këtu nuk mund të shpjegohet dot, heshtja e Ylber Vatës. Dr. Vata pse hesht, pse nuk reagon, pse vazhdon ta revoltojë personelin e sallës së operacionit dhe opinionit edhe sot e kësaj dite? Këtë e di vetëm ai dhe askush tjetër. Ndërkohë që me siguri libri do t'i ketë rënë në dorë dhe do ta ketë lexuar! Në atë kohë dr. Vata ka kryer edhe detyrën e shefit të kirurgjisë dhe i ka drejtuar ato kolegë dhe kolege në zbatim të realizimit sa më të mirë të shërbimit shëndetësor. Pikërisht për këtë është i detyruar të flasë e të dëshmojë të vërtetën. Në takime e biseda me kolegët, me infermieret dhe me punonjësit e tjerë me të cilët ka punuar dhe i ka drejtuar, me të drejtë shprehen se kanë dyshime të arsyeshme. Ato e dinë fort mirë se dr. Vata është ndihmësi, përkrahësi dhe informuesi i Juriseviçit për ato pak ditë të qëndrimit të tij në Kukës. Nëse vazhdon shefi i kirurgjisë të heshtë, doemos dyshimi i punonjësve të spitalit dhe i të gjithë kuksianëve, i të gjithë shqiptarëve do të shndërrohet në akuzë e drejtpërdrejtë. Një malësor fisnik, një atdhetar, një njeri i mençur ka thënë: "*Të keqin nuk e kam kurrgjë" dhe*

çuditemi në hezitimin e pashpjegueshëm, në heshtjen fajtore. Ka pasur fatkeqësi populli shqiptar në historinë e tij mijëravjeçare, por me e madhja fatkeqësi ka qenë se Skënderbe kanë lindur rrallë e Hamza më shpesh. Juriseviçi fyen pashpirtërisht, në mënyrën më skandaloze nënat shqiptare dhe gjithë nënat në botë kur në paçavure shkruan: "nëna po lëkundte trupin e vdekur të një fëmije një vjeç e gjysmë... Mbase nuk e di se fëmija ka vdekur, mbase e di, por e ka humbur aftësinë për të reaguar... Po e shikoj njërën nga tragjeditë më elementare njerëzore, nënën që e përqafon trupin e pajetë të fëmijës dhe reagimi im është i mëshirshëm, ndjej gjynah". Ne mjekët pediatër jemi dëshmitarë të përhershëm të aftësisë dhe dhuntisë se çdo nënë për të përcaktuar me saktësi gjendjen e fëmijës së saj në çdo moment; kjo është një dhunti që Zoti ua ka dhënë vetëm nënave. Na ka ndodhur e na ndodh shpesh, kur nëna vetëm sapo e prekë fëmijën me buzët e saj përcakton temperaturën e trupit njësoj si termometri, apo monitoron ose ndjek me vëmendje gjendjen e fëmijës së saj njëlloj sikur mjeku. Sepse për fëmijën nëna sakrifikon ushqimin, gjumin dhe shëndetin e saj, në kërkim të ndihmës mjekësore për fëmijën në çdo orë të ditës apo të natës. Unë, në vitin e parë të punës, si mjek pediatër në spitalin e Kukësit (1971) mbasi vizitova një fëmijë vendosa ta shtroja në spital dhe fillova të shkruaj kartelën. Dëgjova nënën që fliste me fëmijën (vetëm gjashtë muajsh) që i thoshte: "*drita e nënës, nëna të ka dritë syri...*". Instinktivisht unë në kartelë shënova emrin "Drita" kur ajo në fakt e kishte Albana!

O nëna të dashura të gjitha kohërave, o nëna të dashura kudo që jeni, o nëna të shtrenjta që Zoti i Madh ju ka dhënë privilegjin më të madh dhe detyrën më themelore në këtë botë; lindjen dhe zhvillimin e jetës njerëzore, përbuzeni e përçmojeni djallin Juriseviç! Përulemi me respektin më të thellë para nënave tona të mira duke ju kërkuar falje. Më

duket sikur i lëndojmë kur në faqet e librit ku shkrova NËNË, shkrova dhe emrin e djallit! Më falni, o nëna! Iu thaftë ajo dorë këtij "kirurgu" mostër kur shkruan me poshtë se "*i gjeta vetëm katër pacientet e mi....*" dhe *''Nëna e fëmijës, të cilit ja amputova këmbën...*" duke e përsëritur pafund amputimin "*operacionin*" tënd të preferuar, "*operacionin*" tënd të adhuruar. Po cilin amputim? Përsëri shkruan për amputimin e këmbës së një fëmije. Fëmijë pa emër, pa mbiemër, pa iniciale, pa numër kartelë klinikë. Fëmijë anonim që nuk ekziston veçse në mendjen e sëmurë. Juriseviçi siç i kishte parashikuar ëndrrat t'i "*shohë*", ashtu i "*sheh*" edhe në pavijon Në pavijon sipas tij, nga tetë pacientë të operuar gjeti vetëm katër prej tyre (!) Pse ishin zhdukur? Sepse vetë djalli kishte vendosur t'i zhdukte. E kemi vërtetuar dhe e kemi thënë tashmë, se nuk ka pasur as tetë pacientë, as katër pacientë, asnjë pacient të operuar në ditën 16 orëshe pa ndërprerje të "*punës operatore*" të çiftit Vata-Juriseviç. Dokumentacioni i spitalit është kokëfortë. Po ku ndalet stili kriminal i Juriseviçit!? Ai vazhdon të shkruajë se "*tre prej katër të zhdukurve u ishin amputuar gjymtyrët*" dhe kishin edhe "*dëmtime në abdomen e kraharor, për të cilën ishte ndërhyrë në mënyrë kirurgjikale*". Përsëri amputime, amputime dhe vetëm amputime kur e dimë të vërtetën e amputimeve dhe s'ia vlen të merremi më me të amputuarin Juriseviç. Duke biseduar me veten e vet ai bën sikur pyet infermieren, të cilën e përshkruan hollësishëm dhe me kujdes: "*Duket se është vetëm në të njëzetat, por flokët i ka të hollë dhe tashmë kanë filluar t'i thinjen*" dhe e pyet se "*ku janë katër pacientët e tjerë*" sepse sipas tij nuk po i gjen. "*Një ka vdekur*", - i thotë ajo dhe "*nuk po mund të ma thotë emrin, por nga përshkrimi që e bën është vajza e vogël me amputim të dyfishtë*". Po pse djalli "*kirurg*" nuk ia përmend emrin asaj vajze dhe jo vetëm asaj. Nuk i zë emër asnjë të sëmuri, asnjë të plagosuri, asnjë të vdekuri, asnjë të shtruari,

asnjë infermiereje, asnjë punonjësi në asnjë faqe e në asnjë rresht të paçavures të vetëquajtur libër. Pse nuk përmend asnjë datë, asnjë ditë, asnjë bashkëpunëtor gjatë punës që gjithsesi i duken "heroike", por që realisht nuk mund të realizohet pa ndihmën dhe kontributin e gjithë ekipit të sallës së operacionit. Nuk besojmë se vetëm kontributi i Vatës dhe i Milaimit janë të mjaftueshëm për "*heroizma*" në shërbimin mjekësor. Si është e mundur që përshkruani me hollësi e saktësi të "*sëmurët*" me plagët, me duart e këmbët e prera, llojin e plagëve që u ka shkaktuar secila armë e llojit dhe kalibrit që vetëm Juriseviçi e di dhe nuk thotë absolutisht asnjë emër, asnjëherë? Si është e mundur që përshkruan me hollësi çdo infermiere sikur ato janë të dehura, janë të droguara, janë me flokë të holla...e nuk thotë asnjë emër, asnjëherë? Si është e mundur që Juriseviçit kur ia kërkon nevoja të "*dokumentojë*" një ngjarje të ndodhur në spital "*rastësisht*" dëshmitarë janë ose dr. Vata ose Milaimi ose të dy së bashku? Askush tjetër! Duket qartë se këta të dy janë edhe dëshmitarët edhe ndihmësit edhe informatorët e tij. Duket si interesante, por jo aq sa duket në të vërtetë. Sepse në të vërtetë është fatkeqësi! Ne nuk duam ta besojmë këtë fakt të dhimbshëm, por ai jo vetëm që është kokëfortë por edhe i vendosur. Derisa gjer më sot ato dy njerëz (dr.Vata e Milaimi) me gojën e të cilëve flet Juriseviçi gjithnjë nuk po reagojnë e as nuk po bëhen të gjallë, ne po e lëmë në ndërgjegjen e lexuesit ta vlerësojë (secili sipas analizës dhe logjikës së tij).

Edhe më tej Juriseviçi kërkon ndihmën e Vatës dhe Milaimit për të treguar përrallën e "*zhdukjes*" se katër pacienteve të tij (që ishin edhe të Vatës po të ishin reale) dhe ato vijnë në një çast shumë të dëshiruar për Juriseviçin kur shkruan: "*Në fund të korridorit një infermiere po e rrihte një djalosh me këmbën e plagosur. Në fakt ajo i ishte sulur djaloshit; qëllimin e kishte t'i shkaktonte dhimbje*" (!) Edhe

kafshët e të njëjtit lloj ndeshen dhe luftojnë me njëri-tjetrin derisa ndodhë që njeri që plagoset "*dorëzohet*" apo largohet, ndërsa fituesi e ndërpret luftimin menjëherë në shenjë respekti për llojin. Mirëpo ç't'i thuash "*kirurgut*" Juriseviç! Edhe kafsha mendon e gjykon më mirë se kjo mostër djallëzore me fytyrë njeriu kur thonë se "*në fakt ajo (infermierja që është njeri) i është sulur djaloshit (që edhe ky është njeri), qëllimin e ka t'i shkaktojë dhimbje*". Me këto histori të paqena mendon se e ulë shqiptarin deri në atë nivel sa të bindë të tjerët se te shqiptari është e pranishme egërsia shtazarake. Është sipas tij i pranishëm instinkti shtazarak që të vrasë e të torturojë! Çfarë zemërligësie e urrejtje për Shqipërinë e shqiptarët! Vetëm djalli e bën këtë (më saktë mundohet ta bëjë) në funksion të misionit të fëlliqur që ka marrë përsipër se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"!. Por edhe vetë e di se ato që shkruan e thotë nuk janë të vërteta, por puna ia do kështu. E për t'i vënë kapakun ngjarjes imagjinare vazhdon ta përshkruajë nga larg përleshjen e nënës së djaloshit me infermieren në mes të pavijonit. Në mes të njerëzve, në prani të përkthyesit (Milaimit), megjithëse përleshja nuk ka nevojë për përkthim se është një ndodhi që kuptohet prej të gjithë njerëzve pavarësisht gjuhës me të cilën flasin. E në këtë rast Milaimit nuk i bie të jetë përkthyes, por dëshmitar i vetëm kur "*një roje i armatosur hyn në mes tyre (infermieres dhe nënës së djaloshit) dhe e hedh nënën e djaloshit përdhe duke e goditur kondakun e pushkës në shpinë*" dhe vazhdon "*mbase kam bërtitur pa qëllim, ngase roja kthehet nga ne, çon pushkën dhe merr nishan; nuk jam i pavetëdijshëm se si të reagojë duke i rezistuar Milaimit që më tërhiqte prej mëngës, ndërsa roja me pushkë e lëviz tytën e saj drejt derës së daljes duke na kërcënuar ne*". Pastaj shkruan se "*Milaimi që nuk frikësohet lehtë ishte seriozisht i bindur se roja mund të na vdiste të dyve*". Vetëm një i sëmurë me skizofreni mund të

tregojë një histori të paqenë si të vërtetë! Sido që të ishte situata "*luftarake*" në pavi on, "*trimi*" i çartur Juriseviç nuk u frikësua. Nuk i luajti as qerpiku, por "*vërtetoi*" abuzimin me pacientët, keqtrajtimin (deri në pragvrasje) që bëhet në spitalin e Kukësit dhe me dëshmitarin e vetëm "*trimin*" tjetër Milaimin, këtë "*aksion model*" imagjinar do ta shkruante në paçavuren e tij pas dhjetë vjetësh më vonë si të vërtetë. Asnjë punonjës i spitalit, punonjës i kirurgjisë, pacient i shtruar në pavijon, vizitor vendas e kosovare, media vendase e ndërkombëtare (që ishin orë e çast në spital) nuk e ka ndeshur e raportuar (filmuar apo fotografuar) rastin në fjalë. Prandaj edhe Juriseviçi nuk e shkruan as emrin e as mbiemrin djaloshit të sëmurë dhe as të nënës së djaloshit. Madje as emrin e ndonjë personi tjetër të vetëm pos emrit të Milaimit të tij. Kam takuar përgjegjësin e rojave të sigurisë së spitalit për atë kohë, Qemal Peposhin, dhe personin që atë ditë ka qenë në shërbim, Beqir Hallaçin si dhe personin që ka marrë shërbimin të nesërmen, Zenel Micin, të cilët e hedhin poshtë me neveri e revoltë atë që përrallis Juriseviçi. Këta punonjës rigoroze shërbimi deklarojnë me përgjegjësi ligjore se asnjëherë dhe në asnjë rast rojet e sigurisë nuk kanë lëvizur me armë brenda mjediseve dhe pavijoneve të spitalit. Me rregullore arma mbahet në kasafortë dhe mund të përdoret vetëm jashtë spitalit në raste tepër të rrallë, por që realisht nuk është përdorur asnjëherë. Edhe ne mjekët që kryejmë edhe shërbime 24 orësh sipas grafikut nuk i kemi parë asnjëherë me armë as brenda e as jashtë mjediseve të spitalit rojet e sigurisë. Krejt padashje Juriseviçi na ndihmon të mos lodhemi shumë në hulumtimin tonë, për veprimtarinë e spitalit. Që në fillim të librin e deri në faqen 45 të tij (në botimin shqip) tregon "*histori*", "*ngjarje*", "*punë*", "*operacione*", "*abuzime*" dhe "*zgjidhje*" që lidhen vetëm me datat 28 dhe 29 prill 1999 dhe që flet e shkruan vetëm për ato dy data. Na ka dhënë mundësinë që t'i shfletojmë, t'i

lexojmë, t'i analizojmë e të nxjerrim të gjitha të dhënat vetëm për këto dy ditë. Kështu që jemi tepër të saktë në përgjigje apo kundërshtitë tona sepse imtësisht kemi gjetur gjithçka është zhvilluar ato dy ditënetë, dmth, ato 48 orë. Të gjitha shkresat, ditarët, regjistrat, dhe të gjitha i kemi parë edhe imtësirat më të vogla dhe më të parëndësishme. Më 28 dhe 29 prill 1999 në pavijonin e kirurgjisë nuk rezulton të jetë shtruar asnjë djalë me plagosje në këmbë (as në këmbën e majtë, as në të djathtën). Me plagosje të tillë nuk rezulton të jetë shtruar as djalë, as fëmijë e as burrë, bile as ndonjë paciente femër. Kjo është e vërteta! Asnjë operacion nuk ka kryer Juriseviçi, në asnjë operacion nuk ka asistuar Juriseviçi në datat 28 dhe 29 prill 1999. Kjo është e vërteta dhe nuk ka të vërtetë tjetër dhe për të bindur njerëzit dhe lexuesit po japim operacionet që janë kryer nga dr. Vata në datat 28 e 29 prill 1999: Më 28 prill dr. Vata ka kryer këto operacione:

1. Pacienti Drilon R, vjeç 12 nga Gjakova me diagnozë Apendicit flegmanoz dhe në kartelë e në bllokun e operacioneve të sallës (regjistri për çdo mjek kirurg) shënohet: Operoi: dr.Y. Vata, asistoi: Inf. Ilmie Kovaçi, anestezisti dr. E. Ferati, instrumentoi M.Guri.

2. Pacientja Vjollca Zh. vjeç 24 nga fshati Kalimash (Kukës) me diagnozë Apendicit akut dhe në kartelë e në regjistër të sallës shënohet: Operoi: dr.Y. Vata, Asistoi: Inf. Ilmie Kovaçi, anestezist: dr. A. Korbi, instrumentoi M.Guri.

Siç del nga dokumentacioni dhe njerëzit e sallës së operacionit që kanë qenë atë ditë në punë dr. Vata ka kryer dy opreracione gjithsej me diagnozë Apendicite. Juriseviçi nuk ka marrë pjesë në asnjerin prej operacioneve të Ylberit (dr. Vatës), as me ndonjërin nga mjekët e tjerë kirurgë (Mustafa ose Shaqiri). Del qartë se Juriseviçi nuk ka qenë fare prezent në sallën e operacionit.

Po kështu ndodh edhe më 29 prill 1999 kur dr. Vata ka operuar:

1. Hazir R. vjeç 63 nga Gjakova me diagnozë: Plasje stomaku dhe në kartelë e në regjistrin e operacioneve shkruhet: Operoi: dr. Y. Vata, Asistoi: Inf. I. Kovaçi, anestezist: dr. E. Ferati, Instrumentoi: M. Guri.

2. Rrahime R. vjeç 24, nga Dragashi me diagnozë Apendicit akut dhe në kartelë dhe regjistrin e operacioneve shënohet: Operoi dr. Y. Vata, Asistoi: I. Kovaçi, anestezisti: dr. A. Korbi, Instrumentoi: M. Guri.

3. Ismail S. nga Librazhi me diagnozë: Apendicit akut dhe në kartelë si dhe në regjistrat e sallës së operacionit shënohet: Operoi dr. Y. Vata, Asistoi: I. Kovaçi, anestezist: dr. A. Korbi, Instrumentoi: B. Cami.

Pra siç del nga dokumentacioni dhe njerëzit e sallës që kanë qenë në punë atë ditë dr. Vata ka kryer tri operacione; dy me diagnozë apendicit akut dhe një me plasje stomaku. Ndërsa Juriseviçi as ka operuar, as ka asistuar në ato operime me dr. Vatën e as me mjekë të tjerë. Edhe një herë e themi se më datat 28 dhe 29 prill 1999 "*kirurgu*" sllavo-australian Juriseviç, jo vetëm nuk ka punuar 16 orë rresht, jo vetëm se nuk ka bërë nëntë operacione as si kirurg i parë as si asistent, por as nuk ka qenë fare në sallën e operacionit. Edhe operacionet e kryera në ato dy ditë prilli (28 e 29 prill 1999) nga dr. Vata dhe ekipi i sallës së operacionit nuk kanë pasur asnjë lidhje me "*luftën*" që përshkuan Juriseviçi në paçavure.

Është absolutisht i vërtetuar, absolutisht i dokumentuar, absolutisht i pakundërshtueshëm operacioni i parë njëkohësisht dhe i fundit i Juriseviçit si asistent apo ndihmës i dr. Vatës më 4 maj 1999. Në këtë datë dr. Vata ka operuar një të sëmurë me emrin Ramadan Q.S. vjeç 57 nga Suhareka me nr. kartele 1932 me diagnozë: Hernia inguinalis dekstra ose në shqip dhjamë në bolen e djathtë. Operacioni është i dokumentuar në kartelën klinike dhe pasi përshkruhet operimi në fund shkruhet: Operoi: dr. Y. Vata, asistoi: dr.

Gregu (d.m.th. Juriseviçi), Instrumentoi B. Cami. Operacioni nuk është bërë me narkozë të përgjithshme, por me anestezi lokale ose me mpirje lokale me gjilpërë. Jemi të detyruar ta përsërisim se ky është operacioni i parë dhe i fundit i Juriseviçit, i cili në fund të shekullit të XX konkurron denjësisht me Don Kishotin e Servantesit të madh duke u bërë kështu Don Kishoti i epokës tonë. Shkurt njeriu më qesharak në botë.

Është e drejta e çdo njeriu në botë që t'i besojë ose jo ato histori, ato ngjarje apo episode që shkruhen, thuhen e propagandohen nga mënyrat më të thjeshta deri në më të sofistikuarat. Por e VËRTETA duhet të mbizotërojë pavarësisht nëse i pëlqen ose jo dikujt, pavarësisht nëse u pëlqen më pak apo më shumë njerëzve. E vërteta nuk njeh kufij, shtete a kontinente. Ajo është e pavarur nga dëshira apo nga ndërgjegjja e gjithsecilit, kudo ku jeton e punon në çdo cep të globit e nuk është pronë e "*kirurgut*" mostër Juriseviç nga Adelajde e Australisë që mundohet të hyjnizojë të pavërtetën, rrenën dhe shpifjen. I bën shërbimin më të keq të mundshëm qytetit dhe Atdheut të vet nëse vërtetë ka qytet dhe Atdhe. Kërkojmë falje nga qytetarët e Australisë e në veçanti nga qytetarët e Adelajdes, sepse vetë Juriseviçi e ve në dyshim origjinën e tij kur shkruan në faqen 14 të librit të tij: "*Gjyshi im sllloven nga ana e nënës*" dhe asgjë më tepër. Dhe nuk saktëson asgjë tjetër në ndihmë të identitetit të tij më tej. Ne u munduam ta identifikojmë origjinën e vërtetë të Juriseviçit (me aq sa ai shkruan për veten e tij), por nuk arritëm ta bëjmë. Vetë ai me aq sa shkruan për veten e tij, nuk mund të identifikohet saktësisht. Nuk është faji ynë kur konstatojmë se ajo shprehje e Juriseviçit është e saktë vetëm në pjesën kur gjyshi i tij e di se nënën e ka sllovene (kështu ia ka thënë nëna e tij gjyshit të Juriseviçit). Përsëri s'është faji ynë që gjyshi i Juriseviçit nuk e thotë emrin e babait të tij, apo të paktën kombësinë e babait të tij (!). Edhe ai

(gjyshi) nuk ka faj, sepse nëna e tij nuk e di as emrin as kombësinë e babait të fëmijës së saj (gjyshit të Juriseviçit). Duket pak e ngatërruar, por kështu është. Në këtë linjë janë dhe pasardhësit e gjyshit të Juriseviçit duke vendosur një "*standard*" të ri e të çuditshëm; mospërmendjen e emrave e mbiemrave të trungut familjar. Ky "*standard*" është reflektuar edhe në paçavuren në fjalë, ku nuk përmendet as nuk shkruhet asnjë emër, asnjë mbiemër, asnjë datë, asnjë ditë...për asgjë. Si përfundim del që Juriseviçi, duke filluar nga gjyshi i tij e në vazhdim ka origjinë kopili apo dobiçi dhe ashtu kopil pas kopili deri tek Juriseviçi i sotëm. Ky "*fis*" i rrallë i shtrirë nga Evropa në Australi duket ideal për themelimin e shoqatës "*Kopil Pa Kufi*" (shoqata KPK) ose në variantin e shoqatës "*Dobiç Pa Kufi*" (shoqata DPK).

XI - Drejt portës së shpresës – Morinit

Pasi ka punuar "*heroikisht*" dy ditë (28 e 29 prill 1999), në sallën imagjinare të operacionit Juriseviçi shkon drejt Morinit, drejt pikës së kalimit kufitar Shqipëri-Kosovë. "*IMC ka krijuar një ekip mobil kirurgjikal*", - thotë ai. Sa për dijeni të lexuesit dhe për saktësim atë ekip mobil kirurgjikal në Morin nuk e pat krijuar IMC-ja, por MSF-ja (mjekët pa kufi) të Francës. Ne e kemi vizituar dy herë atë pikë mjekësore të pritjes së refugjatëve dhe e dimë se aty shërbenin mjekë dhe personel tjetër i MSF-së. Edhe Besim R. Cengu në librin e tij "*Përmasat e mbijetesës*" në faqen 183 shkruan se "*Në Morin nga shoqata humanitare 'Mjekët pa kufi' është ngritur një klinikë për të sëmurët që vijnë nga Kosova*". Dhe për çudi njësia mobile e IMC-s (sipas Juriseviçit) është e vendosur në një copë toke të shkretë "*afër një ure guri mbi rrjedhën e gjerë të Drinit dhe që bart masën e të dëbuarve*". Duket se ia fut kot për urën e gurit në rrjedhën e gjerë të Drinit, sepse nuk ka asnjë urë guri mbi

lumin Drin. Nuk ka pasur as nuk ka asnjëherë urë guri mbi Drin në Morin! Dhe të ardhurit nga Kosova nuk kanë kaluar mbi lumin Drin (nëpërmjet urës së gurit të Juriseviçit) për të ardhur në Morin e më pas në Kukës, sepse rruga automobilistike, është paralel me lumin Drin, siç ka qenë gjithmonë dhe s'ka asnjë lidhje me të. I pavëmendshëm në përshkrimin e gjërave kryesore, por tejet i "*saktë*" kur shkruan edhe në detaje të holla ato që të i duhen dhe i interesojnë. Në paçavure shkruan: "*Ka diçka me lumin Drin që më habit. Te kalimi lumi është blu, por kur e shikon rrjedhës të lart e ka ngjyrën e ndryshkut*". Përsëri i shumëdituri (Milaim) si gjithnjë shpjegon se "*serbët kanë hedhur shumë trupa të gjakosur në lumë*". Dhe Juriseviçi përfiton nga kjo e dhënë dhe menjëherë shkruan se "*tash e vërej numrin e madh të trupave të vdekur mbi ujë, aty ku rrjedha ngadalësohet në kthesë, disa nga ato të zënë nga shkurret, disa duke u ulur e ngritur me kokë teposhtë*". Ne që kemi qenë me dhjetëra herë në Morin në atë kohë, shokët tanë mjekë e mjaft miq e shokë që kemi njohur, punonjësit e policisë kufitare, punonjësit e doganës së Morinit si dhe banorët e fshatit Morin, nuk e kanë vënë re ndryshimin ngjyrës së ujit të Drinit në pjesën e kalimit të tij nga Kosova për në Shqipëri në drejtim të qytetit të Kukësit. Asnjë person tjetër as atëherë as sot nuk është shprehur për ndryshimin që ka parë Juriseviçi. Asnjë media vendase apo e huaj (që siç dihet ishin të shumta dhe të vendosura non stop) në Morin nuk e ka vërejtur "ndryshimin e ngjyrës" në lumin Drin. Ndryshe do të jepej si lajm i shpejtë dhe i parë. Por veç Juriseviçit që e mban mend qysh atëherë dhe që e shkruan pas dhjetë vjetësh dhe Milaimit që ia ka "*shpjeguar*" ndryshimin e ngjyrës së ujit të Drinit në kufirin kosovaro-shqiptar në atë kohë asnjë dëshmitar real nuk gjendet. Është e thjeshtë; s'ka pasur dëshmitarë të tjerë as në atë kohë. Ndërsa "*dëshmitar*" Milaimit nuk i besohet as në WC pa lëre

në këtë rast. Edhe përshkimi që bën për refugjatët që kalojnë urën është i denjë vetëm për një mendje ekstremisht të sëmurë që prodhon fantazi të paimagjinueshme për radhët e mëdha të refugjatëve që kalojnë kufirin veçmas faktit që përtej kufirit sa herë që shikon dallon "*ato që bien në tokë dhe mbeten mbrapa*" pasi janë tepër të lodhur për të vazhduar. Por, vëren Juriseviçi, nuk ishte ashtu, ishte ndryshe sepse "*me një palë dylbi që m'i jep një i ri refugjat (!) shoh fytyrat e ushtarëve serbë nja një gjysmë km larg kur snajperët serbë në kodër qëllojnë dhe vrasin një nga një refugjatët*". Dhe më në fund ai e kupton se "ato që po mbesin prapa, po mbesin jo nga rraskapitja, por serbët po i vrasin". Nuk e mendon Juriseviçi se serbët kishin kohën e mjaftueshme dhe hapësirën e duhur që t'i vrisnin refugjatët kur të donin e ku të donin brenda Kosovës. A mos ishte Sllobodan Millosheviçi ndonjë budalla që t'i vriste refugjatët bash në vijën kufitare ku ishte e pranishme e gjithë bota. Apo mos serbët po i vrasin refugjatët që t'i shohë vetëm autori i paçavures. Si është e mundur që një i ri refugjat t'i jepte një palë dylbi Juriseviçit, ndërkohë kur dihet mirëfilli se çdo refugjat që kalonte kufirin kontrollohej dhe i merrej çdo gjë duke filluar nga targat e makinave e deri tek dokumenti identifikues. Të riut të dëbuar me dhunë ia paskan lënë dylbinë që t'ia jepte Juriseviçit! Përralla, të denja për netët e gjata të dimrit! E "*heroi*" Juriseviç (në fakt Don Kishoti modern) dëshiron të kalojë kufirin për të ndihmuar ato që kanë nevojë për ndihmë mjekësore. Por për fat është Milaimi (Sanço Panço modern) që e "*shpëton*" duke i shpjeguar se "*përtej vijës kufitare është shumë e rrezikshme, është e pamundur të ndihmohen refugjatët, sepse tek ura serbët do të na vrasin edhe ne*". Nëpërmjet gojës së Milaimit të tij (të vetmit dëshmitar), Juriseviçi mundohet të na bindë se serbët po i vrasin kosovarët në prani të gjithë botës. Këtë e bën për të vërtetuar forcën dhe vendosmërinë e serbëve kundër gjithë

botës demokratike dhe për ta sfiduar atë. Por harron se serbët nuk janë aq budallenj që aq haptazi e aq pa frikë të marrin guximin e çmendur ta sfidojnë edhe NATO-n. Pak më tej përshkruan një kasaphanë në anën tjetër të kufirit duke shkruar se "*zhurma e tre shpërthimeve të shpejta njëra mbas tjetrës dëgjohen poshtë lumit*" dhe nga pozicioni që ai ndodhet sheh që "*njerëzit janë shtrirë përtokë, disa të vdekur apo të plagosur, të tjerë në përpjekje për të gjetur strehim aty ku nuk ka strehim*" dhe vazhdon se "*kemi një kiamet gazetarësh këtej pari, që përzihen me refugjatët...Tash shumica e tyre po vrapojnë drejt urës, në kërkim të xhirimeve të kaosit dhe pse nuk mund të shohin shumë, ngase janë pjesë e rrëmujës*". Ai (Juriseviçi) me sytë e tij të djallit sheh "*edhe ushtarët serbë që vallëzojnë prej gëzimit mbase hodhën minat*". Megjithëse vetë shkruan se "kemi një kiamet gazetarësh bile që përzihen me refugjatët, nuk e dimë pse harron e pas dhjetë vjetësh i shkruan në paçavuren e tij ato "*ngjarje*" e ato "*ndodhi*" që veç tij askush nuk i ka parë. Asnjë gazetar, reporter apo fotograf i atij "*kiameti gazetarësh*", as nuk e kishte dëgjuar as nuk e kishte parë atë ditë në anën tjetër të kufirit në Morin atë që kishte dëgjuar e kishte parë Juriseviçi! Asnjë punonjës i doganës dhe i policisë kufitare dhe banor i Morinit nuk e ka dëgjuar e nuk e ka parë atë që ka dëgjuar e parë Juriseviçi. Po të ishin të vërteta ato që thotë e shkruan ai "*kiameti i gazetareve*" do të filmonte, fotografonte dhe informonte botën, por kjo nuk ka ndodhur. Mediat për këtë punë kishin ardhur dhe detyra e tyre ishte për të raportuar ngjarjet. Mirëpo ato media nuk mund të pasqyrojnë fantazitë e sëmura e përrallisjen haluçinante të këtij "*kirurgu*" mostër. Përgatitja dhe etika profesionale e çdo gazetari mbështetet në pasqyrimin real e me vërtetësi të ngjarjeve dhe jo të ngjarjeve ireale, pjellë e fantazisë se dikujt, apo që porositën si mall për t'u shitur në "*kujtimet*" e ndonjërit pas dhjetë vjetësh si ngjarje e ndodhi

si të vërteta që nuk kanë ndodhur kurrë. Juriseviçi e vazhdon "*luftën*" e tij siç e dëshiron dhe siç i intereson. Data 30 prill 1999 apo dita e tij e parë në Morin (për të cilën shkruan) nuk ka qenë dita e "*duhur*" për të. Bazuar në faktet që jep gazetari Besim R. Cengu në librin "*Përmasat e mbijetesës*" atë ditë në Morin kanë hyrë 1500 refugjatë (të dhëna të marra nga policia kufitare, Prefektura e Kukësit dhe UNHCR-ja) duke qenë larg ditëve kur në Morin kanë hyrë 20 mijë deri në 30 mijë refugjatë e ndonjë ditë edhe më shumë. Do të ishin "*ditë ideale*" këto ditë dhe jo dita për të cilën flet e përshkuan Juriseviçi në paçavure që tenton të na mbushë mendjen për punën e tij "*heroike*" në trajtimin e plagëve të refugjatëve si dhe për "*shkathtësinë*" e "*cilësinë*" e shërbimit të tij "*shëndetësor*" duke u afruar deri në vijën e katastrofës pa i bërë syri tërr siç thotë ai. Gjithnjë në kulmin e "*punës*" e "*sakrificës*", Juriseviçit i del përpara rasti që i duhet. Rasti që një natë më parë e ka parë në ëndërr, sepse në gjithë atë rrëmujë e përshtjellim (siç e përshkuan vetë) ai e gjen kohën e nevojshme që ta shënojë ngjarjen e "*duhur*" në bllokun e tij misterioz që do t'i duhej pas dhjetë vjetësh që ta përshkruante në paçavuren e "kujtimeve" të tij. S'ka si të mos i paraqitej një djalosh (refugjat) të cilin e përshkuan me hollësi, megjithëse në kushte të dritës së kufizuar. Ishte mbrëmje vonë dhe djali kërkon ndihmën e Juriseviçit për motrën e tij të sëmurë. Quhet Liridon, ndërsa motra e sëmurë quhej Lule. Ajo sipas Juriseviçit, ishte në gjendje të rëndë dhe në dorë mbante një letër që ia kishte dhënë mjeku i spitalit të Prizrenit që e kishte kuruar. Ajo pusullë shkruante "*pusulla i drejtohet kujtdo që e lexon se Lulja është e sëmurë me leucemi dhe i është nënshtruar trajtimit duke rekomanduar vazhdimin e tij*". Mjeku e kishte shkruar me shpejtësi atë pusullë dhe me një anglishte të dobët, por kishte qenë i ndërgjegjshëm dhe ka dhënë detajet e trajtimit të saj duke shkruar më në fund edhe lutjen: "*Ju lutemi ndihmojeni*

këtë vajzë! Unë kam bërë gjithçka kam mundur. Zoti e ndihmoftë atë dhe gjithë të tjerët"! Ne jemi të bindur se midis serbëve ka pasur, ka dhe do të ketë njerëz të mirë (nuk ka thënë kush e as nuk themi se populli serb është i keq, sepse nuk ka popull të keq) se ka serbë të mirë e pohojnë mjaft kosovarë të ardhur në Kukës. Por rastet janë konkrete, të jetuara, të vërteta dhe të provuara në jetë pa pasur asnjë arsye apo nevojë që Juriseviçi të shpikë ose të pjellë serbë të mirë. Si në rastin e mjekut serb në spitalit e Prizrenit. Këtë e shprehim me bindje të plotë se nuk kemi hasur në asnjë punonjës, mjek, infermier, drejtues të atëhershëm dhe të sotëm të spitalit të Prizrenit që ta pohojë "*faktin*" e Juriseviçit se më 30 prill 1999 "*një mjek serb ka punuar në atë kohë në spitalin e Prizrenit*" e ka "*bërë të pamundurën që Lulen (vajzën 16 vjeçare të sëmurë) ta mbante në spital për kundër nxjerrjes me forcë nga aty prej ushtarëve, policëve dhe paramilitarëve të të gjithë të sëmurëve shqiptarë që ishin shtruar atë ditë në spitalin e Prizrenit"*. Edhe nga shfletimi i dokumentacionit klinik në spitalin e Prizrenit nuk kemi gjetur ndonjë të sëmurë me emrin Lule, as me diagnozë leucemi e as me ndonjë sëmundje tjetër. Jo vetëm kaq, por asnjë mjek serb nuk është vrarë atë ditë brenda spitalit të Prizrenit sepse paska "*kuruar*" e "*ndihmuar*" një vajzë shqiptare të sëmurë me leucemi. Edhe këtë "*fakt*" (vrasjen e mjekut serb më 30 prill 1999, brenda në spital të Prizrenit), nuk ka asnjë punonjës, mjek, infermier, drejtues, i sëmurë dhe banor të lagjes rreth spitalit që ta pohojë. Për koincidencë, unë kam pasur të strehuar në banesën time në Kukës 46 shqiptarë të Prizrenit dhe Malishevës dhe midis tyre ishte dhe baca Kamber Kurtaj i lagjes "*Tusus*" i cili kishte ardhur në Kukës shumë më vonë se pjesëtarët e tjerë të familjes që kishin ardhur që ditët e para të eksodit. Ai vuante nga tensioni i lartë i gjakut dhe

kurohej vazhdimisht duke bërë vizita periodike në spitalin e Prizrenit.

Saktësisht më 30 prill 1999 baca Kamber ka qenë për vizitën e radhës në spital që në mëngjes duke pritur disa orë për tu vizituar si dhe disa orë të tjera për të bërë analizat dhe ekzaminimet e nevojshme dhe tregonte se kishte parë shumë të sëmurë shqiptarë që linin në panik spitalin për t'u bashkuar me familjarët e tyre për në Kukës, bile disa prej tyre edhe i njihte. E sa për vrasjen e mjekut serb asnjëherë nuk ka folur, asnjëherë nuk e ka përmendur "*faktin*" Juriseviç! Sipas Juriseviçit historinë e vrasjes së mjekut serb ia ka treguar Lulja duke e cilësuar "*hero*" (mjekun serb) për arsye se ai kinse e mbrojti Lulen prej ushtarëve, policëve dhe paramilitarëve serbë dhe i qëndroi pranë duke ia dorëzuar të vëllait të saj, Liridonit. "*Duke u larguar vëlla e motër, u kthyen ta përshëndesin me dorë mjekun serb. Por në atë çast dëgjuan krisma arme dhe panë më sy mjekun e vrarë, e pak më vonë panë dy ushtarë serbë që e tërhoqën zvarrë trupin e tij dhe e nxorën jashtë portës së spitalit*". E si për të na mbushur mendjen me fantazinë e tij shkruan se "*Lulja e rraskapiti veten me këtë rrëfim për guximin dhe heroizmin e mjekut, por nuk ka fuqi për asnjë fjalë tjetër të vetme*"! Kjo se edhe Juriseviçi kaq donte, kaq kishte planifikuar të fliste Lulja dhe Liridoni, dy njerëz anonime dhe të paidentifikueshëm prej askujt as atë ditë e as pas dhjetë vjetësh; duket se vetëm "*doktori*" australian e pohon. Teveqeli (Milaim) duket mjaft qartë se e ngarkon veten me përgjegjësi mjaft të rendë kur i "*përkthen*" Juriseviçit sipas dëshirës së tij, sipas skenarit të tij krejt fiktivisht për hesap të...misionit djallëzor të padronit të tij mjek se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"! Por e paimagjinueshmja, e papranueshmja, acaruesja, revoltuesja, vjellndjellësja...është më vonë kur Juriseviçi bën "*heroin*" në trajtimin e shkëlqyer të Lules dhe e nisi për trajtim të mëtejshëm në spitalin e

Kukësit (për të cilin vjell vetëm vrer). Ishte i interesuar në vazhdimin e ëndrrës së tij kriminale, ëndrrës së tij djallëzore që e kishte parashikuar Lulen të vdekur dhe më tej ku do të varrosej. "*Vajza do të vdesë, e di*" thotë Juriseviçi dhe s' ka si të mos vdesë kur ai e ka planifikuar në ëndërr vdekjen e saj (!) por më e rëndësishmja për djallin është të "*sigurojë*" edhe varrimin e saj sipas ëndrrës; kjo do të jetë për Juriseviçin më e rëndësishme se vetë vdekja e vajzës. Prandaj kur u kthye natën vonë në spitalin e Kukësit e pyeti një infermiere se çfarë u bë me Lulen e "*tij*"? Infermierja (përsëri anonime) i tha se kishte vdekur rrugës për në spitalin e Kukësit. Pas "*keqardhjes*" për vdekjen e saj menjëherë e pyeti Milaimin e "*tij*" se ku do të varrosej Lulja (megjithëse në ëndërr e ka caktuar përgjigjen e Milaimit)! Milaimi i "*tij*" (tashmë një teveqel i spikatur) u përgjigj mu ashtu siç e kishte parashikuar Juriseviçi në ëndrrën e vet: "*Në një gropë të përbashkët me të tjerët*"! Të flasësh si kriminel i vërtetë serb, të flasësh qesim o Milaim ngarkohesh me përgjegjësi të rëndë morale dhe penale! Duhet ta dijë djalli Juriseviç se në Kukës dhe në fshatrat rreth tij, në Krumë dhe në fshatrat përreth, në Bajram Curri dhe në fshatrat rreth tij, kudo në Shqipëri kur vdes një njeri varrimi i tij bëhet në praninë e shumë qytetarëve, të shokëve, të miqve dhe dashamirëve duke i dhënë vlera të larta një tradite të lashtë shqiptare për të respektuar të vdekurin. Çdo i vdekur ka varrin e vet duke i dhënë çdo varri emrin dhe mbiemrin. Në Kukës në atë periudhë kanë vdekur edhe shqiptarë të ardhur nga Kosova, kryesisht për shkaqe natyrale dhe secili është varrosur në varrin e tij duke zbatuar ritet fetare e rregullat strikte shtetërore.

Dëshmitarë janë të gjithë qytetarët e Kukësit, të gjithë të ardhurit dhe pjesëmarrësit e shumtë në çdo varrim. Bashkia e Kukësit (punonjësit e shërbimit funeral) ka varrosur në varrezat publike të qytetit në një parcelë të

veçantë 170 shqiptarë të vdekur të dëbuar me dhunë nga trojet e veta. 137 janë të identifikuar dhe në secilin varr është shënuar emri dhe mbiemri, data e lindjes, data e vdekjes, vendbanimi. Janë varrosur edhe 33 të vdekur të tjerë të paidentifikuar secili në varrin e vet. Në çdo varr është shënuar *"kosovar i paidentifikuar"*. Kufomat e tyre janë fotografuar e janë filmuar nga organet e policisë e prokurorisë dhe janë të dokumentuara pranë këtyre organeve. Pjesa dërmuese e personave të vdekur pas përfundimit të krizës, janë marrë nga familjarët e tyre dhe janë varrosur në vendbanimet e tyre në Kosovë. Edhe në varrezat publike të qytetit të Krumës janë varrosur 36 të vdekur dhe ashtu sikurse edhe në Kukës secili në varrin e vet me ceremoni zyrtare e rite fetare sipas traditës shqiptare. Pothuajse të gjithë janë marrë nga familjarët dhe janë varrosur në vendbanimet e tyre në Kosovë. Edhe në komunat e Kukësit e të Hasit kanë vdekur 17 shqiptarë të dëbuar dhe janë varrosur secili në varrin e vet, në varrezat e çdo fshati ku kanë vdekur, me ceremoni e rite fetare sipas traditës. Kanë qenë të gjithë të identifikuar dhe janë marrë tashmë nga familjarët për tu varrosur në vendbanimet e tyre në Kosovë. Si është e mundur që Milaimi ta plotësojë pa asnjë ndrojtje kërkesën e ëndrrës së Juriseviçit se "*Vajza (Lulja) do të varroset në një gropë me gjithë të tjerët*"! Ku e merr guximin, ku e gjen forcën dhe mbështetjen kur deklaron të padeklarueshmen? Kjo është barra më e rëndë për Milaimin që në një farë mase e "*lehtëson*" pak edhe djallin Juriseviç. Është një fyerje shumë e rëndë për kuksianët të cilët njëzëri e hedhin poshtë me neveri. Është një barrë edhe më e rëndë për familjen e Milaimit, përderisa ai nuk prononcohet të thotë të vërtetën ne kemi të drejtë të marrim gjithçka thuhet të mirëqenë dhe të vërtetë. Një turp kaq i madh indinjon çdo kuksian, nuk e pranon e nuk e mban asnjë njeri me gjak shqiptari dhe ndjenja atdhetarie, o Milaim teveqeli! Nuk ka kuksian e nuk

ka shqiptar qe e mban atë barrë tejet të rëndë turpi ani pse Milaimi e ka të vështirë dhe të pamundur ta hedhë atë barrë nga shpina e tij. Heshtja e Milaimit të revolton. Por më të acaruarit do ta akuzojnë atë për shpifje e deklarime të pavërteta dhe fyerje të rëndë të popullit të Kukësit. Mirëpo ç't'i bësh misionit të djallit!

Në shërbim të fëmijës

XII – Skutat e errëta të një shpirti katran

Është e sikletshme skena që paraqet Juriseviçi për fëmijët që banojnë pranë banesës së tij në Kukës. Midis të tjerash shkruan se "*nisem poshtë për të parë se përse qeshin fëmijët mu në mes të Kukësit, sepse nuk do të duhej me të gjitha këto gjëra përreth që i bëjnë të vajtojnë*" (!). Po Juriseviçit nuk i pëlqen e qeshura e fëmijëve. Hëm! Këto nuk mund ta kuptojmë! Pse!? Pse nuk do duhej të qeshnin fëmijët në Kukës për Jurisiçin!? Vetëm shpirti i tij (ku ka shpirt ai!), vetëm truri i tij dëshiron që "*fëmijët të mos qeshin*". Askush tjetër! Por s'ka çfarë bën as Juriseviçi e askush tjetër; ata fëmijë qeshin e gëzojnë se janë fëmijë shqiptarë. Qeshin me gjithë shpirt (siç di të qeshë vetëm fëmija) dhe e sfidojnë pa e ditur shpirtin të autorit të paçavures Juriseviç. Më poshtë shkruan se duke parë fëmijët që luajnë me top para pallatit kënaqet sepse "*kjo është njëra nga gjërat e shkëlqyera në jetë, t'i shohësh fëmijët teksa luajnë*", por jo pa qëllim "*rastësisht*" takon një grua që po kujdesej për ata fëmijë që luajnë. Prezantohet menjëherë duke u afruar dhe ajo e përshëndeti në anglisht se e kuptoi që Juriseviçi ishte i huaj. Kur prezantohet Juriseviçi gruaja menjëherë e dëgjon "*viç*"-in dhe ja thotë "*Juriseviç është emër serb*", por "*argumenti*" i tij e qetëson gruan menjëherë kur i thotë se "*jam slloven nga babagjyshi*" (fq. 56 botimi shqip), duke e "*bindur*" menjëherë se nuk ishte serb. Fillojnë bisedën dhe gruaja i thotë se "*quhem Edona dhe fëmijët janë jetimë. Ata jetojnë me ne në familjen tonë dhe në familje të tjera. Një ditë do të kthehen në Kosovë ndoshta*". "*Specialisti*" Juriseviç menjëherë i gjen rastet që i duhen dhe që i interesojnë (dhe kur bëhet fjalë për fëmijët) duke fantazuar se "*familjarët e këtyre fëmijëve kanë vdekur në prani të fëmijëve të tyre dhe për këtë është i sigurt*". Një shembull do ta ketë planifikuar

dhe menjëherë e "*gjen*" kur pyet vajzën e vogël me flokë të gjata që ishte në skaj të fushës dhe përsëri "*ëndrra i del*", sepse pikërisht asaj vajze "*ja kishin vrarë para syve nënën, babanë, dhe motrën*", - i thotë Edona. "*Mbase do ta kishin vrarë dhe vajzën e vogël, por ajo ishte fshehur në dollap*".

Si gjithnjë i "*punon*" truri kur bën krahasimin e pamundur, krahasimin e paduhur, apo krahasimin më djallëzor të mundshëm, midis fëmijëve në Adelajde dhe atyre në Kukës. Shkruan më poshtë se "*kur fëmijët po hanin, Edona po m'i tregonte vizatimet dhe pikturat që i bëjnë*". Më poshtë fillon krahasimi i pamundur kur thotë se "*Kur në Adelajde, fëmijë të moshës 6-7 vjeç e kanë rastin të përdorin lapsa me ngjyra të ndryshme dhe ato që i shohim në paraqitjet e tyre të hareshme janë paraqitja e drurëve, qiejve të kaltër, lopëve, veturave të shkëlqyera, yjeve të TV, kukullave e superheronjve gjithashtu edhe nënën e babanë e buzëqeshur, sepse tek fëmijët ajo që ua dominon mendjen del e paraqitur në letër*". Pa dyshim që flet për një vend, për një qytet të zhvilluar ekonomikisht, larg luftërave e konflikteve, një shtet me mirëqenie e nivel jetese për t'u admiruar jo vetëm nga ne, por edhe shtete të tjera të zhvilluara. E ndërsa shikon vizatimet e pikturat e fëmijëve që ishin para pallatit në Kukës, Juriseviçi shkruan se "*ajo që del nga mendjet e këtyre fëmijëve është vdekja, në të shumtën; vizatime trupash të shtrirë në pellgje gjaku të ushtarëve duke gjuajtur nga pushkët, të tankeve, të shpërthimeve, shtëpive të djegura, të fëmijëve që derdhin rrëke lotësh. Një pamje e shpeshtë është fëmija pranë një kufome*". Edona thotë: "*ky është jetimi, e ai tjetri prindi*" dhe më shpjegon më tej se si "*arti antitrauma*" i këtij lloji i ndihmon fëmijët të flenë natën! Pasi i "*gjen*" dhe i "*merr*" ato që i duhen, ato që me siguri autori i ka planifikuar qysh më parë ndahet me Edonën, e cila sigurisht (Juriseviçi e kishte planifikuar dhe këtë) se do ta falënderonte dhe sigurisht (e kishte planifikuar dhe këtë) që

s'do të mund të mos i quante "*heronj*" të gjithë të huajt që po e ndihmojnë Shqipërinë, pa mëdyshje edhe Juriseviçin. Fjala "*hero*" e dalë nga goja e asaj gruaje që quhet Edona i duhej shumë atë ditë Juriseviçit sepse pas dhjetë vjetëve do të shkruante për "*heroizmat*" dhe atë vlerësim (si hero) do ta quante si të vërtetë (!), duke bindur veten e tij se "*heroizmi*" e ndjek nga pas, por kurrë nuk e arriti. Kjo për shkak se djalli nuk ka qenë, nuk është, dhe nuk do të jetë hero kurrë! Juriseviçi e di këtë fakt, por edhe Don Kishoti e "dinte" dhe i "*besonte*" heroizmat e tij që shekuj më parë kur luftonte me mullinjtë e erës. Të gjithë Don Kishotët janë njësoj si ato të shekullit të XIX, si ato të shekullit të XX, si ato të shekullit të XXI! Në fund të fundit Don Kishotë janë! Mendja e tij bën "*dallimin*", bën "*analizat*" dhe jep "*përfundimet*" për çdo gjë (gjithnjë sipas tij) kur shkruan se "*Artileria serbe po na afrohet me të shtëna dhe nuk ka asgjë që do t'i parandalonte serbët që t'i sulmonin kampet, ta bombardonin Kukësin me t'i zbrazur 'kaçushat' posaçërisht nëse nuk janë në humor të mirë, e ata kurrë nuk janë në humor të mirë*". Në këtë mënyrë ai bën kinse një "*analizë ushtarake*" si mjek kirurg vullnetar. Dhe jo vetëm kaq: ai është i "*pakënaqur*" nga OKB-ja e UNHCR-ja që "*flasin për projekte pastrimi ujrash, logjistikën e shpërndarjes së ushqimeve, lëvizjen e refugjatëve në rajon...probleme që realisht janë nga më primaret në atë kohë, kur rreth 200-300 mijë njerëz në Kukës ishin në pragkatastrofë humanitare*". Del qartë se "*ku i rreh*" Juriseviçit e "*ku i rreh*" OKB-s e UNHCR-s! Juriseviçi pret sulmin e serbëve mbi Kukësin, mbi refugjatët, ai pret katastrofën më të tmerrshme që e imagjinon, por edhe e dëshiron! Juriseviçi e "*planifikon*" sulmin e artilerisë serbe kundër Kukësit. Për më tepër, sipas tij, s'ka asgjë që ta ndalë këtë sulm. Por harron ai apo ashtu "*ia do mushka drutë*" të shprehet sepse artileri dhe kaçusha nuk kishin vetëm serbët! Armë të të gjitha llojeve, ushtri dhe popull nuk kanë vetëm

serbët, por të gjithë popujt e rajonit. Shqiptaria ishte në këmbë. Jetonte me situatën dhe ishte e gatshme, e përgatitur dhe e vendosur t'i përgjigjej jo vetëm një sulmi siç dëshiron Juirseviçi, por edhe çdo provokimi brenda territorit te Republikës së Shqipërisë. Në librin e Besim R. Cengu "*Përmasat e mbijetesës*" në faqen 141 shkruhet për deklaratën e zëdhënësit të Qeverisë së Shqipërisë me 13 prill 1999, i cili deklaron: '"*Sovraniteti i Shqipërisë nuk mund të preket e që nga kjo ditë. Ushtria shqiptare është urdhëruar që për çdo incident të përgjigjet me zjarr*". Aq më të vendosur dhe më të sigurt ishin shqiptarët dhe Shqipëria, kur në krah të tyre ishte bota demokratike, ishte NATO-ja aleanca më e madhe dhe më e fuqishme ushtarake e të gjitha kohërave. S'besojmë se Serbia kishte në drejtim budallenj të asaj shkalle sa të urdhëronin sulmin kundër Republikës së Shqipërisë. Ky veprim do të ishte fatal për vetë Serbinë. Shqipëria asnjëherë, nuk ka sulmuar askënd, por një fakt është i vërtetë kush ka sulmuar Shqipërinë ka pësuar humbjen e sigurt. Duket paradoksale se si Juriseviçi që kishte ardhur në Shqipëri i fundit (28 prill 1999), bëhet i pari i shërbimit shëndetësor në Kukës. Ai sapo erdhi, mori një "*post*" të ri: "*postin*" e koordinatorit kirurgjik dhe kirurg kujdestar për kampet e zonës së Kukësit. U pajis me makinë "*Land Crusier*", shofer dhe radio nga "*zemërgjerësia*" e UNHCR-s (megjithëse e kemi thënë më parë që Juriseviçi nuk e kishte shumë qejf UNHCR-n, bile nuk ka asnjë respekt të veçantë dhe kohë pas kohe nuk ka besim tek UNHCR-ja, sepse kishte "*zbuluar*" se ajo mund të ketë lidhje të fshehta me krimin...! A nuk po duket i jashtëzakonshëm ky Jurisheviçi, a nuk po merr mbi kurriz shumë barrë, a nuk po duket se vetëm ai mund t'i kryejë disa punë njëherësh e asnjë tjetër! Ne mendojmë se për të kryer një, dy apo më shumë punë detyra ose përgjegjësi, nuk është e mjaftueshme vetëm dëshira e vullneti i personit (në rastin tonë Juriseviç).

Themelore është faktori kohë që personi ka në dispozicion në "*24 orët e ditës dhe natës*" dhe pamundësia objektive për të qenë prezent në disa vende në të njëjtën kohë të shkurtër. Pa lëre më për ta kryer plotësisht një punë, përgjegjësi, ose detyrë! Por me Jurisheviçin çdo gjë mund të realizohet sepse vetëm detyrën primare, misionin e tij misterioz kishte objektiv ta realizonte. Të tjerat ishin formale, aq formale sa nuk është çudi që Juriseviçi është "*prezent*" në sallën e operacionit disa herë sepse vetëm i shënohet emri në kartela, pa qenë fare në sallën e operacionit. Ose "*kryen*" dy detyra në të njëjtën ditë: mjek kirurg në Kukës dhe "*vullnetar*" i UÇK-së në Helshan...! Është shumë e vështirë të pranohet se Juriseviçi i ka kryer detyrat që i ka pasur në atë kohë, sepse detyra e koordinatorit kirurgjik e të mjekut kirurg kujdestar i kampeve të vendosura në Kukës (që nuk ishin pak), ishte një detyrë që i merrte shumë kohë dhe s'besojmë se e lejonte Juriseviçin të mund të kryente operacione në kampin italian me dr. Tokafudin në spitalin e Kukësit me dr. Vatën. Apo të rendte në pikat shëndetësore ku priteshin refugjatët, në rastet e "*shpeshta*" të aksidenteve ku Juriseviçi gjithnjë ishte "*prezent*", sikurse e thotë disa here. E megjithatë ishte në dorën e Juriseviçit t'i shkruante e t'i tregonte ato "*punë*" e "*veprimtari*" të shumta të tij dhe në dorën e lexuesit që t'i besojë ose jo. Ne nuk e besojmë për shkak se faktet kokëfortë flasin kundër tij! Një gjë është e vërtetë se po të mos "*gradohej*" dhe të merrte "*postin e ri*", nuk do të mund të vizitonte, të kontrollonte e të vlerësonte as spitalin e EBA, as spitalin e kampit "*Italian 1*" as MSF...as pikat shëndetësore të kampeve të tjera të shumta në Kukës. Kështu përfiton për të mos humbur rastin që të shpifë për spitalin e Kukësit sepse vetë e thotë, kur ai "*kontrollon*" spitalin e EBA në bisedë me nënkolonel Muhamedin. Gjatë bisedës Muhamedi i thotë se ky mision ishte më i rëndësishmi në jetën e tij dhe tregon se është

krenar për këtë mision. Për të vetmen gjë se sipas tij "*Po zbatojmë dëshirën e zotit. Po zbatojmë vullnetin e tij duke u kujdesur për vëllezërit dhe motrat tona myslimane*". Dhe menjëherë mjeshtri i "*licencuar*" nga djalli në paçavure shkruan bash ashtu siç e ka porositur licencdhënësi se "ma merr mendja se Muhamedi nuk e ka vizituar brendinë e spitalit të Kukësit ku motrat dhe vëllezërit myslimanë e kanë rehatinë dhe kujdesin sikur të ishin në një kasaphanë". Qëllimisht e dashakeqësish synon kësisoj tinëzisht dy punë; të vërtetojë se "*spitali i Kukësit është kasaphanë*" dhe "*shqiptarët t'i identifikojë si myslimanë (në mes të Europës) në radhë të parë dhe më pas si shqiptarë*". Por siç thotë ajo shprehja e njohur popullore se "*dy kunguj në një sqetull nuk mbahen*" (pa lëre me tre jo e jo) sepse Juriseviçi e ndërpret "*planin*" e tij për të shkuar në sallën e operacionit të spitalit të Kukësit e vazhdon duke shkruar "*Gjithë ato amputime! Raportet për të vrarët nuk e pasqyrojnë plotësisht atë që lufta ju bën njerëzve. Imagjinojeni po qe se do të detyrohesha të jepja raport javor, e t'i paraqitja të gjithë gjymtyrët që janë humbur, sa metra zorrë janë këputur, e sa sy janë qorruar*"! Duke mos e fshehur dëshirën e tij patologjike që të raportojë amputime, zorrë të këputura, dhe sy të qorruar, kur ne e kemi vërtetuar, e kemi evidentuar se asgjë reale dhe të vërtetë nuk ka në rrëfimet e Juriseviçit për spitalin e Kukësit për sallën e operacionit të kirurgjisë dhe "*amputimet*" e tij imagjinare që i përsëritë ditë e natë pa pushim në paçavuren e tij të neveritshme. Detyrat që i merr përsipër ai asnjëherë nuk arrin t'i plotësojë sepse s'është kirurg i aftë, s'është kardio-kirurg. Madje s'është as...mjek i rëndomtë me ato që bën e shkruan kudo por kjo siç duket është vetëm fasada e tij "*vullnetare*".

Por në thelbin e tij ai nuk është i paaftë e i pazoti në plotësimin e objektivit të tij, misionit të tij të vërtetë në shërbim...të serbëve. Nuk mund t'ia hajë kush hakun sepse

atë mision e ka kryer me guxim, këmbëngulje dhe me fshehtësi. Pavarësisht faktit se në ato kushte që ishte Shqipëria dhe Kukësi, fshehtësia e kishte humbur identitetin dhe rëndësinë e saj. Në atë periudhë të vështirë në plan të parë kishte dalë haptazi paraja, dollari amerikan e më shumë nga të gjithë "*dinari serb*" mban "*përgjegjësi*". Por, në fund të fundit përgjegjësinë më të madhe e kemi ne shqiptarët e sidomos e kanë shqipfolës të ndryshëm që mjaft qartë evidentohen në paçavuren e Juriseviçit! Juriseviçi "*di*" çdo gjë, "*sheh*" çdo gjë, "*parashikon*" çdo gjë dhe "*projekton*" çdo gjë duke bërë dhe "*heroin*". Ndërsa të tjerët vijnë shumë hapa pas tij! Kështu ndodhë (siç thotë ai) me OKB-n, UNHCR-n, NATO-n...kur vjen momenti që serbët mund të sulmojnë Kukësin e Shqipërinë dhe duhet planifikuar evakuimin (!). Sepse Mc Namara, emisari i UNHCR-s i paska thënë Jurisheviçit se "duhet të planifikoni evakuimin". Po kush duhet ta planifikojë evakuimin? I binte barra Juriseviçit (shumë pak e besueshme, kur kujtojmë se një mjek nuk ka by... t'ia dalë) që menjëherë filloi të bënte llogaritë dhe dyshon nëse mund të realizohet evakuimi se e pyet veten "*a ka diçka që nuk di për situatën këtu? Ndonjë plan të fshehtë që do të më zbulohet vetëm kur serbët ta sulmojnë Kukësin*"? Duket sikur Juriseviçi është "*kërthiza*" e botës kur i bën vlerësimet për gjithçka dhe shkruan se "*Duke u hutuar nga mënyra se si UNHCR-ja dhe NATO-ja e marrin më shumë lehtësi pamundësinë e evakuimit për një kohë të shkurtër. Mbase UNHCR-ja e ka parallogaritur humbjen e shumë jetëve pas invadimit dhe pasi e kanë bërë këtë vlerësim e mashtrojnë veten se e kanë situatën nën kontroll*" (!). Më tej shkruan se "*Më duket thuajse disa nga njerëzit e NATO-s dhe të UNHCR-së, me të cilët kam biseduar kurrë nuk e kanë parë një refugjat, pos nga largësia. Një gjë e di me siguri, forcat e NATO-s kurrë nuk do të akordojnë trupa tokësore për ta mbrojtur zonën kufitare siç është Kukësi.*

Mbase mund të bëjnë disa bombardime, por nuk do t'u ekspozojnë serbëve ushtarët e vet mish për top" (!). Më "*lart*" s'ka ku ngjitet Juriseviçi! Sipas tij ai është "*njohësi*", "*vlerësuesi*" dhe "*parashikuesi*" thuajse i vetëm i situatës në Kukës e më gjerë; ai bën "*llogari*" për NATO-n, për UNHCR-në, për Shqipërinë, për çdo gjë duke tejkaluar aftësitë e çdo "*kirurgu*" në botë! Sipas këtij gjeniu (të vetquajtur) kot është OKB-ja e UNHCR-ja, më kot është NATO-ja! Krejt kot paguhet Kofi Anan, Wesli Klark...! Zgjidhja është Don Kishoti Juriseviç! Mozomakeq!

Çdo njeri në botë e ka mjaft të qartë se çdo kirurg i vërtetë nuk merret me asnjë punë tjetër, veç punës së kirurgut për të cilën ka investuar vite të tëra jo vetëm shoqëria por edhe vetë kirurgu. "*Zgjidhja*" sipas tij, është e thjeshtë, mjafton të takojë Milaimin dhe të bisedojë për thashethemet për invadimin mbasi siç shkruan "*nuk ka shumë besim në versionin që ma dha MC Namara*" (i UNHCR-së). E vetmja mënyrë për ta gjetur Milaimin është ta kërkojë nëpër Kukës, në këmbë (pavarësisht se kishte dhe radion dhe makinën që ia kishte dhuruar UNHCR-ja) dhe me këtë rast "*njihet*" me qytetin e Kukësit! Fillon të ecë rrugëve dhe shtigjeve përbri njerëzve që e shikojnë me kureshtje (ne nuk e kuptojmë kureshtjen e njerëzve për ta parë Juriseviçin kur atë nuk e njihte asnjeri në Kukës). Kishte mësuar diçka për Kukësin gjatë rrugës nga Sidnei në Romë (rrugë ajrore) dhe shkruan se Kukësi i sotëm (qyteza siç thotë ai) nuk është i vërtetë, sepse Kukësi i vërtetë është fundosur nga liqeni i Fierzës në vitet 70-të. "*Qyteza e Kukësit ka vetëm 15 vjet, por varfëria e ka plakur para kohe, ashtu siç mund të bëjë duhani që burri 35 vjeç të duket si 50 vjeçar...*"! Vetëm me një llogari të thjeshtë duket se Juriseviçi ia fut kot (se mos vetëm njëherë), kur dihet se jemi në vitin 1999 e Kukësi i vjetër gjendet i mbuluar nga ujrat e Liqenit te Fierzës që prej vitit 1974 (kur u evakua edhe spitali, institucioni i fundit për

në Kukësin e Ri) që rezulton që janë plot 25 vjet që Kukësi i vjetër është fundosur. Rrjedhimisht dhe Kukësi i sotëm i ka jo 15 vjet sa thotë Juriseviçi, por 25 vjet nga dita e fundit e "*jetës*" së Kukësit të vjetër! Kukësi i Ri ka filluar të ndërtohet më 22 korrik 1962 (sipas pllakatës që është vendosur në pallatin e parë të Kukësit të ri në Lagjen nr.1). Shkurt i bie që pjesë të qytetit të jenë 37 vjeçare. Një gjë duhet ta dijë mirë; ta mësojë edhe paçavureshkruesi në rast se nuk e di: Kukësi nuk është 15 vjeçar duhani por 25 vjeçar i shëndetshëm. I fortë, i gjallë, me njerëz të zgjuar, me moshë mesatare mjaft të re, me qytetarë atdhetarë, mikpritës e bujarë të cilët megjithëse me një popullsi 20-25 mijë banorë, priti, strehoi, ushqeu dhe mbrojti 200-300 mijë shqiptarë të Kosovës që u dëbuan me dhunë nga trojet e tyre etnike prej regjimit fashist serb në vitin 1999. Një "*qytezë e plakur*", një popull i pashpresë, një vend i padashuri, i padashur dhe i pashpresë (siç shprehet e shkruan autori për Kukësin) assesi nuk mund të bënte atë që bëri ky qytet që arriti të kthehet në kryeqytetin e shpresës kombëtare shqiptare, në simbolin e mikpritjes, bujarisë, sigurisë dhe të humanizmit në shkallë botërore.

XIII – Rëndësia e qytetit të Kukësit në tejkalimin e krizës

Vëmendja dhe sytë e gjithë botës ishin në Kukës deri në atë shkallë sa Shqipëria dhe Kukësi identifikonin njëri-tjetrin! Shqipëria priti rreth një milion refugjatë duke shmangur katastrofën humanitare të shekullit dhe kryeqyteti i shpresës, humanizmit dhe i bujarisë mbeti Kukësi. Në librin e Besim R. Cengut "*Përmasat e mbijetesës*" në faqen 128 është shkruar fjala që ka thënë në Kukës gjatë vizitës së saj më 8 prill 1999 Sadako Ogata, Kryekomisionerja e Lartë e OKB-së për Refugjatët e cila thotë: "*ne falënderojmë dhe respektojmë thellë kontributin që po jep populli i Kukësit. Ky*

popull është bujar si rrallë ndonjë popull tjetër. Të mbash, të ushqesh, e t'i shërbesh një mase njerëzish që kalon më shumë se pesëfish numrin e banorëve të tij, do të thotë, që ju keni bërë atë që pakkush e beson. Ky akt i lartë i juaji, pra i popullit të Kukësit, na obligon ne edhe më shumë për t'ju ndihmuar të përballoni situatën e krijuar...Pra ne nuk do të ndihmojmë vetëm kosovarët, por edhe këtë popull të mrekullueshëm që ka ndarë kafshatën me ta".

Vlerësimin për Kukësin dhe për popullin e tij e bëri bota. E bëri mbarë njerëzimi dhe atë vlerësim ky qytet e meriton plotësisht prandaj ishte kandidat potencial për çmimin "*Nobel*" për paqe. Vetëm vitaliteti i një populli si i Kukësit, sakrifica e jashtëzakonshme e këtyre banorëve, humanizmi e karakteri i vendosur i tij bëri të mundur përballimin e suksesshëm të situatës absolutisht të paimagjinueshme dhe tejet të rrezikshme të të ardhurve nga Kosova. Vetëm kështu duke dashur jetën e njëri-tjetrin u evitua kriza mëe madhe humanitare pas Luftës së Dytë Botërore. Zhak Shirak, presidenti i Francës në atë kohë do të shprehej se "*Në rast se Francës do t'i duhej të pranonte rreth 800 mijë refugjatë në një periudhë kohore aq të shkurtër (79 ditë) ajo do të gjendej në pragfalimentim*". Ndërsa Kukësi dhe Shqipëria nuk falimentuan, nuk u dorëzuan (siç kishte dëshiruar e planifikuar dikush) por e përballoi me sukses të plotë krizën e vitit 1999 duke mbetur shembulli më i shkëlqyer për çdo popull në botë. Komentet, përshkimet, shpifjet, gënjeshtrat, fantazitë dhe përpjekjet e Juriseviçit nuk ndikojnë në asnjë rast e në asnjë rrethanë që shqiptarët t'i paraqesë si kriminelë, vrasës, banditë... S'kanë e s'do të kenë asnjë vlerë, asnjëherë! Historia flet ndryshe, bota dhe njerëzimi kanë bërë dhe bëjnë vlerësimin më të mirë. Çdo njeri në botë ka dy alternativa; të besojë, respektojë dhe vlerësojë popullin shqiptar për përballimin me sukses të krizës më të rëndë njerëzore pas Luftës së Dytë Botërore, ose

të besojë, të respektojë, dhe të vlerësojë Juriseviçin dhe të gjithë "*viç*"-ët e tjerë për të kundërtën. "*Ndalem në sheshin e qytetit, afër zyrave komunale dhe i shikoi nënat me fëmijët në karroca të vjetra që palosen*" shkruan Juriseviçi më tej duke bërë tinëzisht (si gjithmonë) një krahasim që nuk mund të bëhet sepse Kukësi është një qytet në kushte absolutisht të pabarabarta me Adelajden; njëri qytet (Kukësi) është në luftë, në prag të krizës humanitare me një mbingarkesë njerëzore në raport me hapësirën që ka. Ndërsa tjetri qytet, Adelajde është në paqe, në mirëqenie e zhvillim ekonomik të lartë. Mirëpo ç't'i bësh, ky është zakoni i Juriseviçit: ta nxijë Kukësin siç di vetëm ai, siç do vetëm ai, sepse misioni i tij i poshtër ia kërkon. Dhe i bie në mend për krahasim edhe kur "*po i zien koka nga problemet*" sepse ka dalë të gjejë Milaimin e tij për ta "*pyetur*", e për t'i dhënë "*zgjidhje*" problemit të "invadimit të serbëve" në Kukës. Ai nuk i beson askujt (jo vetëm Mc Namora-s së UNHCR-së), prandaj e donte Milaimin me çdo kusht sa më shpejt (çudi pse po e kërkonte në këmbë dhe jo me radio apo me makinë!). E kërkon se vetëm ai do t'ia thoshte ato që kishte në mendje edhe vetë Juriseviçi (si gjithmonë) bash ato që i duheshin! Pasi endet nëpër Kukës dhe më në fund futet në bar "*Amerika*" të cilin e përshkuan si "*vendi ku bëhen të gjitha allishverishet, qoftë për të mirën e refugjatëve, që derdhen në Kukës e shumë të tjera për të mirën e të këqinjëve*" (!) Sipas Juriseviçit, këto të dhëna për bar "Amerikën" ia kishte dhënë Milaimi. Sapo u fut brenda në bar, menjëherë bëri bilancin e njerëzve që ishin aty kur shkruan se "*mund të identifikojë disa nga mjekët që kam takuar këto tri ditë, por më shumë ka gazetarë e tipa që i takojnë mafias lokale*". Duket se është më pak kirurg, e më shumë…një misterioz, një njeri që fsheh diçka që është gjithmonë në aksion për të zbuluar e ditur gjithçka.

Duke e pirë birrën që ia dhanë "*me zor*" (nuk dimë se kush ia dha birrën) e gjen Milaimin të ulur në tavolinë dhe menjëherë futet në "*temë*". I thotë Milaimit se "*jam i brengosur për invadimin, për të cilin flasin të gjithë*" dhe mbasi e shoshitin mirë me të, ky i fundit i thotë se "*Invadimi, evakuimi janë krejt pallavra, gjëra pa lidhje*". Dhe diskutimi vazhdon se "*Këta njerëz, NATO-ja, OKB-ja frikësohen shumë lehtë. Që prej se kanë ardhur në Kukës janë duke folur për invadime*". Shqetësimin dhe merakun e Juriseviçit për invadimin ia heq Milaimi dhe ia mbush mendjen se "*serbët nuk do të invadojnë. Nuk do të bombardojnë kampet*" duke e bindur atë. Milaimi i thotë se serbët janë të çmendur, por i sugjeron të jetë i qetë sepse ky është stili i Milaimit për të qetësuar të tjerët. Mirëpo ç'është e vërteta, Juriseviçi qetësohet e rehatohet përfundimisht dhe i mbushet mendja plotësisht se s'do të ketë invadim vetëm kur dy shokët e Milaimit në tavolinë (pasi Milaimi ua përkthen brengat e Juriseviçit) tundin kokat, më shikojnë e thonë: "*Jo, jo serbët nuk vijnë". Po kush janë dy shokët e tavolinës së Milaimit që janë aq të sigurt që serbët nuk vijnë*" (mos vallë janë zëdhënës të Millosheviçit!?). Kësaj pyetje mund t'i përgjigjet vetëm Milaimi e ndoshta edhe Juriseviçi. Në funksion të realizimit të misionit të tij Juriseviçi, mundohet t'i shmanget politikës (siç thotë vetë), por realisht, nuk mund t'i shmanget sepse nuk mund t'i shmanget misionit të tij djallëzor. Prandaj edhe "*argumenton shkencërisht*" apo më saktë në mënyrë çubrilloviçëse kur shkruan se "*po, serbët janë duke u shkaktuar tmerre të papërshkruara shqiptarëve të Kosovës, por këtë janë duke e bërë me urrejtjen që kanë në zemrat e tyre për shkak të tmerreve të ngjashme që i kanë përjetuar gjatë shekujve. Përvoja më e freskët: serbët iu nënshtruan dëbimit të dhunshëm nga Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore deri sa ishte i okupuar nga shtetet e boshtit. Përpjesëtimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë ka*

lëvizur andej-këndej ku secila baticë e zbaticë ka lënë prapa me mijëra kufoma e refugjatë"(!). Harron Juriseviçi apo ia "*do mushka drutë*" kur i shkruan ato gënjeshtra e të pavërteta, ato shpifje monstruoze që duket sikur dalin nga vetë goja e Millosheviçit të zi.

Historia e vërtetë, dokumentat dhe statistikat flasin ndryshe. Flasin qartë e pastër se Kosova, ka qenë, është e do të jetë tokë shqiptare. Populli i Kosovës është popull shqiptar. Teoria e Çubrilloviçit dhe gjenocidi permanent i serbëve për shqiptarët e Kosovës kanë arritur të dëbojnë me dhjetëra e qindra mijëra shqiptarë nga Kosova për në vende të tjera sidomos në Turqi. Ky gjenocid serb është ushtruar periodikisht dhe pandërprerje. Në librin voluminoz dhe cilësor "*Genocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare*" të studiuesit Shaban Braha me anën e dokumenteve arkivore origjinale, me fakte dhe shifra të sakta jepet numri i të vrarëve, masakruarve, plagosurve, zhdukurve dhe të shpërngulurve jashtë Kosove të banorëve të saj etnike. Vitalitetin, forcën, dëshirën dhe vullnetin për ta mbrojtur, për ta përtërirë e për ta shtuar jetën e kombit të tyre shqiptarët e kanë pasur, e kanë dhe do ta kenë dhuratën më të çmuar nga Zoti i Madh. Nuk ka ndodhur kurrë që serbët t'i jenë nënshtruar gjenocidit shqiptar. Kurrë! Shqiptarët në historinë e tyre mijëravjeçare kanë luftuar vetëm në kufijtë e territoreve të tyre etnike kundër armiqve të huaj pushtues në çdo kohë. Nuk është faji i shqiptarëve (siç e kemi thënë më parë) se 12 mijë ushtarë serbë janë vrarë në Lumën e Kuqe në nëntorin e vitit 1912. Ata erdhën në Lumë dhe e kërkuan vdekjen duke sulmuar për ta pushtuar e vrarë, djegur e therur me bajoneta. Ushtarë serbë vranë të pafajshëm, burra, gra, pleq e fëmijë. Madje kanë therë me bajoneta dhe fëmijët në barkun e nënës! Por kurrë nuk e nënshtruan popullin shqiptar. Kjo është e vërteta e jo paçavurja e Juriseviçit. Është e shkruar në Muzeun e Beogradit një "*betim*" i

serbëve: "*Mos harroni Kullën e Lumës*". Le të mbetet ai shkrim si kujtesë për vetë serbët që asnjëherë s'duhet t'u bien në qafë të tjerëve dhe duhet ta kenë "vath në vesh" sidomos kur kanë përballë shqiptarët. Historia na e ka dhënë mësimin më të madh se "*çdo pushtues, sado i fuqishëm të jetë gjen humbjen e sigurt, gjen vdekjen, sepse lufta për liri është e shenjtë, e ligjshme dhe më e fuqishme se lufta për pushtimin, grabitjen dhe shkatërrimin e të tjerëve*". Luftën çlirimtare e bekon Zoti, luftën pushtuese e dënon dhe e mallkon Zoti.

Nejse. Sapo niset për në kufi, Juriseviçi detyrohet të kthehet pasi e thërrasin në një mbledhje urgjente me drejtorin mjekësor të UNHCR-s Daniel Everts dhe me nënkolonel Mahmudin e kampit të EBA meqë "*spitali i EBA do të mbyllet*". Mahmudi i thotë Juriseviçit se kjo bëhet zyrtarisht për: "*Vështirësi të parapara të natyrës teknike*". Juriseviçit i vjen përsëri rasti (më saktë e sjell vetë rastin) të shprehet kriminalisht kur shkruan se "*do të duhet të dërgojmë më shumë pacientë në spitalin e Kukësit, që është përafërsisht njësoj si t'i ftosh të vdesin*". Vetëm djalli dhe krimineli mund të flasë me kaq mllef patologjik kundër spitalit të Kukësit me aq kontribut në përballimin e krizës së vitit 1999. Këtë fakt e kanë njohur dhe e kanë deklaruar të gjithë, e kanë parë të gjithë. Këtë e vërtetojnë edhe statistikat dhe të dhënat e veprimtarisë së spitalit të Kukësit. Ato të dhëna janë të qarta, të sakta dhe të pakundërshtueshme. Në vazhdim shkruan se "*Rrugëtojmë për në Bajram Curri, një qytet më i madh, për të vlerësuar situatën dhe për të koordinuar ndihmat mjekësore në atë zonë sepse refugjatët nuk kishin pasur ndihmë mjekësore*", - shprehet Juriseviçi. "*Do të kthehemi me ata që kanë nevojë për kujdes në kirurgjinë e Kukësit*", - thotë Juriseviçi. Çudi! Për herë të parë i "*pëlqen*" kirurgjia e spitalit të Kukësit! Rrugës për në qytetin "*Bajram Curri*" mahnitet me bukuritë natyrore, por mendjen e ka diku tjetër, e "*frikëson*" shumë ndonjë sulm

serb kundër ambulancave në kolonë se ato nuk e kanë as emblemën e Kryqit të Kuq. Emblemën e Kryqit të Kuq e mbajnë vetëm automjetet e Kryqit të Kuq, por këtë nuk e di shkruesi i rreshtave të këtij libri. Nuk kanë të drejtë ta mbajë askush tjetër as shoqatat, as institucionet e tjera të çfarëdollojshme pasi përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar. S'e kuptojmë pse e quan "*gabim të madh*" që makinat e IMC-s nuk e paskan emblemën e Kryqit të Kuq! Një natë më parë si gjithnjë e ka parë në ëndrrën e vet të përnatshme që ka aq frikë nga ndonjë sulm serb mbi kolonat e makinave. Si për çudi vetëm 500 metra para kolonës së ambulancave ai sulm ndodhi dhe shkruan se "*një sulm artilerie e ndal kolonën tonë, sulmi është kryer vetëm 500 metra larg nesh dhe nuk e dimë se jemi në shënjestrën e tyre*". Juriseviçi e ka komoditetin ta trajtojë siç dëshiron vetë atë ngjarje (që sipas gjithë gjasave është kryekëput gënjeshtër). Ai thotë që sulmi i artilerisë serbe kishte objektiv një fshat (pa emër) brenda kufirit të Shqipërisë dhe kjo bëhet vetëm "*për të vrarë njerëz*". Kështu i thotë Milaimi i tij. Asnjeri nuk e dinte emrin e fshatit që u sulmua. Asnjë njeri nuk e përmendi emrin e fshatit (!), por "*ne i afrohemi një fushe loje, afër një çerdhe ku tymi dhe era e sulmit të artilerisë ende ndihet në ajër, ndërsa nga dritarja e 'Land Cruiserit' shohim një masakër*". "*Shumë të vdekur paska*" - thotë Milaimi, - *dhe shumë janë fëmijë (bile të gjithë janë fëmijë)*", - konstaton ai. E ne themi se s'ka si të ndodhte ndryshe derisa Juriseviçi e ka parë në ëndërr ngjarjen. E tashmë e mëson se ëndrrat i dalin të "vërteta"! Ai e ka vendosur ëndrrën në çerdhen e fshatit pa emër! Vetëm sytë e djallit e kanë aftësinë, durimin dhe pashpirtësinë t'i "*shohin*" dhe t'i "*përshkruajnë*" në paçavure. Vetëm truri i djallit i fantazon ato tablo tmerri që pas dhjetë vjetësh rikujtohen dhe shkruhen në paçavuren që quhet libër. "*Dalim prej veturës dhe ndërmjet rrënojave të shpërthimit nis të kërkoj ndonjë të mbijetuar duke i shikuar kalimthi ato*

që nuk kanë shpëtim. Nuk po gjej kraharorin e një pale këmbësh të vogla, e kur i gjej nuk e di cilave këmbë u takon; aq shumë gjymtyrë, aq shumë krahë e duar dhe këmbë me çizme të mbathura. Ndalem para trupit të pajetë të një vajze, kukullës së saj e cila e padëmtuar e thithte gjakun e saj aty pranë. Janë gjetur pesë fëmijë që do të mund të shpëtonin dhe menjëherë fillojmë ndihmën mjekësore. Ndërsa vajtimi i njerëzve të fshatit teksa shohin fëmijët e tyre të bërë copë, ma këput shpirtin! Nuk mundem të shpëtojmë asnjë, të gjithë fëmijët vdesin"! Sipas Juriseviçit të gjithë fëmijët e fshatit pa emër vdesin, se ai i donte të vdekur! Kështu i do regjisori që e ka urdhëruar të shkruaj një libër me skenar të përcaktuar, edhe pse nuk është i vërtetë. Që nga Kukësi e deri në Tropojë i kemi verifikuar të gjithë fshatrat pa asnjë përjashtim (jo vetëm ato të zonave kufitare) dhe në asnjë rast, në asnjë fshat, në asnjë ditë apo natë nuk ka ndodhur një ngjarje e tillë ku janë vrarë fëmijë çerdhe nga sulmet e artilerisë serbe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë! Nuk ka asnjë dëshmitar në fshatrat ku kemi qenë, nuk ka asnjë dëshmitar nga forcat kufitare shqiptare të asaj kohe, as nga forcat e ushtrisë shqiptare që kanë qenë të dislokuara në mbrojtje të zonave kufitare dhe të kufirit shtetëror që ta pohojë se ajo ngjarje ka ndodhur. Asnjë media lokale, kombëtare apo botërore nuk ka folur asgjë. Të gjithë e dimë se mediat jo vetëm ishin të shumta, por ishin nga të katër anët e botës dhe nuk besojmë se një ngjarje e tillë kaq makabër, një katastrofë e tillë e paimagjinueshme dhe një krim të tillë të paparë dhe të padëgjuar ndonjëherë nuk do të përbënte një lajm tronditës. Nuk besojmë se po të kishte ndodhur ajo ngjarje do të kishte heshtje varri. Na duhet të t'i themi këto fjalë edhe pse dimë se nuk do të ndikojmë se djalli prandaj është i tillë!

Ajo ngjarje nuk ka ndodhur kurrë. Ai sulm i artilerisë serbe mbi çerdhen e asnjë fshati nuk ka bërë vaki. Ata fëmijë

nuk kanë vdekur, nuk janë vrarë. Fëmijë jetojnë e do të jetojnë pavarësisht se Juriseviçi i do të ishin të vdekur. Vetëm djalli, vetëm misioni i djallit dëshiron, planifikon dhe punon për të vrarë fëmijët, qeniet më të pastra e më të pafajshme njerëzore. Është e qartë se kemi të bëjmë me një individ që ka në gjithë qenien e tij një urrejtje patologjike për fëmijët shqiptarë dhe për shqiptarët në përgjithësi. Misioni i djallit është brenda paçavureshkruesit.

XIV - Komb Vital!

Autori i librit duhet ta ngulite thellë në trurin e tij të sëmurë se të gjithë ata fëmijë që kjo mostër i ka dëshiruar të vdekur, janë gjallë plot shëndet. Sot një pjesë mësojnë, një pjesë punojnë për kombin dhe për vendin e tyre. Një pjesë tjetër e tyre që në atë kohë ishin në kopsht apo në shkollën fillore sot japin një kontribut jo të vogël edhe në vendet e Evropës, SHBA, deri në Australinë e largët nga ku ka ardhur Juriseviçi. Punojnë e jetojnë me dinjitet e me aftësi konkurruese të admirueshme.

Natyrisht që "*superheroi*" i di të gjitha dhe të gjithë presin prej tij zgjidhjet e situatave, por Juriseviçi është në "hall" sepse s'mund të premtojë me ndërgjegje të pastër kur njerëzit nëpër kampe e pyesin: "*Më e keqja kaloi apo jo?*" Ai më poshtë shkruan: "*ç'ka mund t'u premtoj me ndërgjegje të pastër? Se serbët nuk do të invadojnë Shqipërinë dhe se nuk do t'i bëjnë kampet cope. Do të doja të mund t'ua premtoja këtë. Do të doja të thosha: Ne do t'ju shpëtojmë, ne do t'ju ruajmë, vuajtja juaj po mbaron*". Mendja e çdo njeriu normal e kupton se Juriseviçi nuk është personi i duhur që t'u japë përgjigje atyre pyetjeve që vetë i shtron. Sepse ai nuk e ka asnjë mundësi reale të bëjë një gjë të tillë; një kirurg i ardhur nga Australia nuk mund të bëjë asgjë tjetër veçse trajtimit mjekësor të pacientëve të sëmurë ose të

plagosur në luftë. Ai nuk ka as detyrë, e as mundësi tjetër në dorë. S'besojmë se kishte ndonjë njeri në atë kohë që të mos e dinte se për luftën në Kosovë, për zgjatjen ose mbarimin e saj, vendimmarrjen e kishte NATO-ja, SHBA-ja, e BE-ja pa e pyetur fare as Juriseviçin e as "*Tmadhviçin e Serbisë*".

Por siç e kemi provuar edhe në misionin e tij humanitar Juriseviçi është *"për të ardhur keq*" pasi nuk ka punuar si kirurg në sallën e operacionit në periudhën e eksodit 1999. I vetmi "*kontribut*" dhe e vetjma "*meritë*" e tij në fushën e mjekësisë, konkretisht të kirurgjisë është fakti se ia ka mbajtur me mjaft kujdes bolet një kosovari kur dr. Vata po kryente operacionin për t'i hequr dhjamin në bolen e djathtë! Dhe s'është pak për Juriseviçin kjo punë!

Foto nga kampet e refugjateve në Kukës

Ky operacion ka ndodhur më 4 maj 1999 në sallën e operacionit të kirurgjisë e ku Juriseviçi "*ndihmon*" Ylber Vatën që e ka kryer operacionin. Kjo është dita kur Juriseviçi ka hyrë për herë të parë dhe njëkohësisht për të fundit në

operacion si asistent apo ndihmës i dr. Vatës. Asnjëherë tjetër Juriseviçi nuk është dukur në operacion. Gjatë operacionit Vata i vuri detyrë asistentit (Juriseviçit) që t'ia mbante bolet kosovarit. Dikush duhet t'ia mbante se duhet ta bënte atë "*punë*". Dhe në respekt u gjet Juriseviçi, i cili ç'është e vërteta edhe në prezencën e tij të parë në një operacion në sallë doli nga "*kompetenca*" e asistentit të dr. Vatës. Siç thotë Besa Cami që ka kryer detyrën e instrumentistes në atë operacion, Juirseviçi debatoi me dr. Vatën për dr. Uillin (mjek kirurg amerikan që punonte shpesh me kirurgët e Kukësit në sallë) duke bërë vërejtje deri edhe pyetje se "*pse pranoni dr. Uillin në sallën e operacionit*"!?. "*Jo vetëm kaq*, - thotë Besa, - *por ai (Juriseviçi) "fshehurazi, tinëzisht ka fotografuar dhomën-depo të materialeve të dala jashtë përdorimit*" për ta përdorur si argument që pas dhjetë vjetësh ta përshkruante sallën e operacionit siç ka bërë vetëm ai. Kërkon mbështetje Juriseviçi për ta kryer misionin e tij dhe e gjen, e thotë vetë se: *"Mbështetem tek kolegët e mbi kirurgë si Toccafundi (Italian te kampi Italia) dhe dr. Vata*" dhe herë pas here operoi me ta, por zakonisht operoi "*vetëm*" shkruan më poshtë! Operacion vetëm!? E çuditshme të operosh vetëm është absolutisht e pamundur! Tashmë dihet se u bë përrallë puna e operacioneve të tij në sallën e operacionit me dr.Vatën, prandaj të merresh me të është jo vetëm kohë e humbur por edhe e bezdisshme për lexuesin. Juriseviçi e kërkon dr. Vatën sot se "*për një apo ndonjë arsye tjetër e kam një nevojë të madhe të flas me Ylberin, të dëgjoj atë që ka për të më thënë për politikën dhe rajonin: Të gjitha që i di për shtetet e gadishullit të Ballkanit janë abstrakte dhe teorike por Ylberi jeton në kaosin e politikës ballkanike përditë"*. Oh, çfarë kirurgu! Mbasi ka bërë "*namin*" në kirurgjinë e spitalit të Kukësit i vjen radha "*namit*" tjetër.

XV – Nëpërkëmbja e personalitetit

Mbasi ka bërë "*namin*" në kirurgjinë e spitalit të qytetit të Kukësit i vjen radha "*namit*" politik. Juriseviçi do të mësojë më shumë (më shumë se sa di) për politikën e rajonin dhe këtë e kërkoj prej dr. Vatës, mjekut kirurg i cili në atë kohë ishte vetëm një mjek i thjeshtë. I vetmi që mund ta ndihmonte në "*hallin*" e tij politik do të ishte dr. Mustafa i cili më parë kishte qenë politikan dhe deputet i rrethit të Kukësit (1992-1996). Prandaj më e mira do të ishte të këshillohej me të dhe ta pyeste për çështjet politike që i interesonin. Po ku ta dimë nëse Juriseviçi nuk e ka parë në ëndërr politikanin Vata? Vetëm ai e dinte ëndrrën e tij dhe ëndrrat e tij dalin të vërteta! Në atë kohë jo, por me vonë dr. Vata u bë politikan, madje u bë kryetar partie, kryetar qarku i Kukësit dhe kandidat për deputet (pavarësisht se nuk fitoi)! Ne kemi dyshime të arsyeshme për lidhjen Vata-Juriseviç; nuk duket transparencë në atë lidhje!

Në kërkim të dr. Vatës shkon në sallën e operacionit dhe e gjen aty *"duke bërë një amputim (!) nën gju*" dhe është i gatshëm ta ndihmojë (si zakonisht në amputimet e tij imagjinare. Amputime që në fakt nuk janë bërë asnjëherë! Ylberi bën me shenjë në drejtim të *"një tipi të ulur në karrigen në kënd të sallës. Një kryemadh, i sertë, me kokë të rruar, i cili nuk dihet pse rri aty*". Që nga larg Juriseviçi e dallon dhe e vlerëson amputimin e Ylberit të pavend pasi plaga ishte infektuar e duhej prerë ditë më parë duke pyetur veten: "*Pse janë vonuar?*". "*Sa herë përpiqem që ta shtroj ndonjë pyetje, Ylberi kthen shikimin nga këndi dhe nga unë duke tundur kokën lehtë. Duhet të pres që t'ia këpusë këmbën e të dalim së bashku me Ylberin nga salla që të kuptoj me shumë*". Por Ylberi i thotë: "*Jo këtu dhe më tërheq me vete deri në një kënd të korridorit ku nuk na sheh askush duke ju dridhur dora ndez cigaren, e thith mirë*" dhe i shpjegon

Juriseviçit se "*ai tipi në qoshe është mafia, është mafioz dhe Cena me mafien i ka punët kështu*". E ndërsa Juriseviçi pyet: *"Cena është pjesë e mafias? Drejtori i spitalit?*". *"Jo, por punon për ta*", "*në spital mund të ndihmojnë vetëm nëse paguan mafian. A e kuptove?*", - thotë Ylberi.

Nga e gjithë kjo skenë e imagjinuar që mund të vlerësohet vetëm si një fantazi keqdashëse dhe një "*akuzë e butë"* për dr. Vatën, i cili bëri një ndërhyrje kirurgjikale të vonuar duke ndikuar jo seriozisht në rrezikimin e shëndetit për pacientin që iu pre këmba realisht dhe bazuar në dokumentacion kirurgjikale nuk ka ndodhur ndonjëherë! Por jo vetëm kaq. Frika e dr. Vatës bën që ai "*të ruhet shumë*" kur komunikon me Juriseviçin!? Pse? Vetëm ai e di dhe askush tjetër!

Të kesh frikë, të ruhesh nga ato që ke rreth e qark, nga mjekët, infermierët dhe punonjësit e tjerë me të cilët ke punuar e punon prej shumë vitesh duket paradoksale dhe e çuditshme. Vetëm Juriseviçi për Ylberin është njeriu i besueshëm. Njeriu të cilit mund t'i ankohet, njeriu të cilin e informon rregullisht për çdo gjë që ndodhë e s'ndodh në spital e në rrethin e Kukësit. E ç'ka nuk ndodh janë ato që i porositë, i kërkon e i dëshiron Juriseviçi, madje, për më tepër që i planifikon të ndodhin. Duket qartë se Ylberit vërtetë i ka hyrë frika në "*palcë*" nga lidhjet e veçanta që ka me Juriseviçin dhe në çdo çast bën kujdes të jetë sa më i fshehtë. Sa më larg njerëzve me të cilët punon gjithnjë vetëm për vetëm me Juriseviçin. Kështu ndodh kur në një çast kalon një infermiere (pa emër e pa mbiemër si zakonisht) pranë tyre. Ajo me siguri është në punën e saj pa asnjë lidhje me ata të dy (Vatën e Juriseviçin) por Ylberin e shqetëson shumë kur i thotë Juriseviçit se *"ajo është hafije, ajo është spiune*". "*Ylberi më merr me vete korridorit dhe dalim jashtë spitalit, në kafen e Bujarit në një qoshe të saj dhe aty, në siguri relative*", - thotë Juriseviçi, "*Ylberi më informon më*

saktë e më hollësishëm: Më tregon se një numër kolegësh në spital janë përfshirë dhe m'i jep emrat. Thotë se pacientët të cilët nuk mund të paguajnë i largojnë prej aty natën dhe i hedhin në kthina të errëta apo nëpër fushat jashtë qytetit" (!)

Dr. Vata pasi shfryhet tek Juriseviçi për kolegët e tij, mbasi e kryen "*punën*" e vet na del qartasi njeri pa identitet. Si njeri i kapur, si njeri i shitur e i blerë njëkohësisht, duke e ngarkuar veten jo vetëm moralisht por edhe ligjërisht si një shpifës pa kufi, mjeku Ylber Vata bën përpjekjet maksimale për të fituar "*titullin*" më të lig apo epitetin më të neveritshëm, spiun. Bile Vata bën kujdes dhe e këshillon Juriseviçin (pra jo vetëm se këshillohet, por edhe këshillon), duke e paralajmëruar se "*Cena mund ta vrasë! Sepse Cenës, Juriseviçi, i ka hyrë në pjesë, duke i dërguar të sëmurët tek Spitali i kampit italian tek spitali i EBA…duke mos i lënë në spitalin e Kukësit për Cenën*".

Dhe më tej pasi e paralajmëron Juriseviçin se Cena mund ta vrasë, njëkohësisht i kërkon ndihmë atij. Vata vetë na qenka i kërcënuar nga Cena me jetë dhe jo vetëm ai, por e gjithë familja, gruaja dhe fëmijët (!). I kërkon ndihmë që ta rregullonte të punonte jashtë spitalit të Kukësit, në IMC, UNHCR, MSF apo kudo tjetër jashtë spitalit të Kukësit.

Dr. Vata kërkon ndihmën e Juriseviçit se *"Cena nuk do të mendohet dy herë, po të vendosë të më vrasë. Kjo është Shqipëria. Vrasja është mënyra normale e afarizmit*". Më poshtë se kaq nuk bie dot burri, por duket se ndihmën nuk e kërkon aq për veten se sa për fëmijët e tij sepse më poshtë i thotë Juriseviçit se *"Tash është bërë rrezik për familjen time, shumë rrezik*".

Në fund të bisedës me Juriseviçin, krejtësisht i përulur dhe i dorëzuar, dr. Vata mund të pranojë edhe alternativën kur thotë se *"nëse mbes këtu mbase do të mbaroj si këta të tjerët dhe të bëj atë që ai (Cena-M.B.) do që të bëjnë*". Ndahet me Vatën (i cili shkon në spital), ndërsa vetë

shkon në bar "*Amerika*". Ulet në një tavolinë. Rastësisht afër tij, në tavolinën pranë ishin ulur *"disa amerikanë që po ankoheshin se nuk ka ngjarje për raportim në Kukës*". Kësaj here "rastësia" merr një rëndësi tejet të veçantë se ato amerikanët "pranë Juriseviçit" na qenkëshin gazetarë të gazetës "*The Stars and Stripes*" dhe sipas të gjitha gjasave e duan rrëfimin e Juriseviçit. Apo më saktë Juriseviçi dëshiron ta japë atë rrëfim. Rrëfimin e *"mafiozit Cena*", por vetë e thotë dhe e shkruan se *"po përmbahem*". "*Nuk kam prova (!) por edhe me prova, a do ta ndihmonte kjo Ylberin apo do ta bënte punën më keq*"? Hall i madh, mbrojtja e Ylberit! Ylberi ka bërë atë që nuk duhet bërë kurrë: Lejon praktikisht mirëfilli para këtij mjeku kirurg australian nëpërkëmbjen e personalitetit të tij. Përderisa ai nuk prononcohet të gjitha çka thotë Jurisiçi janë të vërteta dhe për më tepër dinjiteti i dr. Vatës nuk ekziston sepse ai i është marrë nëpërkëmbë poshtërsisht. Të përdoresh nga të tjerët për të arritur një qëllim djallëzor dhe të mos reagosh do të thotë se je pjesëtar i skenarit të krimit dhe i përçmimit të shqiptarëve dhe përpjekjeve titanike të tyre për të fituar lirinë.

XVI - Jo vetëm mjek, por edhe "*gazetar*"…

Është interesant fakti se gazetarët që mbulojnë fushatën e NATO-s (sipas Juriseviçit) nuk janë të kënaqur. Sepse nuk i kanë rastet që ato i duan (më duket se i do Juriseviçi) ose nuk po gjejnë rrëfimin e vërtetë për atë çka po ndodh në Kukës. E kur më në fund ai e vendosë t'i japë gazetarit diçka shumë të rëndësishme (natyrisht, vetëm kur t'i vijë koha), e ndërpret bisedën me të sepse i duhet të shkojë urgjent në kampin "Italian 1", por i premton gazetarit, i cili nga ana e tij i premton Juriseviçit se "*do të të nxjerr diçka të madhe. Nuk mund të më rezistosh për jetë*"! Çfarë mirëkuptimi në distancë, çfarë mirëkuptimi telepatik midis

Juriseviçit dhe gazetarit amerikan, midis *"ngjarjes shumë të rëndësishme*" që do t'i jepte Juriseviçi dhe se *"diçka të madhe*" që do të nxirrte gazetari në gazetën e tij!

Menjëherë niset me "*Land Cruiserin*" e tij me shpejtësinë e "*breshkës*" sepse "*shpejtësia është shumë e rrezikshme me gjithë ato fëmijë nëpër rrugë*". Harron Juriseviçi se rrugët ishin plot me njerëz të rritur, pleq, plaka e njerëz të çdo moshe. Për këtë arsye shoferët nuk e kishin asnjë mundësi tjetër, veçse të ecnin me shpejtësinë e breshkës. Rrugët, sheshet dhe gjithë hapësirat midis pallateve si dhe trotuaret ishin plot njerëz, si asnjëherë tjetër prandaj shoferët nuk kishin asnjë mundësi të ecnin me shpejtësi edhe sikur të donin. Por Juriseviçi e përmend *"shpejtësinë e breshkës*" mbasi thotë se para një jave "*më thirrën për shkak të një aksidenti te kampi gjerman 'Kapanamur' ku një kamion kishte aksidentuar për vdekje një fëmijë katër vjeçar kosovar*".

Edhe këtë fatkeqësi, (që vërtet ka ndodhur), në funksion të misionit të tij djallëzor e bën "*konkluzionin*" edhe më përdreq kur shkruan se *"Mund të gëlltis diçka, atë që vjen nga serbët, por ka diçka tepër neveritëse te fakti se fëmijët ia dalin të mbijetojnë për të ardhur në këto kampe, vetëm sa për t'u vrarë apo sakatuar nga ngasës të papërgjegjshëm*"

Përsa i përket rastit në fjalë, siç e thamë, me të vërtetë është një fatkeqësi shumë e rëndë. Por Juriseviçi e ka me të treguar pasi nuk ka qenë në vendngjarje (lëre se çfarë thotë!) sepse në atë moment në vendngjarje kanë qenë mjekët e shoqatës MSF (Mjekët Pa Kufi) dhe asnjë përfaqësues i IMC-s! Kjo është e vërteta, ndërsa ai (Juriseviçi) gënjen pa pikë turpi. Dëshmitarë okularë që kanë qenë prezent në atë moment në vendin e ngjarjes thonë se kamioni i ngarkuar me dru zjarri nuk ka qenë duke ecur me shpejtësi. Sipas tyre nuk ishte e mundur që me aq shumë njerëz nëpër rrugë, automjetet të ecnin me shpejtësi edhe

sikur të donin. Mjaft banorë të Gostilit ku ndodhi aksidenti dhe që kanë qenë prezent si Met Trota, Zaim Muçmataj, Rifat Cena, Hamdi Elezi...thonë se kamioni nuk ka qenë me shpejtësi. Zaim Muçmata e mban mend shumë mirë se mjekët që u gjendën në atë moment në vendngjarje ishin të shoqatës së MSF, me të cilët edhe ka biseduar (me anë të përkthyesit që kishin). Edhe Z. Çollopeku, E. Susuri, B. Susuri, L. Susuri (të ardhur nga Kosova) që kanë qenë prezent në vendngjarje kanë deklaruar në prokurorinë e Kukësit se kamioni nuk ka qenë duke ecur me shpejtësi. Edhe akt-ekspertiza e vendit të ngjarjes dhe e automjetit nuk nxjerrin shkak të aksidentit shpejtësinë e lëvizjes së automjetit. Juriseviçit ia bëjmë të qartë se ky ishte aksidenti i parë dhe i fundit në Kukës për periudhën 27 mars deri më 12 qershor 1999. Nuk ka patur asnjë aksident tjetër. Por dora e djallit dhe mendja e tij duke e shkruar e shprehur në shumës thotë se janë "*ngasës të papërgjegjshëm"*.

XVII – Rrenat nuk mbarojnë kurrë

Paçavureshkruesi nuk e di se një fjalë e urtë popullore thotë se *"rrena i ka këmbët e shkurtra*" dhe rrena zbulohet sa hap e mbyll sytë. “Kirurgu” kurrë nuk ka qenë prezent në vendngjarje. Më datën 4 maj 1999, kur ka ndodhur aksidenti vdekjeprurës për të miturin kosovar A.S., ka qënë për herë të parë dhe njëkohësisht të fundit në sallën e operacionit të spitalit të Kukësit ashtu siç e kemi të dokumentuar më përpara. Nuk ishte e mundur që Juriseviçi me 4 maj 1999 të gjendej në të njëjtën kohë edhe në Gostil, në vendin e aksidentit, edhe në sallën e operacionit duke asistuar dr. Vatën në operacionin e famshëm kur ia mbante me kujdes aletet kosovarit që dr. Vata po ia hiqte dhjamin në bolen e djathtë.

Kur arrin te “*Kampi Italia 1*” gjen komandantin italian të nervozuar e me cigare që e thithë thellë. Kjo për shkak se tre zyrtarë lokalë (pa emër, pa mbiemër, pa identitet as pozitë) i kishin thënë atij (komandantit italian) se "s'ka më operacione në spitalin e ‘*Kampit Italia 1*’. Sipas atyre zyrtarëve anonimë në Spitalin e ‘Kampit Italia 1’ nuk duhen bërë më operacione, mbasi të gjithë refugjatët që kalojnë kufirin dhe kanë nevojë për operacione duhet të shkojnë në spitalin e Kukësit. E natyrisht që komandanti italian (sipas Juriseviçit) i nervozuar thotë se spitali i Kukësit *"nuk i përballon të gjithë dhe njerëzit do të vdesin si miza. Ato janë kriminelë*" (thotë komandanti gjithnjë, sipas Juriseviçit).

Me "*analizë*" të shpejtë për atë që dëgjoi prej komandantit italian, Juriseviçi arrin "*përfundimin*" se *"Kjo është punë e Cenës, vendimi për t'i kthyer pacientët në spital të Kukësit është vendim afarist i Cenës*" duke vazhduar më tej me "*analizën*" e tij tinëzare kur thotë se termi "*kriminelë*" që italiani e përdori si metaforë për tre zyrtarët lokalë (anonimë, pa emër e pa mbiemër) u përshtatet atyre përnjëmend. Patjetër që Juriseviçi arriti në një "*sukses*" të misionit të tij se kriminelë i cilësoi shqiptarët dhe *"italiani i tij*" duke i shtuar *"një votë*" koalicionit të djallit kundër shqiptarëve. Hallin e ka tek arritja e objektivit të tij themelor se *"shqiptarët janë më të këqinj se serbët*"!

Duke menduar se edhe Kampi EBA mund të jetë i njëjtë me “*Kampin Italia*” nervozohet kur shprehet se *"ka diçka të rrezikshme që më vlon përbrenda. Por nuk dua të shkoj në spital e t'ia thyej eshtrat Cenës*". Çfarë trimi i çartur ky Juriseviçi i cili me gjithë atë të "*nxehur*" e "*të ndezur*", (kësaj here s'dihet pse) thotë se “*nuk do të marr asnjë rol që ma ka ndarë Cena me planin e vet*".

Mbi të gjitha e ka një merak e një shqetësim ky "*internacionalist*" i spikatur kur pyet veten (siç duket s'ka kë pyet). "*Po kosovarët ku do të mbeten? Kalojnë të zitë e ullirit*

në duart e serbëve e më pas bien në duart e kriminelit Cena që do të pasurohet nga mjerimi i tyre". Dhe si trim i madh e vendos *"Do t'i luftoj! Me çdo lloj çmimi do të mbetem këtu*", shkruan në paçavure. Sipas Juriseviçit Cena është qendra e Kukësit, është kërthiza e Kukësit, është kryekrimineli, kryebanditi, kryemafiozi, është sinonimi i çdo gjëje të keqe e antinjerëzore, është përfaqësuesi i shpirtit të errët dhe i pafytyrësisë së pakufishme.

Nuk duam ta marrim aspak në mbrojtje e as nuk mund të bëjmë një gjë të tillë në asnjë rrethanë. Sepse Cena jeton dhe punon edhe sot e vetë duhet të përballet me ato që shkruan Juriseviçi për të. Por një gjë ia themi me bindje Juriseviçit se kur e vlerësoi Cenën si "*kryemafioz*" me siguri gabon pasi duhet ta dijë mirë se mafia ka ose zbaton standarde shumë, shumë strikte, shumë të rrepta kur merr vendim të rekrutojë ose pranojë në radhët e saj anëtarë të thjeshtë, lëre më drejtues e kryedrejtues. Unë në bisedë me Cenën ia kam thënë se akuzat e Juriseviçit ndaj tij janë të padiskutueshme derisa të dëgjojmë reagimin e vetë Cenës. Mirëpo Bajram Cena, drejtori i spitalit të Kukësit në atë periudhë ç'është e vërteta, deri më sot akoma nuk ka reaguar. E duke njohur Cenën në jetë e në punë që nga muaji janar i vitit 1971 e deri më sot, mendoj se mafia me "*drejtues*" Cenën (!) është shumë e vështirë të funksionojë. Madje vihet në diskutim edhe emri i saj.

Duke biseduar me kolegët e tij të IMC-s, u tregon atyre reketin e Cenës dhe vuajtjet që ka ai, për mafiozët që po sillen vërdallë spitalit si dhe motivin e mbylljes së njësisë kirurgjikale të "*Kampit Italia 1*". E ndërsa kolegët e pyesin nëse janë të vërteta, nëse është e sigurt ajo që tregonte Juriseviçi (siç duket edhe ata nuk binden kaq lehtë, sapo e dëgjojnë atë që thotë Juriseviçi) ai thotë: "*Po, jam i sigurtë. Kam qenë vetë dëshmitar i kërcënimit. Cena po i do gjithë refugjatët ashtu që të mund t'i qethë"* (!). O njerëz, a ka

dëshmi më të besueshme se ajo e Juriseviçit? Ne nuk besojmë kurrë se është e saktë dhe e sigurt një dëshmi në rastin kur dëshmitari dëshmon dëshminë e tij për veten e tij. Dëshminë e tij e ndihmon një koleg (pa emër, pa mbiemër, pa iniciale) kur shprehet se *"Edhe unë e kam parë. Nuk doja ta besoja. Craigu ka të drejtë*". Por kapakun ia ve Roger-i kur thotë se *"Kam dëgjuar për pacientë që kanë vdekur nga gjakderdhja ngase nuk mund t'u paguanin 200 DM mjekëve të Shqipërisë. Më besoni ky është vend i korruptuar, siç e thotë Craigu*". Dhe s'ka se si të mos e besosh një dëshmi që personi që e dëshmon (Roger-i), atë dëshmi *"e ka me të dëgjuar"*! Menjëherë pas këtyre bisedave Juriseviçi niset në këmbë për në spital dhe që nga larg dallon Roger-in (bash atë me të cilin biseduan disa çaste më parë dhe e la me kolegët kur vetë u nis në këmbë për në spital (!) me "*shprehje tjetër të fytyrës"* të kundërt me atë që është mësuar ta shohë.

"*Mirëserdhe mbase mund të nevojitesh. Ata hajnat idiotë u përpoqën…Hajnat e spitalit! Mjekët, infermieret! A mund të besosh? U përpoqën ta thyejnë depon. T'i marrin barnat dhe pajisjet e t'i shisnin në tregun e zi. Vetëm mbi kufomën time! Ishin të armatosur, Craig! Madje edhe gratë! Revole e kallashë! Mutat e këqij*"! E kur Juriseviçi e pyet se ku janë tash, Roger-i i përgjigjet: "*U zhvesha deri në bole dhe vrapova drejt tyre duke bërtitur si i çartur. U futa ethet në bark. O djalë, veç t'i kishe parë*". Përveçse një bisedë tejet banale midis dy "*njerëzve*" dhe më banale se biseda e tyre e ndyrë, ajo që shkruan Juriseviçi në paçavuren e tij edhe më të ndyrë, asgjë më tepër se kaq nuk mund të quhet. Mundohet Juriseviçi që ta bëjë lidhjen në mes bisedës së mëparshme me kolegët e IMC-s dhe të ngjarjes imagjinare të depos...por ç'është e vërteta, asgjë nuk është reale përveçse në botë ka edhe "*trima*" bile ka *"trima mbi trimat*" që luftojnë me bole kundër njerëzve me kallashë e revole! Dhe sipas

Juriseviçit, dalin fitimtarë! Në të vërtetë këto janë ëndrrat tashmë të njohura të Juriseviçit. Ne që kemi jetuar e punuar në spital në atë kohë, ato që kanë qënë të shtruar, familjarët e tyre, vizitorët në spital, qytetarët e Kukësit dhe ato të ardhur nga Kosova, mediat lokale, kombëtare dhe botërore nuk kanë parë asnjë mjek, infermier apo personel tjetër të spitalit të armatosur as me kallash e as me revole! Kjo është e vërteta. Në spital s'ka pasur njeri armë pos armës që kishin rojet e sigurisë së spitalit dhe me rregullore e mbanin armën në kasafortë.

XVIII – Frika e ndjek pas…

Por Juriseviçit, tashmë kishte filluar t'i bënte *"bishti hije*". Prandaj turret të takojë Ylberin si gjithnjë, ndërsa Roger-i u fut në kafen e Bujarit përballë spitalit. Dhe pse donte ta takonte Ylberin!? E thotë vetë pa e pyetur kush. *"Po qe se ia tregoj rrëfimin për skemën e Cenës, Andersonit* (gazetarit amerikan) *më duhet ta lajmëroj Ylberin me kohë*" (!) E pyesim Juriseviçin: Ç'lidhje ka rrëfimi me Ylberin?

Si gjithnjë Juriseviç bën një rrugë e dy punë: edhe e kërkon Ylberin dhe sheh nga emergjenca ku ishin *"Njëzet a me shumë pacientë që rrinë të patrajtuar, vuajnë, qajnë, kanë gjakderdhje. I kapi dy mjekë shqiptarë dhe i urdhëroj që të përkujdesen. Pranojnë me ankesë*" (!) dhe vazhdon të shohë me sytë e djallit, me ata sy sheh vetëm zi, vetëm errësirë në një ditë maji të vitit 1999 duke "*parë*" ato që askush nuk i sheh sepse nuk ekzistojnë në të vërtetë, sepse në urgjencë nuk është vetëm ai! Sipas paçavures që e shkruan vetë tregon se u mësua edhe të bëhet "*trim*" duke arritur kulmin e trimërisë kur "*urdhëron*" dy mjekët shqiptarë të kujdesen për të sëmurët!

Nuk e beson kush Juriseviç "*trimin*" kur thotë se *"i urdhërova dy mjekë shqiptarë*" sepse nuk ka pasur asnjë fuqi urdhëruese apo kompetencë për të urdhëruar askënd veç

vetes së vet. Por meqenëse nuk kishte të sëmurë realisht, kot flet e kot shkruan. Për një pare, si thonë tek ne! Më në fund Ylberin e takon *"duke ngushëlluar familjaret e një viktimë që posa vdiq*" (pa emër, pa mbiemër, pa iniciale). Kësaj here, ndryshe nga herët e tjera, kur Ylberi zakonisht e informon Juriseviçin, ishte Juriseviçi që po e informonte Ylberin për ç'ka kishte ndodhur me depon e IMC-s!

Më në fund vjen çasti kur Ylberi e Juriseviçi i premtojnë njëri-tjetrit, falënderojnë njëri-tjetrin për *"luftën e tyre të përbashkët, për mirëkuptimin e shkëlqyer midis tyre*". Juriseviçi thotë se *"Do t'ju tregoj zyrtarëve të lartë të UNHCR-së për skemën e Cenës, nesër. Të "premtoj*". E Ylberi i afrohet më shumë duke e dëgjuar me vëmendje dhe Juriseviçi vazhdon "*skemën*". *"Rrethi i Cenës, e di, vjedhjen e parave të refugjatëve. Grabitjen. Lidhjen me mafian. Që të gjitha....*" e nuk mund të mungonte falenderimi i Ylberit *"Të falenderimit -Craig! Me gjithë zemër e kam. Nëse nuk bëjmë gjë, atëherë nuk dallojmë fare nga serbët. Por ki kujdes! Cena të urren*". Këto fjalë të Ylberit e lumturojnë Juriseviçin, sepse dalëngadalë dhe me durim edhe drejtpërdrejt prej gojës së Ylberit e tha objektivin e tij "*se shqiptarët janë më të këqij se serbët*"! Sepse Ylberi tha tekstualisht *"atëherë nuk dallojmë nga serbët*"! Në përfundim të bisedës duket se ka ardhur koha që tani Ylberi ta ndihmojë Juriseviçin sepse insiston apo këmbëngul ta takojë atë me "*disa djem të fuqishëm të UÇK në Kukës që do t'i dilnin në ndihmë po qe se do të kishte nevojë për mbrojtje dhe me disa zyrtarë të ndershëm*". *"Kërkesa e fundit e Ylberit vjen e përcjellë nga pikëllimi evident*", - shkruan Juriseviçi, pasi duhet ta ndërpresim kontaktin hë për hë. "*Cena përpiqet të ushtrojë presion mbi ne të dy, sepse beson se unë të jap informata*", - vazhdon Ylberi. "*Nuk dua të m'i kërcënojnë fëmijët me thika në fyt. Mik, shpresoj se do të ma falësh. Më ke thënë se ke një djalë*", - e përfundon Ylberi.

"Po e kam, vetëm pesë vjeç", - i them unë. Kur Ylberi më thotë se "besoj në mirëkuptimin" : unë i përgjigjem: "*Padyshim*". *"I shtrëngojmë duart shkurt, disi fshehurazi*" (!) *"Humbja e Ylberit kështu, por sado kohë më la pa një burim ngushëllim*", - shprehet Juriseviçi.

E informojnë se në Kukës do të vijë Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Kofi Anan dhe Juriseviçi menjëherë e mendon se *"Cena nuk mund ta prekë*" (Kofi Anan-in M.B.) kështu që atij do t'i tregojë çdo gjë. Por djalli mbetet djall dhe mendja e tij e mbrapshtë futet në veprim dhe e merr vendimin kur shkruan se *"Ajo që na nevojitet është një refugjat rrëfimi i të cilit do të shërbejë si ilustrim i pashpirtësisë me të cilën trajtohen kosovarët në Kukës. E që kjo të mos tingëllonte e vrazhdë na nevojitet një patericë në shfaqjen që po ndërtojmë që kjo të ketë sukses*".

Del qartë qëllimi kriminal i Juriseviçit në rregullimin perfekt të skenarit më të keq të mundshëm për të akuzuar, tashmë haptazi, personelin e spitalit të qytetit të Kukësit në funksion të misionit të tij antishqiptar. E thotë vetë se u nis në kërkim të refugjatit që i duhej që e preferonte dhe që do t'i shërbente siç do të dëshironte ai. Me ndihmën e kolonel Toccafundit e gjen refugjatin ideal tek MSF-ja (Mjekët pa kufi). Ajo është në të 20-tat dhe quhet Ariana të cilën Juriseviçi shkon dhe e takon duke i treguar edhe planin e tij, gjithashtu duke u përpjekur që kjo të mos tingëllojë si dikush që po e fut në telashe të rrezikshme. Juriseviçi thotë se ajo *"Nuk kundërshtoi: Dëgjoi me shprehjen bindëse të personit që nuk di për mashtrime dhe kurthe*". Ne nuk mund të bëjmë me faj Arjanën e gjorë sepse nuk e di se mashtrimet dhe kurthet janë zanati i djallit Juriseviç. E për ta bërë më prekëse dëshminë e Arianës për Kofi Ananin, Juriseviçi do të kujdeset vetë që ato që do t'i thotë Ariana të jenë të vërteta dhe vetë Juriseviçi do t'i shkruante e Ariana do t'i mësonte përmendësh.

Sekretari i OKB, Kofi Anan

A mund t'i besoni Juriseviçit kur ai ia shkruan Arianës ato që do t'ia thotë Kofi Ananit (?). Se ajo *"Kishte parë se si i vdisnin fëmijët, por nuk kishte asnjë hije urrejtje (pa lëre më urrejtje jo se jo) për ato që ia kanë vrarë fëmijët*". Si është e mundur që nëna nuk paska *"asnjë hije urrejtje për ata që ia vranë fëmijët para syve të saj*" (!). Është në dilemë Juriseviçi, sepse e kupton dhe se fsheh se po abuzon në mënyrë kriminale me Arianën! Mos vallë serbët i kishin bërë ndonjë nder që ia kishin vrarë fëmijët para syve të saj që ajo të mos i urrente!? Nuk besojmë që mund të gjendet ndonjë nënë në botë që të mos urrejë kriminelët që ia vrasin fëmijët para syve të saj! Përveç "*nënës*" që ka gjetur Juriseviçi e cila na qenka "*shqiptare*" dhe nuk i urrente vrasësit e fëmijëve të saj që ishin ushtarët serbë! Absurditet e krim, krim e absurditet së bashku. Çdo gjë është në funksion të misionit të djallit.

XIX – Paradokse pa fund

Çdo njeri normal në botë e kupton qartë se sa e vërtetë është dëshmia e Juriseviçit (faktikisht "*dëshmia*" është e Juriseviçit e jo e Arianës), por që duhet ta mësojë përmendësh e ta thotë para Kofi Ananit Ariana e gjorë, e tradhtuar kriminalisht! E shkruan vetë në paçavure tekstualisht: *"E kaloj natën duke e qitur në letër atë që do të them nesër. Improvizimi e ka vendin e vet, por jo në situata si kjo. E shkruaj versionin e parë e s'pastroj, e shkruaj të dytin e ushtroj*". Hall i madh kjo "*dëshmia*" e Arianës, sepse ajo dëshmi imagjinare duhet t'i shërbejë doemos misionit…të Juriseviçit, askujt tjetër! E kishte "*pjellë*" rastin më ekstrem, sepse kështu i duhej kur në faqen 92-93 të paçavures shkruan: *"Ariana është kosovare 24 vjeçe nga Kushnini, një fshat dhjetë kilometra përtej kufirit. Fshatin e kishte sulmuar një njësi paramilitare serbe; burri dhe dy fëmijët e saj, një djalosh trevjeçar dhe një vajzë pesëvjeçare u vranë para shtëpisë së tyre dhe para syve të saj. Në shtatëzani të avancuar atëherë iku në mal me disa fshatarë të tjerë përfshirë edhe nënën e vet. Në ikje e sipër lindi vajzën, Besianën, të vetmin fëmijë që i ka mbijetuar. Dy ditë me vonë, në një pyll afër linjës së frontit, ajo së bashku me grupin u zunë mes këmbimit të zjarrit ndërmjet forcave serbe dhe atyre të UÇK-së. E qëlluan në zogun e këmbës së djathtë, duke ia thyer atë në disa vende. Pasi eci dy ditë me ndihmën e nënës, arriti te kufiri i Morinit. Prej aty e dërguan në spitalin e Kukësit. Aty personeli i kërkoi para dhe meqë nuk kishte për të paguar ia mohuan trajtimin dhe e lëshuan nga spitali. Më vonë e çuan në kampin Italia ku u operua dhe u rehabilitua shpejt*".

Duket qëllimi i dëshmisë së Juriseviçit kur thotë se do të synojë tek fjalia kyq: *"Aty (spitalin e qytetit të Kukësit-M.B.) personeli i kërkoi para dhe me që nuk kishte për të*

paguar ia mohuan trajtimin dhe e lëshuan nga spitali"! Por përsëri, nuk është i kënaqur me ato që ia ka shkruar Arianës dhe pyet veten në se *"a do të duhej ta theksoja, edhe më fajësinë e personelit të spitalit të Kukësit se sa e kam cekur*". E më tej Juriseviçit i duket se Kofi Anan nuk po e kupton kur shkruan se *"Dua që Kofi Anan të kuptojë atë që them. Është një akuzë, jo veç një shënim*". Megjithëse po bën një përgatitje "titanike" për t'ia thënë akuzën Kofi Ananit duket se nuk ka besim as tek burokrati Kofi Anan, as te OKB-ja, as te UNHCR-ja se do të ndërmerrnin ndonjë gjë ndaj atyre njerëzve që do të duhej të gjykoheshin si kriminelë lufte.

Misioni i tij e detyronte Juriseviçin të bënte ç'të ishte e mundur bile dhe të pamundurën që t'i thoshte Kofi Ananit se "*personeli i spitalit të Kukësit është më i keq se serbët*"! Dhe se janë *"kriminelë të luftës*", me qëllimin e vetëm që të merrte "*bekimin*" e Kofi Ananit për t'i shtuar një votë të rëndësishme koalicionit të djallit!

I dashur lexues! A nuk e gjeti vetë Juriseviçi, Arianën, a nuk ja shkroi vetë dëshminë disa herë në disa variante? A nuk ia mësoi vetë Arianës ato që ia kishte shkruar, a nuk e kërkoi te "*Kampi Italian 1*"? A nuk e gjeti te MSF-ja? A nuk e përgatiti të fliste para Kofi Ananit dhe insistoi te fjalia e tij kyqe?! Më shumë se kaq nuk mund të bënte Juriseviçi në zbatim të objektivit të tij kriminal! Deri sa të vijë Kofi Anan, Juriseviçi është shumë i shqetësuar nëse do të mund të bindë Sekretarin e Përgjithshëm me dëshminë e tij akuzë. Duke e ndjerë veten askushi (vërtet i tillë ishte ne fakt) ka një parandjenjë se Kofi Anan s'do t'ia varë. Pse bën çdo gjë që fjalinë kyçe të dëshmisë së tij t'ja fusë në vesh Kofi Ananit? E thotë vetë se *"Ajo nuk është dëshmi e thjeshtë, është akuzë për pakujdesi të qëllimshme të personelit të spitalit të Kukësit për trajtimin e refugjatëve*".

Më e lehtë, më e saktë e më bindëse do të ishte përpjekja e Juriseviçit që atë dëshmi-akuzë t'ia paraqiste

organeve të Prokurorisë dhe të hetimit si në Kukës, si në Tiranë, si në Hagë, si në Australi ku ta shihte më të arsyeshme. Kështu do të kontribuonte realisht në zbatimin e ligjit dhe në dënimin e fajtorëve që ai mendonte. Pse nuk veproi kështu atëherë dhe pse edhe sot është në po ato pozita vetëm Juriseviçi di t'i përgjigjet. Askush tjetër. Aq më shumë i motivuar është Juriseviçi për ta paraqitur dëshminë-akuzë në Tribunalin e Hagës kur mbeti i zhgënjyer edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-s, Kofi Anan, nga OKB-ja, UNHCR-ja…Por siç duket ballafaqimi me ligjin dhe me drejtësinë për Juriseviçin ishte shumë i vështirë dhe i pamundur; misioni i tij ngarkonte Juriseviçin të bënte vetëm akuza publike. Akuza në përgjithësi pa fakte e pa dokumente, pa emër e mbiemër që në asnjë mënyrë nuk mund të ballafaqohen me drejtësinë e vërtetë.

Për t'iu shmangur drejtësisë Juriseviçi në paçavuren e tij bën vetëm fantazi, thotë vetëm gënjeshtra e shpifje e nuk jep asgjë të saktë. As emra, as mbiemra njerëzish, as emra fshatrash, as emra e mbiemra të sëmurësh, të plagosurish e të vdekurish ose të vrarësh duke mbetur çdo gjë anonime, siç është ai vetë anonim. "*Tashmë është mesi i muajit maj dhe java e tretë që jam në Kukës duke kaluar maksimumin e kohës duke i kontrolluar personalisht pacientët që vijnë në spitalin e Kukësit*", - shkruan Juriseviçi. Por e kemi thënë dhe e kemi vërtetuar gjithnjë dhe po e themi përsëri se vetëm shpif e fantazon fund e krye. Sepse askush nuk e ka parë në spitalin e Kukësit as si figurë. Askush nuk e mban mend atë fytyrë pasi atë e kanë parë vetëm me datën 4 maj 1999 dhe asnjë ditë tjetër.

Të gjithë i mbajmë mend dhe nuk do t'i harrojmë kurrë dr. Uillin, dr. Dukagjinin, dr. Roger-in, dr. Keitën, dr. Terezën, dr. Lenën që së bashku me ne ishin çdo ditë në punë dhe kujdeseshin për të sëmurët e shtruar në spital. Nuk besojmë se është faji ynë që nuk e mbajmë mend Juriseviçin,

por është faji i tij që s'ka ardhur të punojë në spital që të mbahet mend. Si gjithnjë absurditeti vijon në libër kur vazhdon të shkruaj se "*E kontrobandove një kosovar 62 vjeç (pa emër, anonim) me një këmbë gangrenoze në kampit Italia në mëngjes dhe ia amputova pas dite. Do të mbijetojë. Hajnat në spital të Kukësit ia kishin ndaluar trajtimin. Ndërkohë po iki fshehurazi nga dera e prapme në përpjekje për t'ua shpëtuar jetën të pafajshmëve*". I njëjti avaz, i njëjti stil, me të sëmurë anonimë, me një fjalor të denjë vetëm për djallin (siç e kontrobandova një kosovar…!). Asgjë që përputhet me realitetin e ngjarjet konkrete. Prandaj Juriseviçi del gjithnjë nga dera e pasme, bile fshehurazi. Pse? Vetëm ai mund të përgjigjet për këtë sjellje. Më tej thotë: "*Vonë pas dite e takova një kameraman shqiptar nga Kosova, Milaim Zekën, i cili po shërohet nga një plagë shrapneli të një mortaje serbe. Kishte qenë duke xhiruar kampin e UÇK-s brenda në Kosovë. Plagët nuk i ka të rënda. E trajtoj në banesë*", - shkruan Juriseviçi.

Unë e respektoj të nderuarin, atdhetarin, gazetarin Milaim Zeka. E kam ndjekur dhe e ndjek me interes e me kënaqësi çdo emision të tij duke e falënderuar me gjithë zemër për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare shqiptare dhe në pasqyrimin e luftës çlirimtare. Sinqerisht do të dëshiroja që emri i nderuar i Milaim Zekës të mos ishte i shkruar në paçavurën e Juriseviçit, sepse ajo paçavurë është libri i djallit. A ka pafytyrësi, a ka turp më të madh se kur me djallëzi të "*kualifikuar*" Juriseviçi e përshkruan Milaim Zekën *"duke qarë*" kur dëgjon zërin e gruas së tij në Suedi? Milaim Zeka ka ardhur nga Suedia në Kosovë me vullnet të lirë, me dëshirë të shpirtit e të zemrës së tij për të luftuar për popullin e vet, për Kosovën, njëlloj si mijëra e mijëra shqiptarë nga të katër anët e botës për një qëllim e për një objektiv madhor: çlirimin e Kosovës e jo për të qarë siç shkruan Juriseviçi. Nuk ka qenë dhe nuk është

Milaim Zeka nga ata burra që "*qajnë*", por ka qenë dhe është nga ata burra që kanë luftuar e punuar për Kosovën, për Shqipërinë, për SHQIPTARINË

"Më thërrasin të shkoja urgjentisht në pikën e kalimit kufitar të Morinit, shkruan më poshtë, ku me mijëra refugjatë po dilnin nga pyjet dhe po i drejtoheshin Kukësit", - thotë më tej ku del qartë dëshira patologjike dhe objektivi i mbrapshtë kur shprehet se *"Pres të ketë gjymtyrë të enjtura me gangrenë, pres të ketë amputime*" (!) Një fakt duket sheshit: Juriseviçi do që shqiptarët të jenë të gjymtuar, pa këmbë. Ia do zemra që ata të jenë invalidë dhe të vuajtur gjatë gjithë jetës. Për të mos u zgjatur me përrallat e tij të zakonshme, e sqaroj lexuesin se mijërat e refugjatëve janë vetëm në mendjen e Juriseviçit, janë vetëm dëshirë e tij, por jo realitet. Mjafton vetëm të lexojmë faqen 220 të librit *"Përmasat e Mbijetesës*" të autorit Besim R. Cengu ku shkruhet se *"Ka më shumë se një javë që nga pikëkalimi në Morin nuk ka më kolona me refugjatë shqiptarë të dëbuar që vijnë në drejtim të Kukësit. Gjatë kësaj periudhe, kanë kaluar këtë pikë vetëm gjashtëdhjetë persona, ndërsa sot vetëm katër veta*". E në faqen 220 të librit të Besim R.Cengut bëhet fjalë për datën 21 maj 1999, pikërisht për datën 21 maj 1999 të faqes 102 të paçavurës së Juriseviçit që shkruan për "*mijëra e mijëra refugjatë*"! Si mund të besohet Juriseviçi kur shkruan ato që i mendon ato që i dëshiron, ato që i fantazon dhe jo ato që janë reale e të vërteta!?

Kur më 21 Maj 1999 kanë kaluar vetëm 4 veta (sipas të dhënave të Policisë Kufitare të Kukësit, Prefekturës së Kukësit dhe UNHCR-s) ku e merr atë të drejtë, ku e merr atë guxim që të shkruash në faqen 104 të paçavurës se *"Një mijë e pesëqind nga tetë mijë njerëzit që kaluan sot kufirin ishin të liruar nga burgjet serbe*".

Gazetari, Milaim Zeka

Këto *"gabime trashanike*" që deformojnë realitetin nuk mund të justifikohen me shprehjen e papërgjegjshme se "*libri bazohet në kujtime të largëta*" siç ka shkruar Juriseviçi në hyrje të paçavurës së tij. E kjo nuk mund të justifikohet sepse Juriseviçi e përcakton qartë, mjaft qartë kur shënon në fletoren e tij rrëfimet e një plaku kosovar me emrin Musli Jaha për tmerret, vrasjet, djegiet e shkatërrimet që bëjnë serbët duke i *"vrarë 14 veta të fshatit, tre ishin fëmijë. I pushkatuan fëmijët se pari, ashtu që prindërit të mund t'i shihnin*". Këtë serbët e bënë se fshati i tyre kishte strehuar tre ushtarë të UÇK-së, të *"cilët i kishin zënë rob, i kishin lidhur dhe i dogjën së gjalli; duke i lyer me naftë e duke u vënë zjarrin*". Këtë rrëfim rrëqethës, këtë ngjarje makabre, si një

dokument të saktë e shënon në fletoren e vet datën 21 maj 1999.

Nuk mund të ketë dy data 21 maj 1999 në pikën e kalimit kufitar te Morinit! Ne mendojmë se data 21 maj 1999 e faqes 220 të Besim R. Cengut është e vërtetë sepse ai bashkë me gazetarët e tjerë të mediave të ndryshme ishte në krye të çdo ngjarje e lajmi. Ishte kronikani besnik i asaj periudhe të vështirë me fakte e argumente. Ndërsa data 21 maj 1999 e faqes 102 të Juriseviçit është e rrejshme sepse është trillim i mendjes së tij.

Për t'u bindur po japim më poshtë të dhënat e sakta të numrit të kosovarëve që kanë kaluar kufirin në Morin në drejtim të Kukësit nga data 14 maj deri më 21 maj 1999 e që janë siç thamë 60 veta, prej të cilëve katër më 21 maj. Në ditët në vazhdim: më 22 maj, 500 veta, më 23 maj, 685 veta, më 24 maj, 456 veta, më 25 maj, 84 veta, më 26 maj, 220 veta, më 27 maj, 500 veta, më 28 maj, 570 veta, më 29 maj, 300 veta, më 30 maj, 400 veta dhe më 31 maj, 400 veta. Pjesa dërmuese e tyre të liruar nga burgjet serbe. Edhe në ditët pas 21 majit nuk na dalin mijërat e kosovarëve që e kalonin kufirin çdo ditë sipas Juriseviçit. Dhe pasi "*lodhet*" gjithë ditën me "*mijërat*" e refugjatëve të tij, tashmë është ora 21.00 kur mbyllet kufiri për sot dhe Juriseviçi kthehet në Kukës. E përshkuan si qytet të "*vdekur*" natën duke e përshkruar *"Në Kukës, asgjë nuk lëviz pas territ. Pos dilerëve të drogës nëpër trotuare tregtia tjetër në qytet vdes*". O zot, Juriseviçi "*fshin*" nga Kukësi 200-300 mijë qytetarët shqiptarë (vendas dhe të huaj) që banojnë brenda tij. Njerëzit që lëvizin e që zhurmojnë ditën e natën. "*Fshin*" automjetet e shumta të policisë, të ushtrisë e të qytetarëve që lëvizin vazhdimisht (jo vetëm ditën). "*Fshin*" autoambulancat e shumta të spitaleve dhe shoqatave të shumta që "*funksiononi*n" në Kukës në atë kohë. Por nejse, kushdo është i lirë ta besojë "*qetësinë*" e Juriseviçit. *"Vetëm 'Bar*

Amerika' është hapur", - thotë Juriseviçi, sepse njerëzit kanë nevojë për birrë, uiski, apo ndonjë pije tjetër speciale pas një dite si kjo. Të gjithë tashmë e dimë "*ditën e sotme*" të Juriseviçit, ditë imagjinare, ditë ireale, ditë haluçinante. Sapo futet në "*Bar Amerika*" e gjen Andersonin (gazetarin), i cili sapo e sheh nga larg Juriseviçin, e kupton se ishte i gatshëm t'ia zbulonte ato që deri më tash s'ia kishte thënë. Madje thotë Juriseviçi *"s'u lodha të porosis as birrën se më erdhi në tavolinë, kur isha duke folur me Andersonin*". Filluan menjëherë punën. Gazetari shkroi në krye të faqes së zbrazur të fletores së tij, datën 22 maj 1999, ndërsa Juriseviçi filloi rrëfimin. Gazetari e dëgjon me vëmendje shënon çdo gjë e shikon shumë pak sepse nuk do që të ndalet apo të hutohet, nuk do që *"t'i dorëzohet birrës e të trulloset*". Pasi Juriseviçi e mbaron rrëfimin, gazetari i përsërit disa nga "*dëshmitë*" e tij: *"shumë banditë në spitalin këndej, mjekët dhe infermierët shqiptarë nuk do të bëjnë asgjë për refugjatët nëse nuk marrin para. Nuk ka lidhje çfarë lëndimi: s'ka para s'ka operacion, s'ka barna, s'ka asgjë*". Në bisedë me njëri-tjetrin dalin të "*dhëna*" apo "statistika" nëse janë të gjithë mjekët e spitalit të tillë, janë gjysma, janë pak apo janë shumë! "*Lodhen*" shumë deri sa arrijnë në përfundimin se 50% e personelit në spital kërkon para e 50% e personelit nuk kërkon para. Madje Juriseviçi jep dhe një shembull për një mjek shqiptar (pa emër, pa mbiemër) "*i cili ka rrezikuar jetën për t'i trajtuar refugjatët pa u kërkuar asnjë cent*".

Nuk e kuptojmë as sot se pse u "lodhën" për të arritur tek këto shifra 50% me 50%, kur në faqen 80 të paçavures (botim shqip) në rreshtin e dytë dhe tretë të asaj faqe, dr. Vata e kishte informuar mjaft saktë Juriseviçin për ato që marrin para, bile ia ka dhënë edhe emrat e atyre që marrin para. Nejse, t'i bësh llogaritë dy herë nuk të bën keq. Biseda vazhdon për Cenën si menaxhues i reketit, sepse *"Cena është i lidhur me mafian, mafias i paguan hisen (pjesën) e vet.*

Përsëri del dr. Vata kur asgjë e mbrapshtë nuk ndodh në Kukës, që mafia të mos marrë hisen e vet", - shkruan Juriseviçi dhe duket sikur e firmos dhe e vulos kur më tej shkruan të zezë mbi të bardhë se *"Këtë na e thotë miku im - mjeku shqiptar*".

Mirëpo gazetari duket qartë se e ka një parim bazë të profesionit, e ka një standard në punën e tij (që nuk mund t'i shkelë), mbasi ai do që informacionin që merr dhe që do t'i duhet ta shkruaj, nuk i vlen vetëm me fjalë por ai kërkon fakte sepse vetëm ato janë bindëse. Fjalët s'janë asgjë. Faktet që i kërkon gazetari amerikan janë fotografitë ose filmimet në rastet kur mjekët marrin paratë nga refugjatët e sëmurë. Ç'është e vërteta tani i vjen radha zanatit të vërtetë të Juriseviçit si kurthaxhi, si provokator e si spiun duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e misionit të tij djallëzor. Ai, jo vetëm ideon e planifikon kurthe e provokime të ndyra, por edhe vepron konkretisht. Mënyrën spiunçe e provokuese e zotëron plotësisht duke i futur në spital gazetarin dhe një reporter të tij jo si gazetarë, por si…mjekë me bluza të bardha dhe me stetoskop në qafë. Megjithëse e ka frikën e Cenës se mund t'i vrasë po i zbuloi, përsëri ishte i sigurt sepse zanati i tij i vërtetë është ky me të cilin po merrej me 23 maj 1999: po përgatiste kurthin, po improvizonte skenën ku personeli do të merrte para nga refugjatët dhe gazetarët (me bluza të bardha e stetoskopë) do t'i fotografonin e filmonin.

Për hir të së vërtetës Juriseviçi nuk e kishte të vështirë sepse u angazhua me profesionin e tij themelor, me profesionin e tij të vërtetë i cili me sa duket është ai i spiunit të kualifikuar. Mbasi "*zgjidh*" paraprakisht çdo detaj të luftës konspirative, Juriseviçi është gati për ditën e nesërme. Në paçavure lexojmë: *"Kështu, të nesërmen vishet si mjek dhe i rrekemi punës. Hyjmë në spital me vrull, thuajse nuk kemi as kohë të merremi me zhvatje, por Andersoni dhe fotografi i tij*

i shohin të gjitha ato që duhet t'i shohin. Cena dhe tipat e tij tregohen aq të pafytyrë e të fëlliqur sa që e gjithë zhvatja do të mund të dukej komike po të mos ishte tragjike".

Gjithçka funksionoi, fotografitë u bënë, grabitësit mafiozë të spitalit u zbuluan dhe artikulli i Andersonit *"Kurthi vdekjeprurës për refugjatët*" për të nesërmen ishte gati për botim në gazetën *"The Stars and Stripes*". Andersoni e dërgoi artikullin tek ekipi i Wesli Klarkut (!) në selinë e NATO-s duke *"përshkruar me kujdes ato që kishte parë apo me citoi mua si dëshmitar të gjërave që nuk i kishte parë*", - shkruan Juriseviçi dhe vijon se *"Të nesërmen, me 24 maj 1999 komandanti i NATO-s Wesli Klark e miratoi artikullin dhe gazeta e botoi në faqen e parë të saj*".

Ne nuk e kuptojmë se pse artikullin e një gazetari të një gazete (cilado qoftë ajo) duhet ta miratonte vetë komandanti i forcave te NATO-s! (pastaj kuptohet se sa kohë kishte komandanti i Aleancës së Atlantikut!). Kjo jo vetëm që është absurde, por edhe një akt paradoksal! Sikur komandantit të NATO-s nuk i paska mbetur punë tjetër por edhe të luaj rolin e redaktorit të artikujve të gazetave. Kjo është më shumë se për të qeshur. S'kishte si të mos e miratonte Klarku atë artikull, kur "*faktet*" e Juriseviçit dhe informacionet e dr. Vatës përbënin boshtin kryesor të artikullit! A nuk duket se edhe vetë komandanti i NATO-s gjenerali Wesli Klark e pati të vështirë ta "*censuronte*" Juriseviçin!

Në artikull shkruhej se *"në spitalin e vjetër të Kukësit, njerëzit po vdesin jo për mungesë të mjekëve apo barnave. Po vdesin, ngase zyrtarët vendas po zhvatin krejt paratë që kanë refugjatët të cilët po vijnë në numër të madh në Kukës, duke i lënë të gjithë ata që nuk kanë të paguajnë*", - thonë mjekët e huaj (e ka fjalën për "*mjekun*" Juriseviç).

Por të dhënat e Juriseviçit për artikullin nuk përputhen me realitetin, sepse spitali i Kukësit nuk është aq i

vjetër (aq sa të cilësohet i tillë) sepse është vetëm 25 vjeçar). As nuk është aq i pamundur t'i përgjigjet numrit apo fluksit të madh të refugjatëve ngase vetë artikulli e thotë *"jo për mungesë të mjekëve apo barnave*" duke nënkuptuar qartë një gatishmëri të mjaftueshme njerëzore e profesionale të mjekëve si dhe barnat e duhura dhe të mjaftueshme që janë pa asnjë mëdyshje faktorët me themelore në realizimin e shërbimit shëndetësor optimal në një qendër shërbimi spitalor në çdo vend të botës.

Edhe pretendimi i *"Juriseviç artikullit*" se autoritetet lokale *"nuk lejojnë që ato të cilët nuk mund të paguajnë, të vendosen në spitalet e kampeve të refugjatëve*" nuk qëndron aspak. Nuk qëndron se sipas logjikës së Juriseviçit ato që nuk kanë të paguajnë nuk i pranojnë apo i nxjerrin nga spitali i Kukësit duke i lënë të "*lirë*" të shkonin ku të mundnin. Askush nuk beson se spitali është burg që pacientët të shkonin e të trajtoheshin kudo veç aty ku u kërkonin para jo! Dhe e dini pse? Sepse, po sipas bindjes së Juriseviçit, mjekët shqiptarë s'kanë pse të merren fare me ato që s'kanë të paguajnë. Ata po merren vetëm me ato që kanë të paguajnë!

Harron shumë shpejt, se sipas "*vlerësimit*" të përbashkët të Juriseviçit dhe Andersonit ishte "*vendosur*" shifra e barabartë 50% me 50% të atyre mjekëve që kërkojnë para dhe të atyre që nuk kërkojnë para, duke dhënë një "*alternativë*" shumë shpresëdhënëse në favor të atyre që s'kanë të paguajnë, sepse barazohet ndihma mjekësore me pagesë me ndihmën mjekësore falas: 50% me 50%! Vetë *"Juriseviç-artikulli*" u jep hapësirë dhe mundësi trajtimi (bile njëlloj, apo 50% me 50% dhe atyre që nuk kanë para), duke ndihmuar të sëmurët të mos vdesin siç dhe në fakt nuk kanë vdekur, por jo se Juriseviçi nuk i ka dashur të vdekur!

Ne që kemi jetuar e punuar në spitalin e Kukësit në atë kohë, e kemi njohur realitetin ndryshe si e "*njeh*" Juriseviçi dhe jemi të bindur se mjekët, infermierët,

punonjësit e tjerë si dhe stafi drejtues i spitalit i kanë kryer detyrat me përkushtim njerëzor dhe me atë aftësi profesionale të admirueshme dhe kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme duke përballuar një situatë absolutisht të paimagjinueshme. Është një privilegj i rrallë të deklarojmë se në spitalin e Kukësit nuk ka vdekur asnjë fëmijë i shtruar. Ky është rezultat i artë për çdo spital të botës. Bëjmë me dije bazuar në fakte se në Spitalin e Kukësit për periudhën 27 mars 12 qershor 1999 nuk ka vdekur asnjë fëmijë as i ardhur nga Kosova e as vendas. Por kjo nuk e pengon Juriseviçin ta "*vdesë*" fëmijën 18 muajshe nga Kosova (pa emër, pa mbiemër, pa iniciale...) *"sepse mjekët lokalë refuzuan t'i jepnin antibiotikë dhe oksigjen*"!

A ka krim më të rëndë e dëshirë më ç'njerëzore, mision më djallëzor e synim më makabër që një fëmijë të gjallë e të shëndetshëm ta "*vdesësh*" vetëm pse do autori me qëllim që libri t'i bëhet interesant dhe i konsumueshëm.

XX - Fakte dokumentare

Sa për informacion të lexuesve mendojmë të japim të dhënat e sakta mbi vdekjet që kanë ndodhur në pavijonin e kirurgjisë dhe të reanimacionit bazuar në dokumente të pakundërshtueshëm (kartelë e regjistra) dhe sipas dëshmive të punonjësve që kanë shërbyer në atë kohë në sallë të operacionit, në pavijonin e kirurgjisë dhe të reanimacionit, për periudhën 27 mars deri më 30 qershor 1999:

Kanë ndodhur shtatë vdekje (prej 493 të sëmurëve të trajtuar) dhe me konkretisht sipas muajve janë:

A - Muaji Prill ka pasur tre vdekje e konkretisht:

1. Sali R.B. vjeç 63, me nr. kartelë 1418, i shtruar më 8 prill 1999 dhe vdekur po më 8 prill 1999. Në spital si i shtruar jetoi vetëm 10 orë e 55 minuta. U shtrua dhe vdiq me diagnozën peritonitis generalizata (shqip qelbëzim i

hapësirës së barkut me gjithë organet). Gjendje shumë e rëndë toksiko-septike, shok hipovalemik, pamjaftueshmëri e rëndë e veshkave. Ishte nga fshati Gorozhup i Kosovës.

2. Myzafer R.S., vjeç 21, me nr. kartele 1813, i shtruar më 28 prill 1999 dhe vdekur po më 28 prill 1999, i cili ka jetuar 29 orë. U shtrua dhe vdiq me diagnozën PAZ (plagë me armë zjarri) tejshpuese në gjoks, hemopneumotoraks në dy anët, shok hemorragjik akut. Ishte nga fshati Shikaj i rrethit të Kukësit dhe nuk kishte lidhje me luftën në Kosovë.

3. Elisabeta F.C., vjeç 2, me nr. kartele 1908, i shtruar më 30 prill 1999 dhe vdekur po më 30 prill 1999, i cili jetoi vetëm 7 orë e 20 minuta me diagnozë combustio (djegie) 65%-70% të sipërfaqes trupore të gradës I, II e të III. Ishte nga fshati Nikoliq i rrethit të Hasit.

B - Muaji maj të vitit 1999 ka patur një vdekje.

1. Haki M.K., vjeç 56, me nr. kartele 2184, i shtruar më 18 maj 1999 e vdekur po më 18 maj 1999, i cili jetoi vetëm 7 orë, me diagnozë peritonitis generalisata (qelbëzim të përhapur në gjithë hapësirat e barkut) me gangrenë të zorrëve të holla e të trasha, me gangrenë të fshikëzës së urinës me gangrenë retroperitonale, gjendje toksiko-septike shumë e thellë. Ishte shqiptar i Kosovës.

C - Muaji qershor 1999 ka patur tri vdekje.

1. Enfal H.J., vjeç 22, me nr. kartele 2812, i shtruar më 18 qershor 1999 dhe vdekur po më 18 qershor 1999, i cili jetoi vetëm 5 orë e 15 minuta me diagnozë PAZ (plagë me armë zjarri plasëse, mina) me prerje të dy këmbëve në 1/3 e mesme të kërcirit, shok hemorragjik i gradës IV. Ishte nga fshati Orgjost-Kukës.

2. Sejfulla H.J., vjeç 71, me nr. kartele 2605 i shtruar në reanimacion më 8 qershor 1999 dhe ka vdekur më 13 qershor 1999. Duhet të vemë në dukje se ky pacient ka qenë i shtruar në pavijonin e kirurgjisë nga data 22 maj 1999 deri

më 8 qershor 1999 kur u transferua në gjendje të rëndë në reanimacion ku dhe vdiq. Në pavijonin e kirurgjisë i është nënshtruar operacionit të amputimit të këmbës së majtë në 1/3 e sipërme të kërcirit dhe operacionin e ka kryer dr. Vata. I sëmuri vuante nga sëmundja e quajtur endoartitis obliterans me gangrenë të këmbës, me gjendje toksio-septike të rëndë dhe pamjaftueshmëri zemër mushkëri. Ishte nga Studençani i Kosovës.

3. Fatbardh R.T., vjeç 3, me nr. kartele 2920, i shtruar me 25 qershor1999, i cili jetoi 5 orë e 30 minuta me diagnoze Combustio (djegia) e lëkurës së gjithë shpinës, dy këmbëve dhe dy krahëve (pothuajse gjithë gjymtyrët), të gradës II e të III. Ishte nga katundi Shëmri i Kukësit.

Shumica e këtyre vdekjeve kanë ndodhur kur Juriseviçi ose nuk ka ardhur akoma në Kukës ose kur ai është larguar nga Kukësi madje edhe nga Shqipëria. Sepse p.sh., dy vdekjet e muajit prill kanë ndodhur me 8 prill 1999 (20 ditë para ardhjes së Juriseviçit në Kukës) dhe 28 prill 1999 në orën 05.00 kur helikopteri që po sillte Juriseviçin në Kukës ndoshta akoma nuk ishte nisur. Vetëm vdekja e datës 30 prill 1999 mund të themi se e ka "*pikëlluar*" Juriseviçin Megjithëse ai atë ditë është kthyer në Kukës nga Morini mbas orës 21.00 dhe të gjithë e dinë se ka pyetur vetëm për vdekjen dhe varrimin e Lules. Ndërsa për vogëlushen tri vjeçare as që mund ta dinte se ka vdekur. Mjafton të kujtojmë se fëmija u shtrua në orën 10.00 dhe vdiq në orën 17.20, kur Juriseviçi po bënte "*heroin*" në Morin.

Edhe të gjitha vdekjet e muajit qershor (tri vdekjet) kanë ndodhur më datat 8, 13 dhe 25 qershor 1999 kur Juriseviçi nuk dihej se ku merrte frymë, me siguri jo në Kukës, tashmë ishte larguar.

Nëpërmjet këtyre të dhënave të dokumentuara duam të bëjmë me dije se Juriseviçi nuk shkruan asgjë të saktë dhe të asgjë të vërtetë në rastin kur i rrëfen gazetarit Anderson

për një kosovar 60 vjeçar të vdekur, për një foshnje kosovare 18 muajshe të vdekur dhe për një 25 vjeçar kosovar të vdekur. Realiteti kokëfortë dëshmon se asnjë nga ato të "*vdekur*" të Juriseviçit nuk janë realë. Nuk kanë ndodhur asnjëherë dhe nuk konfirmohen as nga dokumentacioni klinik e as nga punonjësit e shërbimit të asaj kohe. Prandaj, si gjithnjë Juriseviçi nuk shkruan as emër, as mbiemër, as iniciale duke i lënë anonimë qëllimisht, kriminalisht, sepse ashtu e kanë urdhëruar. Pra misioni ia do kështu.

Kushdo është i lirë të vlerësojë e të besojë me ndërgjegjen e tij rrëfimin e djallit Juriseviç, i cili për misionin ka pasur vdekjen e shqiptarëve. E për më tepër, ai ka misionin e zi jo vetëm për t'i paraqitur shqiptarët si kriminelë, banditë e më të këqinj... Por nëpërmjet aktivitetit dhe funksionit të tij edhe për të "*lehtësuar*" serbët kriminelë në krimet e tyre. Jemi të detyruar ta themi edhe njëherë, ta përsërisim sa herë ta lypë nevoja se është fakt i pa kundërshtueshëm që Juriseviçi nuk ka punuar në spitalin e Kukësit e as në sallën e operacionit të këtij institucioni shëndetësor. Asnjë ditë tjetër përveçse më 4 maj 1999 kur asistoi dr. Vatën në operacionin e "*famshëm*" që e kemi përmendur më parë. Por është i çuditshëm fakti që Juriseviçi duke mos qënë realisht prezent në spital është i informuar hollësisht për çdo gjë që ndodh aty. Madje është i informuar "*virtualisht*" ashtu siç e dëshiron e siç e planifikon vetë çdo ngjarje sipas dëshirës së tij. Më saktë siç ja kërkon misioni i tij i mistershëm. Më revoltuese dhe që të bën të vjellësh nga hundët është fakti tjetër se çdo informacion Juriseviçi e merr nga kolegët e tij shqiptarë të spitalit të Kukësit (!) të cilët nuk e dinë ku e marrin guximin dhe ku e gjejnë mbështetjen që të spiunojnë (s'mund t'i vëmë dot emër tjetër) për "*ngjarje*" dhe "*fakte*" që asnjëherë nuk janë parë e dëgjuar dhe nuk kanë ndodhur kurrë. Këtij fenomeni nuk mund t'i vëmë emër

tjetër, por spiunim me fantazi apo me saktë spiunim me porosi.

Ja një "fakt" i Juriseviçit kur shkruan për spitalin e Kukësit në faqen 110 të paçavures së tij shkruan *"spitali i Kukësit në ndërtesën e ndyrë dy katëshe me 240 shtretër në Kukës, me mure gipsi që bien për tokë, tashmë është përplot me pacientë, të cilëve u ofrohet pak kujdes nga personeli. Ato që nuk kanë familjarë të kujdesen për ta janë të shtrirë mbi shurrën dhe jashtëqitjen e tyre me ditë e madje me javë. Infermieret thonë se nuk është punë e tyre t'i pastrojnë. Zakonisht nuk ka ujë. Një lopë kishte qenë duke u kalbur para spitalit dy ditë me radhë para se të copëtohej nga refugjatët të cilët ia lanë vetëm katër kthetrat*".

Foto e spitalit të Kukësit

Duke mos dashur të zgjatemi, po paraqesim fotografinë e spitalit të Kukësit në mesin e muajit shtator të vitit 1999 dy muaj pas rikthimit të shqiptarëve të Kosovës nga Kukësi për t'i thënë Juriseviçit se spitali i Kukësit nuk është ndërtesë dy katëshe, por tre katëshe, shtuar dhe një kat nën tokë ku janë vendosur guzhina, magazinat ushqimore, arkivi i spitalit, lavanteria dhe morgu. Vetëm djalli beson në

veten e tij se mund të "*hajë*" kate të ndërtesave. Edhe përshkrimi i tij keqdashës bie poshtë menjëherë sepse nuk përputhet me realitetin që shihet në foton e spitalit në atë kohë. Por të gjithë punonjësit në këtë institucion shëndetësor e hedhin poshtë me përbuzje atë që shkruan Juriseviçi dhe e quajnë atë një të sëmurë mendor.

Sa i përket pretendimit të Juriseviçit për njerëzit e vetmuar e pa të afërm deklarojmë me përgjegjësi njerëzore se administrata e spitalit me ndihmën e shoqatave të ndryshme të vendosura në Kukës e të pushtetit vendor vuri në dispozicion të tyre një pavijon të ri të veçantë (vetëm për të moshuarit e vetmuar) Me pajisje të reja hotelerie me kapacitet 60 shtretër. Ky pavijoni u hap në katin e katërt të godinës së infektivit dhe nga fondet e qeverisë shqiptare u punësuan punonjës shtesë. Pavijoni u vu nën mbikqyrjen e dr. Azem Brashës, një mjek patolog me eksperiencë dhjetëra vjeçare në punë, që kujdesej për ata njerëz të vetmuar jo vetëm nga ana njerëzore, por sigurisht edhe nga ana shëndetësore.

Edhe përshkrimi i lopës me "*kthetra*", apo më saktë i *"lopës Juriseviç*" nuk mendojmë se ia mbushë mendjen ndokujt. Sepse lopa me kthetra në Kukës nuk ka patur, nuk ka e as nuk do të ketë. Ka patur, ka dhe do të ketë lopë me thundra si kudo në botë, por jo mostra lemeritëse antishkencore siç është në fakt edhe vetë autori i këtij libri.

Në faqen 110 të paçavurës ai bën një shënim interesant kur shkruan se *"po të ishin në SHBA, njerëzit do të dënoheshin për vrasje të shkallës së dytë një herë në javë*" duke u vetëdeklaruar si një njohës mjaft i mirë i ligjeve amerikane më mirë se ato në vendin e tij në Australi. E megjithëse dëshiron t'i dënojë shqiptarët, nuk e dimë se pse nuk e shfrytëzon njohjen e ligjit, kundër shqiptarëve, sipas procedurave dhe të ligjeve të njohura, me anën e denoncimit

apo të akuzës në organet e drejtësisë kudo në botë kur ke fakte dhe dëshmi për krime.

Duke e konsideruar të suksesshme *"luftën e tij*" Juriseviçi citon i kënaqur një zyrtar të NATO-s që në takimin e mëngjesit paska thënë se disa modalitete të reja do të zbatohen në raport me trajtimin mjekësor të refugjatëve që kalojnë kufirin nga Kosova për Shqipëri.

"*Tash e mbas*, - paska thënë njeriu i NATO-s, - *të gjithë refugjatët që kanë nevojë për ndihmë mjekësore, përfshirë operacionet do të drejtohen drejt spitaleve të Kampit 'Italia 1' dhe të njësisë kirurgjikale të EBA*". Kështu, dy ditë pas botimit të artikullit në Gazetën *"The Stars and Stripes*", për skemën e Cenës, ajo po shpartallohet dhe i kënaqur Juriseviçi i uron të gjithë të përfshirët në "*luftë*" por duke harruar se kjo "*luftë*" e tij realisht bëri një *"vrimë në ujë*" sepse që nga data 26 maj 1999 (bile ne e kemi vërtetuar me shifra edhe para kësaj date), fluksi i të ardhurve nga Kosova kishte rënë aq shumë, saqë tashmë kishte filluar të flitej shumë pak ose aspak për të ardhurit nga Kosova.

XXI - Realitetin s'e luan as topi

Më poshtë do të paraqes një studim kliniko-statiskor që e kam krye në mars 2008 (plot tri vjet më parë se të botohej libri i Juriseviçit). Në këtë studim thuhet se si pasojë e eksodit të dhunshëm të vitit 1999 në repartin e pediatrisë të spitalit Kukës nga 27 marsi 1999 deri në 12 qershor 1999 janë strehuar 221 fëmijë të moshës 0-14 vjeç. Nga të dhënat rezulton se 101 fëmijë ose 46.1% janë shtuar në muajin prill, 74 fëmijë ose 33.2% në muajin maj dhe 46 fëmijë ose 20.7% në muajin qershor. Këto të dhëna përputhen me numrin më të madh të të zhvendosurve në fund të muajit mars e sidomos gjatë majit prill të atij viti të zi.

Moti i keq (i ftohtë dhe me reshje shiu) përpos shumë të tjerave ka qenë faktor negativ që ka ndikuar në rritjen e numrit të shtrimeve siç ka ndikuar dhe rrugëtimi tejet i vështirë dhe rraskapitës për në Kukës (që në shumicën e rasteve ka vazhduar disa ditë). Qëndrimi në qiell të hapur, në kushte atmosferike të rënda në ditët e para të të ardhurve për arsye se numri i tyre ishte shumë i madh (30-40 mijë persona në 24 orë kanë hyrë në Kukës dhe rrethinat e tij në ditët e para) jashtë çdo mundësie reale për tu akomoduar në një qytet të vogël si Kukësi me popullsi rreth 20 mijë banorë dhe në rrethinat e tij kur dhe ndihmat për strehim dhe ushqime ishin në fazën fillestare. Të gjithë këto krijuan gjendjen e vështirë shëndetësore të fëmijëve të ardhur nga Kosova.

Ndërsa po analizohet mosha e fëmijëve të shtruar del se vetëm 3 fëmijë ose 1.3% janë të moshës 0-1 muajsh, 9 fëmijë ose 4% të moshës 1-3 muajsh, 37 fëmijë të shtruar ose 16.7% të moshës 3-6 muajsh, 78 fëmijë ose 35.2% të moshës 6-12 muajsh, 72 fëmijë ose 32.5% të moshës 1-4 vjeç dhe 25 fëmijë ose 11.3% të moshës + 4-14 vjeç. Shihet qartë se numri më i madh i shtrimeve është i moshës 6-12 muajsh (78 ose 35.2%) dhe të moshës 1-4 vjeç (72 ose 32.5%), pasi janë moshat më të vështira për kujdesie, trajtimin e ushqyerje jo vetëm për veçoritë e moshës por edhe për kushtet ku u gjendën, ku mungonin krejtësisht elementët më minimale jetësore.

Sipas diagnozës (sëmundjes) kryesore në momentin e shtrimit në spital rezulton se 119 fëmijë ose 53.6% janë shtruar me sëmundje të organeve të frymëmarrjes, 59 fëmijë ose 26.7% me sëmundje të organeve të thithjes dhe tretjes, 19 fëmijë ose 9% me sëmundje të organeve të frymëmarrjes dhe të tretjes njëkohësisht dhe 24 fëmijë ose 10.7% me sëmundje të tjera të ndryshme. Është me interes të theksojmë se në grupin “sëmundje të tjera të ndryshme” në disa raste janë konstatuar dëmtime të ndryshme traumatike të

shkaktuar prej keqtrajtimit të forcave policore ushtarake dhe paraushtarake serbe, të kolonave të shqiptarëve gjatë rrugës për në Kukës brenda territorit të Kosovës.

I tillë ishte rasti i fëmijës Besart Avni Hoti i moshës dy vjeç nga fshati Krushë e Madhe i shtuar në spital me 27 prill 1999 (me kartelë nr. 1825). Në momentin e shtrimit në spital fëmija kishte të vjella të shpeshta që i kishin filluar rrugës për në Kukës në afërsi të fshatit Shkozë të Komunës së Prizrenit. Qante vazhdimisht, ishte shumë i grindur e më vonë filloi përgjumja. Pasi u shtrua dhe iu bë vizita dhe radiografia e kokës (në dy drejtime para-mbrapa dhe anash), fëmija rezultoi me thyerje (çarje) të kockës së kokës në anën e djathtë të saj, më saktë fraktura parieto-oksipitale deksha. Nëna e fëmijës më vonë na tha se gjatë udhëtimit për Shqipëri rrugës për Prizren tek ura e trenit (afër Ladovicës) kolona e njerëzve u ndalua nga policia dhe ushtria serbe. Aty u grabitën dhe u keqtrajtuan njerëzit e kolonës pa asnjë dallim (burra gra, pleq e fëmijë). Meqenëse nëna e kishte shtrënguar fort Besartin në gjoksin e saj, dy paraushtarakë ia tërheqin me forcë dhe fëmija ra në anë të rrugës përtokë. Pastaj me egërsi dhe shpejtësi shtazarake i morën nënës së Besartit çdo gjë të vlefshme që pati në trup. I morën vathët duke i shqyer veshët, varësen dhe zinxhirin e floririt në qafë, byzylykun në dorën e majtë dhe unazat e gishtave. Nëna na tha se Besarti i vogël që nga momenti kur ra në tokë vetëm qante, nuk kishte futur asgjë në gojë, ndërsa afër fshatit Shkozë siç thamë më parë i kishin filluar të vjellët që nuk iu ndaluan derisa u shtrua në spital.

Po të analizohen ditëqëndrimet në spital del se deri në 3 ditë në spital kanë qëndruar 76 fëmijë ose 34.3%, deri në 5 ditë kanë qëndruar 62 fëmijë ose 28.6%, deri në 10 ditë kanë qëndruar 24 fëmijë ose 10.4% e numrit të fëmijëve të shtruar në spital. Arsyjet e ditëqëndrimit të ulët në spital janë të ndryshme, por mbi të gjitha ka ndikuar dinamika e

jashtëzakonshme e njerëzve të ardhur në Kukës, numri shumë i madh i tyre i stacionuar në Kukës si dhe kapaciteti absolutisht i pamjaftueshëm i pavijonit të pediatrisë të cilët i erdhën në ndihmë spitalet fushore që u ngritën më vonë në disa nga Kampet e strehimit për të ardhurit nga Kosova. Pas muajit të parë (prill 1999) spitali i Kukësit filloi të lehtësohej pak mbingarkesa ekstreme duke bërë që numri i shtrimeve të jetë relativisht më i vogël. Ndërsa po të analizohen kushtet e jetës së fëmijëve para shtrimit në spital rezulton se nga 221 fëmijë të shtruar 36 prej tyre ose 16.3% kanë jetuar në qiell të hapur, pa kulm mbi krye. Njëzet fëmijë ose 9.1% janë sëmurë rrugës duke ardhur për në Kukës (shumica në këmbë), 34 fëmijë ose 15.3% kanë qenë të "*strehuar*" në automjete të ndryshme (makina, traktorë, rimorkio etj), 59 fëmijë ose 26.7% ishin strehuar në çadrat e kampeve të strehimit që u ngritën në Kukës dhe në rrethinat e tij dhe 72 fëmijë ose 32.6% ishin të strehuar në shtëpitë e qytetarëve të Kukësit dhe të fshatrave përreth tij.

Të dhënat për gjendjen shëndetësore të sëmundjeve në momentin e shtrimit në spital tregojnë se 153 fëmijë ose 69.2% janë shtuar në gjendje të mesme shëndetësore, 51 fëmijë ose 22.6% janë shtruar në gjendje të rëndë shëndetësore dhe 17 fëmijë ose 7.6% janë shtruar në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Jeta e tyre ishte seriozisht në rrezik. I tillë ishte rasti i fëmijës Riad Rruzhdi Paçarizi, tri muajsh nga fshati Dragobil i Komunës së Malishevës, i cili u sëmurë rrugës për në Kukës dhe u shtrua në pavijonin e pediatrisë me 21 prill 1999 rreth orës një të natës. Gjendja e vogëlushit shqiptar ishte tepër e rëndë, jeta e tij ishte në rrezik tejet serioz, por me ndihmën adekuate mjekësore, ai luftoi disa ditë me vdekjen, e mundi atë dhe doli nga spitali në gjendje të mirë shëndetësore.

Po të shohim gjeografinë e fëmijëve të shtruar në spital, rezulton se Komuna e Prizrenit zë vendin e parë me

78 fëmijë të shtruar ose 35%, pastaj Komuna Therandës me 41 fëmijë ose 18.5%, Komuna e Sharrit me 23 fëmijë ose 10%, me deklarim vendbanimi Kosovë 17 fëmijë ose 7.6%, Komuna e Gjakovës 8 fëmijë ose 3.6%, Komuna e Rahovecit 7 fëmijë ose 3.1%, Komuna e Skënderajt 5 fëmijë ose 2.2%, Komuna e Lipjanit me 5 fëmijë ose 2.2%. Komuna e Mitrovicës me 4 fëmijë ose 1.8%, ndërsa me nga një fëmijë Komunat Pejë, Vushtrri, Klinë e Shtime. Tejet domethënëse që të bën të ndjehesh shumë krenar është fakti kuptimplotë që emrat e fëmijëve të shtruar, emrat e fëmijëve të tjerë që vizituan në ambulancat e ndryshme apo në urgjencën e spitalit si dhe të shumicës së fëmijëve të tjerë që njohëm atë periudhë, janë emra me simbolet tona kombëtare, emra me prejardhje nga jeta dhe për dhe për jetën, emrat nga trojet dhe hapësirat shqiptare dhe më pak emra të "*vjetër*".

Sipas grupimeve që përmendëm po i renditim tre grupet kryesore të emrave që takuam më shpesh:

Grupi i parë me emra nga simbolet tona kombëtare: Atdhe, Flamur, Atdhetar/e, Ilir, Ilirjan/a, Dardan/a, Skënder, Kastriot, Shqipe, Alban/a, Shqiponja…etj. Grupi i dytë me emra që simbolizojnë jetën: Jetlind/a, Jetgjat/a, Donjet/a, Jetlir/a, Liridon/a, Qëndrim, Qëndresa, Çlirim, Lirim, Festim…etj. Grupi i tretë me emra qytetesh e trojesh etnike shqiptare: Berat, Drenica, Dukagjin, Vlora, Korab, Shkodran, Kaçanik, Saranda, Dibran, Erenik, Shkumbin, Rozafa, Lumjana etj.

Hasëm edhe emra të tjerë, të vjetër që thonë se i kanë vënë për të kujtuar apo përtërirë gjyshin, gjyshen, babën, nënën apo edhe atdhetarë të shquar me të njëjtin emër, por relativisht këto emra takohen rrallë. Fatmirësisht në pavijonin e pediatrisë të spitalit të Kukës gjatë periudhës së marrë në studim nuk kemi pasur asnjë vdekje. Me një fjalë, nga 221 fëmijët e shtuar në pediatri dolën nga spitali të shëruar plotësisht. Ky fakt në radhë të parë është tregues i

relativitetit të kombit shqiptar por edhe i organizimit në nivelin më të lartë të mundshëm të shërbimit shëndetësor, të trajtimit shkencor bashkëkohor të fëmijëve të sëmurë dhe përkushtimit maksimal të mjekëve, të infermiereve dhe gjithë punonjësve e stafit drejtues të spitalit të Kukësit për t'u përgjigjur me dinjitet edhe në situatë të jashtëzakonshme pothuajse të paimagjinueshme për kohën që po jetojmë. Po pse jetoi dhe jeton Riad Paçarizi nga fshati Dragobil i Malishevës? Mos vallë një fëmijë tri muajsh (shqiptar) ishte më i fortë se një diktator? Më i fortë se "*kasapi i Ballkanit*" (serb)? Përgjigja tashmë është e qartë, konkrete dhe reale: Riad Paçarizi, shqiptari tri muajsh doli më i fortë. Jeta ishte dhe është me Riad Paçarizin sepse ai është shqiptar dhe e do jetën. Dashuria mes shqiptarit dhe jetës është e pafundme. Nuk shuhet kurrë. Prandaj kombi shqiptar është kaq vital, kombi shqiptar është me Zotin dhe i zbaton porositë e Tij. E do jetën, është kombi më i ri i Evropës, nuk plaket asnjëherë. Kurse "*kasapi i Ballkanit*" është serb, kombi i të cilit historikisht është i lidhur jo me jetën por me vdekjen. Serbët që kurrë nuk janë vendosur në hapësirat ku jetojnë sot, kanë sjellë me vete vdekjen për të tjerët. Sepse i kanë vrarë, i kanë djegur, i kanë dëbuar nga trojet e tyre etnike shqiptarët duke u shkaktuar dhimbje, lot dhe gjak. Por edhe serbët, vdekja nuk i ka kursyer. Fakti që ata lindin pak fëmijë duke e konsideruar veten gjoja si "*komb me kulturë*" flet qartë se ata duan më shumë vdekjen se jetën dhe sot janë nga kombet më të plakur të Evropës. Edhe Zoti nuk i ndihmon kombet që duan më shumë vdekjen se jetën. Plakja e sotme me siguri në një të ardhme jo të largët do të çojë në pakësim të pandalshëm të numrit të serbëve. Kështu, mendojmë ne se ka ndodhur realisht që Riad Paçarizi, fëmija shqiptar tri muajsh (në vitin 1999) jeton i shëndetshëm dhe sot është 13 vjeç (viti 2012). Ndërsa "*Kasapi i Ballkanit*" diktatori i fortë

Sllobodan Millosheviç është harruar se kur ka vdekur. Po mbolle vdekjen, korr vdekjen! Po mbolle jetën korr jetën.

XXII – Çakallit i dalin kthetrat

Ushtria e Serbisë diktatoriale po shkonte drejt greminës, drejt humbjes së pashmangshme dhe kjo ishte e kuptueshme prej të gjithëve; e kuptonte edhe Juriseviçi pavarësisht se nuk i pëlqente dhe nuk e dëshironte. Të gjithë shqiptarët e Kosovës që ishin strehuar në të katër anët e Shqipërisë filluan të rikthehen në Kukës. Lufta ishte në ditët e fundit të saj dhe kthimi i shqiptarëve nga Kosova në shtëpitë e tyre ishte i sigurt. Nuk kishte më njeri të fliste për refugjatë të ardhur nga Kosova, por vetëm për refugjatë që do të kthehen në Kosovë dhe këtë duhet ta dijë mirë Juriseviçi.

Sipas fakteve të fund-luftës së NATO-s dhe fundit të ushtrisë serbe, del se jo vetëm Cena do të mbeste pa para. Pasi sipas logjikës së autorit s'po vinin më refugjatë në spitalin e Kukësit. Por edhe spitali i kampit "*Italia 1*", ai i EBA s'kishin ku të gjenin më refugjatë. Sipas kësaj llogarie po del me "*humbje*" jo vetëm Cena, por edhe spitalet që ishin ngritur në ndihmë të dëbuarve. Se kush humbi në të vërtetë ta bëjë llogarinë vetë Juriseviçi sepse gjithnjë ka punuar e luftuar për humbjen dhe vetëm humbjen. Fitorja në krahun e shqiptarëve është e huaj për paçavureshkruesin. Kjo miopi dhe dashakeqësi nuk e kuptonte ose nuk donte ta besonte se kush fitoi në atë luftë që tashmë dihet se fitoi populli shqiptar, fitoi Kosova, fitoi Bashkësia Demokratike Ndërkombëtare, fitoi drejtësia. Edhe se kush humbi në atë luftë në të vërtetë ne duhet ta themi për të sqaruar Juriseviçin: Humbi Serbia, humbi ushtria e saj gjakatare dhe diktatura e fundit fashiste në Evropë, diktatura e Millosheviçit. Keq na vjen se ndoshta autorit nuk i shkon për

shtat, por kjo është e vërteta. Serbia humbi, Kosova fitoi. Tani duket pak më i "*çliruar*" nga frika e "*mafiozit*" Cena, kur thotë se *"Cena nuk do të na presë qafën. Porosia është botuar në 'The Stars and Stripes". Është porosi nga Wesli Klark*" (!) duke menduar që t'i japë vetes një rëndësi të veçantë mbasi mbrojtjen e tij e paska marrë në dorë vetë Wesli Klark e NATO! Ëndrra të dëshiruara për një njeri normal, apo halucilaçione të një njeriu të sëmurë mendërisht!? E dyta rezulton plotësisht e saktë.

Për të festuar "*fitoren*" së bashku me Andersonin shkuan në gjellëtore dhe me pulë e me birrë e bëjnë "*festën*". Dhe në bisedën mes tyre, përsëri Cena dhe rrezikshmëria e tij. Madje bisedohet edhe për vrasjet mafioze që mund të realizojë Cena për të hequr qafe Juriseviçin dhe Andersonin! I "*rekomandon*" vetë Juriseviçi mënyrat dhe arsyet për të vërtetuar se Cena do ta vrasë. Është specialist i vërtetë, kur ia servir dhe ia rekomandon Cenës "*mënyrat*" dhe rrethanat e vrasjes së tij. Sipas logjikës së Juriseviçit, pjesa e parë e misionit të tij djallëzor u realizua me sukses falë dhe artikullit të gazetës *"The Stars and Stripes*". Por ai nuk mbaron këtu pasi i duhet të fillojë *"punë të re*" për të synuar objektivin e radhës të misionit të tij.

"*Frika*" e madhe prej mafiozit Cena e detyron të "*sakrifikojë*" profesionin e mjekut (që kurrë nuk e ushtroi) dhe të vijë tek ai çasti kur do të merrte një vendim që asnjëherë se kishte menduar në jetën e tij. Kur "*rastësisht*" takon një qytetar me emrin Fadil dhe ky qytetar edhe më "*rastësisht*" e bindë Juriseviçin se Cena mund ta vrasë. Atëherë Juriseviçi merr vendimin për të "*sakrifikuar*" profesionin e mjekut. Sepse Fadili jo vetëm se e "*bindi*" që Cena mund ta vrasë, por i dha dhe rekomandimet e tij, siç ishte këshilla për t'u larguar fare nga spitali i Kukësit e për të shkuar në një prej kampeve të shumta që ishin vendosur në këtë qytet. Por jo vetëm kaq, në rastin që Juriseviçi bindet

nga faktet e Fadilit pranoi të takohet me persona përgjegjës të UÇK-s në Kukës e për të kërkuar ndihmën e tyre. Biseda midis Juriseviçit dhe Fadilit kishte filluar si falenderim i Fadilit për punën dhe sakrificat e Juriseviçit duke e theksuar se *"asnjë shqiptar nuk do ta bënte atë që bëre ti Craig*", por *"banditët kurrë nuk do ta harrojnë kur u përzihesh me hesapet e tyre*". Prandaj e këshilloi se *"është më mirë për ty nëse ikën nga Kukësi*". Edhe këtë Fadil dhe bisedën me të, Juresiviçi e kthen në favor të misionit. Ai me gojën e Fadilit (një qytetar anonim) siguron mjaft informacion që i duhet. Fadili çuditërisht e njihte mjaft mirë Australinë dhe australianët (!) duke i quajtur njerëz të mirë, por që "të *mirët australianë nuk e njohin Shqipërinë fare*". Dalëngadalë, Fadili (njeriu anonim të cilin nuk mundemi ta verifikojmë deri më sot), filloi t'i shpjegojë Juriseviçit keqfunksionimin e shtetit shqiptar (shtetit të vet), bile argumentonte si një analist i vërtetë.

S'kuptohen qartë motivet e informacionit, por një gjë del qartë se Fadili e "*informon*" Juriseviçin bash ashtu siç e pëlqen ai, bash ashtu siç ia do misioni. Me saktë bash ashtu siç e kishte "*porositur*" ai të "*vlerësonte*" gjendjen e rendit dhe sigurisë në Shqipëri. Nuk mund të ndodhte ndryshe, veçse "*Fadili i tij*" ta informonte se *"Në Shqipëri kur dikush na vjedh nuk shkojmë në polici. Vetë policët janë hajna. Në Shqipëri kur na vjedhin, e gjejmë një armë dhe e vrasim. E kuptove? Ti je hajn (sipas Cenës e mafias). Ata do të vrasin, e kuptove*"? Informatë e porositur! Megjithëse anonim, vërtetë anonim, ky Fadili merr përsipër ta takojë Juriseviçin me një person të rëndësishëm. Shkojnë së bashku në "*Bar Amerika*" dhe aty takojnë një person që e njihte Juriseviçin (!) sepse sapo erdhi tha: *"Mirëmëngjesi dr. Juriseviç! Më vjen mirë që u njohëm*" me një anglishte të shkëlqyer që e impresionoi shumë Juriseviçin duke konkluduar menjëherë se ky ishte njeri i arsimuar dhe se besimi tek të arsimuarit

është pjesë e kulturës së Juriseviçit. Por *"natyrisht se ky besim është një budallallëk; Cena që nuk i afrohet qenies njerëzore, ka tituj dhe diploma pa dyshim*".

Po kush është personi që takon tek "*Bar Amerika*" dhe që çuditërisht e njihte Juriseviçin dhe e thirri në emër. *"Ky person i rëndomtë quhej Hysni Hoxha dhe ishte mjek torakal. Kishte punuar në Kosovë, në Prizren deri para disa muajsh kur u detyrua të ikte për në Kukës. Ishte shkolluar në Gjermani dhe në SHBA*", - shkruan Juriseviçi. Kuptohet që dr. Hoxha nuk mund të rrinte pa e falënderuar Juriseviçin për ato që ai kishte bërë për bashkëkombësit e tij. Artikulli i gazetës vërtetë ishte një shërbim i madh. Ndërsa Juriseviçi i përgjigjet "*Ju faleminderit. Më vjen mirë që dikujt i ka bërë mirë kjo punë*". Biseda midis tyre vazhdon e Juriseviçi gjithnjë e më shumë po "*bindet*" se ai do të jetë "*viktima*" e mafias sepse po i "*shtohet*" gjithnjë numri i atyre që e pohojnë këtë duke filluar nga dr. Vata, Fadili, dr. Hoxha...Prandaj po bën përpjekjet që t'i shmanget rrezikut duke marrë masat e duhura që të fitojë gjyqin në rast se ballafaqohet ndonjëherë. Dhe në këtë rast e ndihmon dr. Hoxha kur i thotë se *"në gjyq NATO-ja kur të gjykohet çështja do të mbështetet tek rrëfimi i Juriseviçit, por mbrojtja pa ju në gjykim (pra, po qe se të vrasin!), do të mund të thoshte se rrëfimi është i shpikur. Një përpjekje për të fituar mbështetës. Diçka që ju dhe shkrimtari e keni zier bashkë. E kuptoni?*". Dhe Juriseviçi pyet *"Dhe për këtë do të rrezikonin të më vrisnin*"? Ndërsa dr. Hoxha, me llogjikën e një superspecialisti antikrim (megjithëse ishte një mjek) i thotë Juriseviçit se *"dr. Juriseviç, për ta nuk është rrezik t'ju vrasin. Rreziku është nëse nuk ju vrasin. Kjo është e vërteta pikëlluese për Shqipërinë për fat të keq. Ta vrasësh dikë është sigurimi që kushton më lirë*". (edhe CIA e FBI do ta kishin zili dr. Hoxhën).

Ky "*gjykim*" dhe kjo "*analizë*" e dr. torakal Hysni Hoxha s'ka se si të mos na "*bindë*" ngaqë tre muaj në Kukës ka qenë kohë e mjaftueshme për t'u "*aftësuar*" që ta njohë Shqipërinë, shtetin shqiptar, gjendjen e rendit dhe të sigurisë, shkaqet dhe përmasat e krimit më mirë se kushdo tjetër dhe çuditërisht t'ia bëjë të njohura Juriseviçit! Si është e mundur që dr. Hoxha e informonte Juriseviçin bash për ato që i duheshin. Çfarë konsensualiteti midis tyre! Dhe për t'ua vënë "*vulën*" vërtetësive që dr. Hoxha ia thotë Juriseviçit, ky i fundit informohet gjatë bisedës se na qenkej komandant i UÇK-s; këtë ia tha vetë dr. Hysni Hoxha!

Ne që kemi jetuar në Kukës dhe që kemi njohur nga afër shumicën e kuadrove dhe ushtarëve të UÇK që kanë jetuar, vepruar e që kanë kaluar nëpër Kukës qysh para fillimit të luftës e deri në përfundimin e saj nuk e kemi njohur as nuk e kemi dëgjuar këtë komandant fantazmë të UÇK-s në Kukës me një emër të tillë! Në biseda dhe në diskutime me ushtarakë të Divizionit të Kukësit që kanë marrë pjesë aktive në ndihmë të forcave të UÇK-s, nuk e mbajnë mend "*komandant*" Hysni Hoxhën në Kukës. Asnjë mjek, infermiere dhe farmacist i Kukësit nuk e mban mend mjekut torakal Hysni Hoxha. Nuk kemi hasur në asnjë recetë apo dokument tjetër emrin dhe firmën e tij. Por edhe funksionimi i UÇK, pozita e saj në kohë lufte nuk besojmë se udhëhiqej nga komandantë të *"tipit Hoxha*" që nuk zbatonin asnjë rregull, standard dhe parimi moral në lidhjet me publikun dhe sidomos me të huajt, e për më tepër kur ato janë edhe "*viç*"- ër.

XXIII - Ndërmarrja e "guximshme" e misionarit të djallit

Por kjo ishte ëndrra dhe dëshira e Juriseviçit, objektivi i tij (në funksion të misionit të djallit) që sa më

shumë "*viç*"-ër të infiltronin në radhët e UÇK. Ç'është e vërteta edhe mund të kenë infiltruar se luftë ishte dhe këso situatash edhe mund të ndodhin gjëra të tilla, por rastet janë zbuluar dhe e kanë marrë "*shpërblimin*" e merituar.

Interesante duket vazhdimi i bisedës Juriseviç-Hoxha kur ky i fundit i thotë se *"e kemi një vend rekrutimi të UÇK-s në Kukës. E dini këtë*?" "*Po,* - përgjigjet Juriseviçi dhe ai e pyet Hoxhën se "*si po shkon rekrutimi? A po bashkohen burrat?*". Nuk ka faj Juriseviçi i duhet të dijë sa më shumë për UÇK sepse para një komandanti "*leshko*" si Hoxha e konsideron veten "*të tanët*" duke e rreshtuar veten "*me ne*" pra me UÇK. në komunikimin e Hoxhës me Juriseviçin gjatë bisedës midis tyre i thotë *"dr. Craig*", në praktikim të një proçedurë "*lehtësuese*" për Juriseviçin. Por duke e ditur se për ne dhe për çdo shqiptar UÇK dhe "*viç*"-ërit ishin armiq të betuar dhe luftonin njëri-tjetrin për jetë a vdekje. Asnjë njeri normal nuk e beson "*komandant*" Hoxhën e kafenesë.

Si njeri i konspiracionit, Juriseviçi nuk e pranon aq lehtë dhe aq shpejt ofertën e UÇK-s (në fakt të Hoxhës) për t'iu bashkuar asaj. Dhe Hoxha i jep të drejtë duke i thënë se *"shpresoj se do të viheni nën mbrojtjen tonë atëherë*"! Duket më shumë se një lutje e Hoxhës. Duke parë lajmet në ekran, Juriseviçi preferon më shumë BBC si burimi më i besueshëm dhe i vetëm i informacionit. Kurse për NATO-n shprehet se *"Brifingjet që na i bën Xhemi Shi (zëdhënësi i NATO-s), zyrtari për informacionin e NATO-s janë gjithnjë çmendurisht të pashtjella sa që në fund nuk zbulojnë asgjë*". A thua të jetë kjo një urrejtje për NATO-n apo një frikë prej saj!? Të dyja bashkë themi ne.

Por Juriseviçit i rreh diku tjetër; i rreh në zanatin e tij bazë kur thotë e shkruan se *"më trondit fakti se Fadili dhe Hoxha po flasin para meje sikur të isha unë njëri nga ata. E marrin të garantuar sikur unë jam i interesuar për fitoren e UÇK-së. Por unë kurrë nuk kam pranuar se anoj nga UÇK-*

ja dhe nuk më pëlqen supozimi". Por edhe më shumë nuk më pëlqen perspektiva që ndonjë mafioz të ma heqë flamën. Edhe ne jemi përpjekur ta vërtetojmë se autori i librit është i tillë, siç e deklaron vetë më në fund; është kundër UÇK-së, kundër Kosovës, kundër shqiptarëve. Por duke lexuar me kujdes çfarë shkruan në paçavure nuk është kundër ushtrisë serbe, Serbisë e kundër serbëve. I ndodhur midis dy "*zjarreve*" që vetë i ndezi në synim të objektivit të dytë të misionit të tij, në zjarrin e UÇK-s (që nuk e ka dashur, nuk e do e as do ta dojë asnjëherë) nga njëra anë dhe në zjarrin e "*mafias*" (që e imagjinon dhe e shpikë vetë) fillon të anojë nga UÇK-ja jo se dëshiron, porse misioni ja kërkon. Por edhe pse pranon më në fund të shkojë në radhët e UÇK-s, ende pa u takuar me asnjë pjesëtar të saj e jep vlerësimin e tij prej "*specialisti*". Shprehet se *"njerëzit e UÇK-së janë më të mirët në një skenar më të gjerë që po luhet këtu, por edhe në mesin e tyre ka vrasës të shkathët dhe të pashpirt sikurse paramilitarët serbë, jam i sigurt për këtë*". (!)

Si është e mundur të shfaqet kaq i pacipë!? Si guxon ky individ krejt anonim dhe i parëndësishëm në gjithë atë ngjarje të krahasojë ushtarët dhe komandantët e lavdishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me paramilitarët kriminelë serbë!? Si është e mundur që me këto mend "*vendos*" t'i bashkohet UÇK-s!? Mos vallë për ta "*ndihmuar*" që ajo të kriminalizohet!? Apo mos kishte një qëllim më të errët që nga radhët e UÇK-s të ndihmojë ushtrinë serbe me informata të sakta për vendndodhjen e forcave të UÇK-s, për numrin e saktë të forcave, pajisjen dhe armatimin e tyre...!? Mision krejt i pamundur, sepse Juriseviçi siç thamë më lart ishte i parëndësishëm. Thënë krejt thjeshtë; nuk ishte kurrfarë faktori. Ne mendojmë se qëllimi kryesor për t'iu bashkëngjitë UÇK-së; do të vërtetohet sapo të arrish në Helshan e deri sa të mbarojë lufta në Kosovë! Por sido që të jetë, Juriseviçi në një mënyrë a tjetër e realizoi qëllimin e

vet: depërtoi në radhët e UÇK-s me siguri jo për të mirën e saj, por për të realizuar misionin e tij të poshtër antishqiptar. Pak rëndësi pati për të nëse njerëzit për të cilët shkruan në paçavurë janë ose jo të vërtetë, apo nëse ngjarjet që përshkruan janë të vërteta apo të sajuara; më tepër rëndësi për të pati "*fitorja*" e tij, synimi; u fut në radhët e UÇK-s.

Për këtë e ka meritën e nuk ia mohon askush. Por më shumë është faji i shqiptarëve dhe i luftëtarëve. Është faji ynë! E dimë, por me vonesë! Pas bisedave dhe konsultimeve me *"shqiptarë të ndershëm*" që Juriseviçi i gjen gjithnjë e s'mbetet kurrë pa ta (si Ylberi, Milaimi, Fadili, Hoxha...dreqi) më në fund bindet plotësisht se mund ta vrasin dhe i kujtohet këshilla e gazetarit Anderson se *"duhet të ikte nga Kukësi*" të shkonte në Tiranë dhe të largohej nga Shqipëria.

Por NATO-ja (ah kjo NATO-ja sa pengesa i nxirrte Juriseviçit) kishte urdhëruar ndalimfluturimet në Shqipëri dhe në një pjesë të Kosovës. Askush nuk ka dëgjuar për këtë urdhër të NATO-s, veç Juriseviçit. *"Poqese nisesh me veturë në Tiranë, mbase vdes*", sepse *"Adeti plot kolorit i shqiptarëve, për t'i ndalur veturat dhe kamionët e rrugës e për t'i bërë shoshë me automatik shoferët dhe udhëtarët është shndërruar në një festival të hareshëm gjithëkombëtar*" (!) Është hera e parë që ato që i thotë e i shkruan për rrugëtimin e Tiranës, i nxjerr nga goja e tij dhe jo nga goja e ndonjë personi tjetër. Megjithatë nuk thotë asgjë të vërtetë sepse për ditët për të cilat flet ai, NATO-ja nuk kishte dhënë ndonjë urdhër për ndalimin e fluturimeve mbi Shqipëri. (Fakti është lehtësisht i verifikueshëm). Edhe përshkrimi që bën (me hamendje) për gjendjen e pasigurt të rrugës automobilistike Kukës-Tiranë nuk përputhet me asnjë realitet. Gjatë kohës së rëndë të pragtragjedisë së vitit 1999 nuk ka pasur asnjë grabitje apo vrasje dhe asnjë rast ndalimi të automjeteve në rrugën Kukës-Tiranë. Për siguri

maksimale qeveria shqiptare kishte urdhëruar forcat speciale ta patrullonin atë aks rrugor çdo ditë 24 orë pa ndërprerje. Juriseviçi asnjëherë nuk ka udhëtuar nga Kukësi në Tiranë me rrugë tokësore dhe nuk e dimë se kush ia ka treguar aq dramatikisht disa episode të ndodhura dy vite më parë (1997)!

Sidoqoftë, sipas Juriseviçit, "*faktet*" e rrugës Kukës-Tiranë iu shtuan "*fakteve*" që kishte mbledhur deri më tani e çonin tek alternativa e vetme: t'i bashkohej UÇK-së! Dhe për këtë i vjen keq pasi nuk mund të jetë më kirurg i IMC-s në këtë mision bamirësie. Por do të jetë *"rekrut i UÇK-së për të gjitha qëllimet dhe caqet*". Sa bukur e "*vërtetoi*" më në fund! *"Nuk kam rrugëdalje tjetër*, - thotë Juriseviçi, - *pos ta braktis Kukësin. M'u imponua*". Por para se ta linte Kukësin kishte planifikuar të linte një "*dokument*" akuzues të ri për spitalin e Kukësit duke e firmosur me dorën e tij. Një fare tip testamenti, porosie apo amaneti…Ky dokument është *"Përmbledhja e ngjarjeve të fundit. Çështja e spitalit të Kukësit*" që në fakt është një përsëritje e rëndomtë e fakteve" që ishin dhënë nga ana e tij për gazetën *"The Stars and Stripes*" dhe janë botuar më 24 maj 1999. Rishkrimi i tyre në paçavurë e ka qëllimin më të keq; të japë sa më shumë ngjarje e ndodhi anonime, më shumë të sëmurë e të plagosur të paidentifikuar, të vdekur të shpikur (vdekje që s'kanë ndodhur asnjëherë) dhe sidomos akuza monstruoze për mjekët e nderuar e të respektuar të Kukësit të cilët jo vetëm se kanë mbajtur peshën kryesore të shërbimit shëndetësor për të ardhurit nga Kosova dhe të qytetarëve vendas dhe kanë punuar me përkushtim, me ndërgjegje, e pa e tepruar, me heroizëm duke arritur rezultate cilësore në shërbimin shëndetësor të spitalit. Të dhënat që dalin nga studimi i veprimtarisë së spitalit të Kukësit, sidomos kirurgjia dhe pediatria flasin qartë e s'kanë nevojë për asnjë koment.

Është absolutisht kriminale kur Juriseviçi shkruan në paçavurën e tij dhe akuzon mjekët Mustaf Mustafa e Shaqir Shehu kur shkruan se "*dr. Mustafa dhe dr. Shaqiri (kirurgë) haptazi kërkojnë pagesë për operacione nga pacientët; mospagesa ka për rezultat refuzimin e këtyre dy mjekëve që të operojnë. Ka disa shembuj përshkrues të kësaj neglizhence kriminale*". Dhe "*shembujt*" e kësaj neglizhence tashmë dihen; janë pa emër, mbiemër, iniciale, pa nr. kartele... Plotësisht anonim. Shembuj që gjenden vetëm në mendjen djallëzore të Juriseviçit sepse e kemi thënë disa herë dhe e deklarojmë përsëri se asnjë i "*sëmurë*", i "*plagosur*", asnjë i vdekur prej atyre që i "*sëmurë*", i "*plagos*", i "*operon*" ose i "*vdes*" Juriseviçi nuk është i vërtetë. Nuk figuron e nuk vërtetohet nga asnjë dokument i arkivit të spitalit, as nga mjekët, infermieret, punonjësit e tjerë shëndetësor që kanë punuar në atë kohë dhe që punojnë edhe sot në spital të Kukësit. Jemi përpjekur shumë, jemi marrë me dokumentacionin disa herë, kemi takuar pothuajse të gjithë personelin e spitalit që ka punuar në atë kohë dhe s'kemi gjetur asnjë *"fakt juriseviçian*". Asnjë të vetëm. E me atë palo "Përmbledhje..., synohet të përbaltet qeveria e Shqipërisë, ministria e shëndetësisë, pushteti vendor dhe gjithë institucionet vartëse të tyre Dhe shkruan se *"Ky është përshkrimi i saktë*" i ngjarjeve që kanë ndodhur ndërmjet 20 dhe 24 majit 1999 dhe mund të shërbejë si evidencë e aktiviteteve të mia gjatë kësaj periudhe. Objektin e kishte që të linte diçka të shkruar me dorën e tij si *"dokument i saktë*".

E pasi vjen dorëheqja nga puna në IMC në cilësinë e kirurgut vullnetar duke vendosur datën 26 maj 1999. Deklaron se *"Që nga sot tërhiqem nga puna në IMC në cilësinë e kirurgut vullnetar. Lutemi ta pranoni zyrtarisht dorëheqjen tonë nga International Medical Corps. Sinqerisht Craig Juriseviç*" d.v. Po dorëheqjen si koordinator kirurgjik i spitaleve dhe njësive mjekësore të kampeve për Kukësin

Juriseviçi harroi ta bëjë! Ai qe pajisur me makinë, me shofer e me radio nga UNHCR-ja, kur u "*gradua*" koordinator! Kujt ia dorëzoi atë detyrë a thua!? Apo siç duket ia ka fut kot pasi ky individ kishte edhe detyra e misione që nuk mund të deklaroheshin. Diçka "*çalon*" në sinqeritetin e mjekut misterioz dhe misionin e tij humanitar për të cilin erdhi nga Australia e largët. Që nga ai moment (i dorëheqjes) Juriseviçi nuk mund të vinte në spital të Kukësit për të ushtruar një detyrë për të cilën e kishte dhënë dorëheqjen si mjek kirurg vullnetar i IMC-s. Pikërisht për shkak të asaj dorëheqje s'ka asgjë të vërtetë në "operacionet e tij" në sallën e operacionit më 26 maj 1999. Kjo është e vërteta e pakundërshtueshme e 26 majit 1999 për Juriseviçin dhe sallën e operacionit.

Puna e përditshme në spital

Por çudia për të gjithë është se emri i Juriseviçit në kartelën e një të sëmuri si asistent i dr. Vatës është i shkruar me dorën e dr. Vatës! Një ndërmarrje e pakuptueshme (!) e dr. Vatës për të dokumentuar të pavërtetën e ka një shkak

tejet të fortë, por atë e di e mund ta thotë vetëm dr. Vata.

Ndërsa për Juriseviçin shënohet një pretendim i mjerë, një synim tjetër djallëzor, një e pavërtetë e re në vargun e pafund të të pavërtetave të tij dhe që tashmë na bindin të gjithëve se "*kirurgu*" Juriseviç është vërtetë e pavërteta e madhe dhe çdo gjë që lidhet me të e ka vetëm një emër: P A V Ë R T E T Ë S I.

Të nesërmen, më 27 maj 1999, dita kur do të niset për në kampin UÇK-së në Helshan për Juriseviçin do të jetë një ditë që "*mbase do ta kthejë kokën prapa nga kjo datë si nisjen e një gabimi trashanik*". Sepse "*po futem në territor të panjohur*", - shkruan ai. Se pse u fut në atë rrugë nuk e dimë ne. E di vetëm ai se kush e detyroi e për ç'arsye. E kishte më të lehtë të kthehej në Australi. Mirëpo...misioni i djallit ia kërkonte të vepronte ashtu.

Nisja bëhet me dy "*Land Cruiseir*"-at mbasi marrim ilaçet nga magazina dhe i ngarkojnë me ndihmën e mjekëve të tjerë të IMC-s. Me vete marrin edhe një mjek të spitalit të Kukësit me emrin Mehmet, për të cilin thuhet se "*është mjek i ndershëm, i cili i shmanget çdo kontakti me Cenën*". *"Mehmeti (që realisht është emri i një mjeku shumë të nderuar e të respektuar të spitalit që nuk është nga Helshani) më flet në veturë para se të nisemi, për familjen e tij, për shpresat që ka për një Shqipëri më të mirë, për Kosovën e lirë*" - shkruan Juriseviçi, që më tej vazhdon "*Jeton në Helshan dhe po vjen për të vizituar familjen. Thotë se djali i është bashkuar me UÇK-në...*". Qysh në fillim gabohet se Mehmeti (Mehmeti i tij) është banor i qytetit të Kukësit ndërsa prindërit dhe të afërmit i ka në Helshan dhe po shkon t'i shohë. Ai nuk ka djalë në UÇK, pasi e ka shumë të vogël në moshë e ne nuk besojmë se të paska thënë se djali i është bashkuar me UÇK! kur është një vjeç. Vetëm "*Mehmeti i tij*" mund ta çojë djalin në UÇK në këtë moshë!

Me të mbërritur në Helshan e përshkruan fshat të bukur bujqësor të lakmueshëm për turistët. Menjëherë e bëri vlerësimin e tij për fshatin në rolin e një *"specialisti ushtarak*" duke thënë se *"është fshat aq i ekspozuar ndaj sulmeve të artilerisë, saqë predhat minahedhëse serbe do të mund ta fshinin nga faqja e dheut krejt fshatin vetëm me nja pesë të qëlluara të sakta*". Harron se vetëm dëshira e tij djallëzore që kjo të ndodhte (që fshati të qëllohej e të zhdukej nga faqja e dheut) nuk është ndonjë shkak i madh që Helshani të mos ishte aty ku është. Aty ku Zoti e ka vendosë pa pyetur fare për "*vërejtjet*" dhe "*parashikimet*" keqdashëse të Juriseviçit. Por edhe kësaj here si çdo herë, Juriseviçi merret më shumë me vdekjen se me jetën (!). Sapo sheh *"tre kamionë me ushtarë të UÇK-së që kalojnë për t'iu bashkuar luftëtarëve në front. Shumica e tyre ende pa i mbushur të njëzetat dhe burra të rinj: O Zot, nëse këta fëmijë duhet të vdesin le të jetë ajo vdekje e shpejtë*"! Pse ndjell vdekje për ushtarët e UÇK-së për ata kanë vendosur të çlirojnë Kosovën dhe të jetojnë të lirë në Atdheun e tyre të lirë nuk e dimë!

Shtëpinë e Mehmetit e përshkruan si një shtëpi tipike shqiptare, të pastër, të rregullt, me njerëz bujarë e mikpritës që bëjnë jetë të thjeshtë e të ndershme. Një familje atdhetare dhe e vendosur të përballojë çdo vështirësi e pengesë, madje edhe çdo sulm armik si fshat kufitar. Por nuk është i saktë (nuk thotë të vërtetën), për më tepër trillon kur shkruan se *"mjeku i ngre dolli të birit dhe i thotë suksese*" kur siç thamë, mjeku nuk ka djalë në UÇK! Apo në rastin kur mjeku pas drekës *"na tregon fermën e tij të vogël. Një ullishte (!) të bukur, mbase nja njëzet edha dhe dele*" duke gënjyer hapur. Në Helshan nuk janë njohur e mbjellur kurrë ullinjtë. Klima e Helshanit dhe ullinjtë nuk përshtaten absolutisht.

E ndërsa për *"njëzet edhat e delet*" (gjithnjë nëse Flaka ka përkthyer saktë në gjuhën shqipe) është shumë i pamundur ai kombinim. Sepse edhat janë të vegjlit e dhive

dhe jo të deleve; këto mund të quhen edhe keca, ndërsa të vegjlit e deleve janë qengjat, e këta nuk kanë emër tjetër!

Kur e viziton kampin e UÇK-së i cili është i vendosur në tokën e mjekut që është krenar për këtë se po ndihmon vëllezërit dhe motrat kosovare që po luftojnë për çlirimin e Kosovës, ngulë këmbë në rrezikun që e kanosë familjen e mjekut nga sulmet serbe. Madje ai shprehet se *"e sheh se ka shumë mundësi që gjërat të shkojnë mbrapsht si për Mehmetin ashtu edhe për familjen e tij. Më impresionon guximi i babait dhe i djalit. E dinë ata shumë më mirë se unë se çfarë tmerri do të përjetonin po qe se serbët do të invadojnë*" (një dëshirë të përhershme e Juriseviçit)! Po a nuk e di a thua Juriseviçi se njeriu nuk e zgjedh vetë armikun! Por a mund të bëhet ky shkak që të mos e luftosh armikun! A mos duhet të jetë shkak që të mos e luftosh armikun!? Historia e shqiptarëve ka qenë luftë, qëndresë dhe fitore me të gjithë armiqtë deri më sot; s'ka si të mos vazhdojë kjo luftë deri në plotësimin e amanetit të atyre burrave dhe grave shqiptare që dhanë jetën e tyre për çlirimin e të gjitha trojeve shqiptare deri në realizimin e bashkimit kombëtar shqiptar në një shtet të vetëm.

Gjithnjë me një mllef të madh kundër shqiptarëve, me një simpati të "*fshehtë*" për serbët të cilët i vlerëson tejet të fuqishëm (në fakt i dëshiron të jenë ashtu) dhe që mund t'i invadojnë e të masakrojnë familjen e Mehmetit e do të granatonin bazën e UÇK-s vetëm me një forcë ushtarësh, e bile të kishin kohë të ktheheshin në Kosovë për të ngrënë mëngjesin. E kemi thënë shpesh, por po e themi edhe njëherë se serbët janë kriminelë, të këqij e të pabesë, por gjithsesi nuk janë aq budallenj sa të sulmojnë (siç dëshiron mendja e sëmurë e autorit) asnjë metër territor të Republikës së Shqipërisë. Ata e dinë fort mirë se Shqipëria, populli shqiptar dhe ushtria shqiptare janë këtu ku janë. Janë këtu ku i ka vendosur Zoti. Kanë qenë, janë e do të jenë gjithnjë të

gatshëm të sprapsin me sukses çdo sulm siç ka ndodhur në histori.

Me njohuri të kënaqshme për politikën rajonale (siç duket i kanë bërë mirë konsultat dhe bisedat me dr. Vatën) Juriseviçi si një "*analist*" i vërtetë ushtarak rajonal mendon se "*serbët e shohin këtë luftë si shansin e artë për ta shndërruar veten në padron të gjithë rajonit të Ballkanit, duke besuar se rusët do t'i përkrahin në çdo hap*" dhe më tej e zgjeron "*analizën*" duke u shprehur "*…dhe gjithashtu (serbët-M.B.) besojnë se Perëndimi kurrë nuk do të shkojë deri në fund për ta përkrahur një shtet të ri mysliman në Ballkan që do të ishte Kosova e pavarur, një shtet mysliman defakto, që përkufizohet me një shtet mysliman defakto, Shqipërinë*". Jurisheviçit i pëlqen shumë që amerikanët dhe evropianët "*të mos shqetësohen shume po qe se myslimanët të sakatoheshin aq sa do të brengoseshin po qe se kosovarët do të ishin të krishterë biondë*". Kot e ka djalli autor i këtij libri se teoritë e tij fetare as nuk kanë qenë e as janë në vëmendjen e botës demokratike. Kjo sepse në fokusin e tyre është respektimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave kombëtare për të gjithë kombet pa asnjë dallim.

Bota demokratike ka dhënë kontributin kryesor në shpartallimin dhe përmbysjen e diktaturave dhe në çlirimin e kombeve pa asnjë dallim, si në Greqi, Spanjë, Kili, Nikaragua, Irak, Afganistan, Tunizi, Egjipt, Libi...pavarësisht faktit nëse ishin vende apo popuj ortodoksë, myslimanë, katolikë... Jurisheviçi bën kujdes dhe e "*këshillon*" Mehmetin dhe djalin e tij kur shkruan se nuk do të ndjehesha krenar që "djali im 18 vjeçar po luftonte me një guerile të improvizuar kundër një armiku të armatosur mirë, i cili ushtron dënime sadiste ndaj të zënëve robër". Por do t'i thosha: "*Biri im, të lutem mos rreziko kot të lutem, mbaji sytë hapur e krahët çelë, të lutem kthehu i palënduar, i*

gjallë dhe asnjëherë mos e bëj një gjë të tillë në jetën tënde". Kur të ngrija dolli me të (tim bir) "*nuk do t'i thosha suksese*". Duket shumë qartë apeli i Juriseviçit: Ju shqiptarë mos shkoni në luftë. Por ky mesazh nuk vlen për shqiptarët e asnjë popull në botë sepse është mesazh antinjerëzor dhe djallëzor. Është mesazh i misionit të djallit. Të gjithë popujt dhe kombet në botë kanë luftuar për liri dhe të drejta, kanë luftuar për çlirimin e vendit të tyre nga pushtuesit dhe gjithnjë kanë dalë fitimtarë pasi janë betuar dhe kanë dhënë jetën për çlirim. Pas betimit, përgatitja luftarake e përvojat ushtarake kanë ardhur duke u rritur e shtuar duke bërë që edhe pushtues të fuqishëm të armatosur e kriminelë janë shpartalluar e thyer me turp. Kështu e kanë filluar dhe vazhduar popujt luftën e tyre çlirimtare dhe gjithnjë kanë fituar. Shumë vite më parë në luftën e Vietnamit një nga udhëheqësit e luftës popullore çlirimtare (vietnamezët ishin në luftë me SHBA që veç trupave të rregullta ushtarake prej 530 mijë vetash kishin teknikën dhe armatimin më të fuqishëm të kohës) pat deklaruar se "*Vietnamezët do ta fitojnë luftën me SHBA*". Kur një gazetar e pyeti se "*pse është kaq i sigurt me fitoren*" ai pat dhënë këtë përgjigje: "*Sepse ka shumë më tepër vietnamezë që japin jetën për Vietnamin se sa amerikanë*". Dhe në librin e tij "*Diplomacia*" Henri Kizinger e vlerëson shumë këtë fakt duke analizuar atë luftë të SHBA-së në Vietnam. Në libërpaçavuren autori jep "*këshillën*" që të mos futen në luftë shqiptarët. Se armiku na qenka më i fuqishëm, më i armatosur dhe sadist ndaj të zënëve rob. Se ata (shqiptarët) na qenkan vetëm një *"gueril i improvizuar dhe nuk paskan fuqi të dalin fitimtarë*".

Autorit nuk i duket asgjë vendimi i shqiptarëve që të japin jetën për çlirimin e atdheut të tyre. Nuk e vlerëson fare gjakun e derdhur për çlirimin e trojeve etnike shqiptare. Duket qartë, Juriseviçi nuk ka atdhe (nuk e di as vetë, nuk na e vërteton as ne se cili është atdheu i tij. Përfundimisht ai

është një njeri i "*shkulur*" që nuk e di se nga është shkulur! Nuk e di as origjinën e tij dhe as të familjes. Prandaj dhe është kohë e humbur t'i mbushësh mendjen se pse shqiptarit nga *"7 deri 70*" e kanë dhënë dhe e japin jetën si *"me le*" për Atdheun e tyre. Shqiptarët e kanë Atdheun e tyre, e kanë vendin e tyre të mrekullueshëm që Zoti u ka dhënë, e kanë popullin dhe kombin e tyre. Jeta dhe gjaku i çdo shqiptari në mbrojtje të Atdheut dhe të Kombit Shqiptar ia ka shtuar jetën Atdheut dhe Kombit. Populli shqiptar është një popull që jo vetëm e meritoi, por edhe e siguroi inkurajimin dhe përkrahjen për luftën e tij të ligjshme, luftën çlirimtare (që veç kuptimit të çlirimit nga pushtuesit e huaj, nuk besojmë të ketë ndonjë kuptim tjetër). I tillë ka qenë dhe do të jetë gjithnjë populli shqiptar: Për liri e për Atdhe ka dhënë jetën si me le.

Pas ndarjes së përzemërt me familjen e Mehmetit, vjen pritja që u bëhet në kampin e UÇK-së. Në fillim i ndalojnë te porta rojet deri sa i ftojnë të hyjnë. Para se të hyjnë, Juriseviçi si gjithnjë i vëmendshëm, vëren nga jashtë njerëzit e veshur me uniformë të UÇK-s. Dhe menjëherë e bën llogarinë kur shkruan se "*UÇK-ja duhet të përbëhet nga burrat dhe gratë që janë në përpjesëtim tre me një*". Vetëm Juriseviçi është ashtu i vëmendshëm dhe aq i saktë duke arritur me shpejtësi të inkasojë në trurin e tij të dhëna të çdo lloj natyre për UÇK-në që në takimin e parë para se të futet brenda territorit të kampit. Si duket truri i tij ishte i parapërgatitur për shumë gjëra (qysh kur u nis nga Australia), sepse edhe në aeroport "*zbuloi*" se gazetarët ishin në raportin tre me një me njerëzit e tjerë të pranishëm. Ndërsa për UÇK-në bëri menjëherë një "*zbulim*" që kur zbriti në tokë kur shkruan se "*ekipi i diasporës do të prisja që të ishte një përzierje e vullnetarëve të sinqertë, por dhe e banditëve, rambove potencialë, psikotike ...*". E më tej shkruan se "*madje ka dhe një numër muxhahidinësh nga*

Afganistani që kishin luftuar kundër rusëve në luftën civile të Afganistanit të viteve 1980-1988 dhe që kishin ardhur për të përkahur vëllezërit e tyre myslimanë".

Që në fillim të kontaktit të parë me UÇK-n Juriseviçi qëllimisht e thekson *"faktorin mysliman*" në UÇK. Për më tepër atë *"faktor mysliman*" që jo vetëm se është më i largëti, (Shqipëri-Afganistan – largësi e madhe) por më ekstremisti, "*myslimanizmin afgan*" (!) E ka pikësynimin e misionit të tij në këtë përcaktim për UÇK-n. Por e ka kot, sepse UÇK-n e kishte njohur, përkrahur dhe mbështetur e gjithë bota; vendet e fuqishme demokratike si SHBA-ja, vendet më të fuqishme të BE-s, organizmat kryesore ndërkombëtare si OKB-ja, NATO-ja…duke ja ulur tej mase vlerën teorisë së "*myslimanizmit afgan*" të Juriseviçit. Tentativa e përbaltjes është qëllimi dhe objektivi themelor i Juriseviçit në çdo rresht të paçavures së tij për çdo gjë shqiptare, për çdo veprimtari shqiptare; për çdo traditë e zakon shqiptar, sepse ky është qëllimi kryesor i ardhjes së tij nga Australia e largët dhe përpjekja e përhershme e tij. Prej faqes së parë deri tek ajo e fundit e paçavures synimi është që lexuesit t'ia mbushë mendjen se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"! Ky është misioni i djallit.

Tashmë dihet se synimi i Juriseviçit mbeti në tentativë, sepse bota demokratike ishte dhe është me shqiptarët. Ishte me UÇK-n dhe me luftën e saj për çlirimin e Kosovës shqiptare nga pushtuesit serbë duke dhënë kontributin e madh që historia e padrejtësisë ndaj kombit shqiptar të vihet në vend. Është vetëm Juriseviçi, shefat dhe mbështetësit e tij që UÇK-n e "*vlerësojnë*" si një guerile të armatosur me armë bërllok dhe të pafuqishme për t'i bërë ballë ushtrisë serbe duke mos e fshehur dot urrejtjen për këtë formacion ushtarak heroik e simpatinë për ushtrinë serbe si ushtri e fuqishme, e armatosur mirë, bile nga më të fuqishmet në Evropë e në botë. Dhe vazhdon t'i "*kruhet*" kur

më tej shkruan se "*do të ketë pasur ose jo abuzime nga ushtarët e UÇK-s ndaj serbëve në Kosovë gjatë kësaj periudhe – ushtarët që më informojnë nuk e përjashtojnë këtë mundësi, e, as unë ...*", - duke bërë të pamundurën që ta kriminalizojë UÇK-n e lavdishme pa asnjë fakt, pa asnjë argument, por vetëm, thjesht se ia do misioni që i kanë caktuar.

Në tentativën e dështuar për të barazuar krimet masive serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, gjenocidin e egër serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, krimet monstruoze të fashizmit modern serb ndaj shqiptarëve në fundshekullin e XX-të në mes të Evropës dhe në sytë e gjithë botës me abuzimet imagjinare (sipas tij të UÇK-s), nuk mund të arrijë asgjë më shumë sesa nivelin e një mjerani të rëndomtë dhe të një shërbëtori të përulur të serbëve. Prandaj dhe erdhi që nga Australia e largët. Çdo njeri i ndershëm, çdo njeri i thjeshtë, kudo në botë e kupton këtë, aq më shumë çdo shqiptar. Me shpjegimin e tij tejet cinik, me arsyetimin e tij tejet djallëzor i ve "*kapakun*" filozofisë së tij fashiste kur shkruan se "*me gjasë do të ketë qenë triku me tri letra: Serbët i presin në fyt një numër të madh shqiptarësh, UÇK-ja në hakmarrje i pret në fyt disa serbë. E më pas serbët nën një gjendje të hidhërimit, nën ethe bërtasin: Shihni, shihni! Ata shqiptarët zuzarë po na presin në fyt, që kështu të mos e lënë asnjë frymë shqiptare të sigurt*". "*Analiza*" të tilla kriminale kanë bërë vetëm djalli dhe serbët. Dhe me këtë paçavure edhe kirurgu misionar Juriseviç. Por ka harruar se në atë kohë ishte bota e vërtetë demokratike që bëri një analizë tjetër, një analizë reale të gjendjes së shqiptarëve të Kosovës, shkeljen e çdo të drejte kombëtare e njerëzore të shqiptarëve, dhunën dhe gjenocidin fashist serb ndaj shqiptarëve dhe u rreshtua në krahun e shqiptarëve. Mbështeti popullin shqiptar dhe luftën çlirimtare të UÇK-s. Kështu që pak rëndësi ose aspak s'pati "*analiza*" djallëzore e kriminale e Juriseviçit. Por

përpara se ta bënte atë analizë, sapo u fut për herë të parë brenda kampit të parë të UÇK-s në Helshan; njeriun i parë që takoi ishte Hysni Hoxha (doktori torakal) të cilin e kishte takuar më parë tek *"Bar Amerika"* në Kukës. E njihte, prandaj dhe s'kish si të mos e takonte. Bile të parin.

Ky takim në dukje i rastësishëm, ishte i menduar e i planifikuar nga ana e Juriseviçit mbi bazën e një skenari të planifikuar më parë! Ndryshe nuk do të kishte se ku ta gjente për ta përshkruar në "*kujtimet*" e tij pas dhjetë vjetësh. Në paçavure shkruan se *"Hoxha na i shtrëngon duart dhe na përshëndet me një buzëqeshje të gjerë mirëseardhje"*; *"dr. Juriseviç kam nderin t'ju përshëndes. Edhe ju dr. Lake, dr. Vitachi*". E më tej shkruan se "*Hoxha na informon në detaje thuajse do të dëshmojë se tash e konsideronte se i takonim anës së tij*" duke kërkuar falje që të njoftonte komandantin e kampit të UÇK-së se kishin arritur. Dhe teksa prisnin kthimin e Hoxhës me komandantin, disa ushtarë të UÇK-së na ftojnë të ulemi me to rreth tavolinës "*nën një mështekën*"! Se çfarë lidhje ka mështekna me Helshanin vetëm Juresiviçi mund ta sqarojë. Në Helshan nuk ka mështekna! Ky fshat i krahinës së Hasit nuk ka klimë për mështekna! Por nejse, kur Helshani kultivon *"ullinj juriseviçianë"* nuk mund të mos ja plotesojë dëshirën Juriseviçit për të kultivuar edhe "*mështeknat juriseviçiane*"! Edhe komandanti (Ajvet Misini) që na e prezanton Hoxha na takon dhe nëpërmjet Hoxhës si përkthyes, *"na informon për kampin e UÇK-s për kapacitetin dhe funksionimin e tij dhe na thotë se kjo bazë është si katapulte për përcjelljen e ushtarëve në vijën e frontit të zonës së Hasit"*, - shkruan Juriseviçi.

Ne që e kemi njohur pjesën më të madhe të komandantëve të UÇK-s, të gjithë personat ushtarakë të Divizionit ushtarak të Kukësit të asaj kohe, eprorët ushtarakë që kanë bashkëpunuar ngushtë në terren me komandantët dhe ushtarët e UÇK-s, nuk e mbajnë mend "*komandantin*

Ajvet Misini" të Juriseviçit në Helshan. Të gjithë eprorët dhe specialistët e Divizionit të Kukësit që kanë ndihmuar në trajnimin dhe përgatitjen e ushtarëve të UÇK-s dhe që kanë qëndruar pranë njëri-tjetrit në çdo moment nuk e mbajnë mend atë "*komandant*" të Juriseviçit!

Këtë shpifje të tij e hedh poshtë me neveri edhe Uk Lushi, ish zëdhënësi i batalionit "*Atlantik*" në Helshan në kohën e luftës. Ky luftëtar thotë se "*nuk kemi pasur komandant të kampit Ajvet Misinin*". Madje e sfidon Juriseviçin kur në reagimin e tij shkruan: "*Kam qenë në Helshan pikërisht kur dr. Juriseviçi flet për këto takime, por unë nuk mbaj mend dhe e sfidoj mjekun nga Australia dhe këdo të më gjejë dy persona me këto emra që Juriseviçi thotë se kanë qenë komandantë të UÇK-s dhe përgjegjës për rekrutët*". Uk Lushi hedh poshtë edhe "*komandant Hysni Hoxhën*" sepse nuk ka pasë realisht në Helshan një person me një emër të tillë. Kjo është safi shpikje e Juriseviçit. Nuk po e kuptojmë pse "*komandantit*" Ajvet Misinin (bisedë që nuk është zhvilluar kurrë) i thotë se gjithnjë nëpërmjet përkthimit të Hoxhës, ky i fundit (Hoxha) i thotë se "*Komandanti e bëri një shaka. Thotë se do të jeni spiun serb, Craig, me mbiemrin që keni, Juriseviç*". Por kjo "*shaka*" e bren nga brenda sepse dyshimin për serb e ka hasur kudo që kur zbriti në tokën shqiptare që kur erdhi në Kukës. Që kur hyri në spitalin e Kukësit, që kur u takua me njerëzit e thjeshtë, që kur mori kontakt me UÇK-në, sepse të gjithë pa asnjë përjashtim e dyshuan për serb. Dhe dyshimet të cilat atëhere ishin të arsyeshme, sot pas kujtimeve në paçavurë janë plotësisht të vërtetuara; fatkeqësisht shumë vonë. Megjithëse ndihej ngushtë kur në takimet me njerëzit e dyshonin për serb Juriseviçi "*çuditërisht*" e kishte shpjegimin dhe sqarimin e duhur *"tepër të saktë*" sepse thoshte se "*nuk jam serb, nuk jam spiun, jam mik*" (!). Dhe kaq i mjaftonte ta besonin të gjithë. Ky "*besim*" e kishte një bazë pasi që

Juriseviçi takohej me ato që i planifikonte, bisedonte me ato që ia planifikonin, punonte me ato që jo vetëm i besonin por që edhe i besonte në informatat aq të domosdoshme dhe jetike në funksion të zbatimit të misionit të tij se "*shqiptarët janë më të këqij se serbët*"!. S'kishte si të ndodhte ndryshe që në "kujtimet" për takimin me "*komandantin*" e UÇK-s duke shkruar më tej që "*komandanti*" ia përcjell me anë të përkthyesit: "*Komandanti e di që jeni mik i Kosovës. Ka dëgjuar për trimërinë tuaj dhe shërbimin tuaj të madh që u keni bërë pacientëve në spital dhe se është i impresionuar me shpejtësinë me të cilën po e mëson shqipen*"! Me një shpjegim të thjeshtë Juriseviçi e ka të vështirë të na bindë se komandanti (megjithëse i shpikur nga vete ai) i beson aq shpejt. Gjithashtu jemi të prirë ta dëgjojmë atë që thotë sepse edhe komandanti që thotë ato fjalë është i Juriseviçit. Edhe fjalët që ai i thotë janë të Juriseviçit. Asgjë të vërtetë nuk ka, veçse trillime të paskrupullta.

Nuk po e kuptojmë bash mirë shprehjen e komandantit të Juriseviçit se "*po e mëson shpejt shqipen*"! Duket qartë se Juriseviçit i bën "*bishti hije*" pavarësisht se të gjitha i "*rregullon*" vetë duke hasur vështirësi serioze në realizimin e mëtejshëm të misionit të tij misterioz! Për një njeri që ka ardhur nga Adelajda e Australisë së largët, fiks para 29 ditësh (28 prill 1999 deri më 27 maj 1999) as një ditë më pak e asnjë ditë më shumë, avancimi i shpejtë në mësimin e gjuhës shqipe nuk është dyshim i vogël dhe i parëndësishëm. Është një dyshim shumë i arsyeshëm se "*Juriseviçi australian*" fsheh brenda vetes së tij njeriun me origjinë rajonale ballkanike. Fsheh misionin e djallit…






To Dr Hasie,

Thankyou for allowing us to work with you.

Our best wishes for the future.

love Theresa and Leena.

Epilog

Si mjek pediatër, dua t'i shkruaj disa faqe edhe për shërbimin e pediatrisë për periudhën 27 mars deri në 12 qershor 1999. Kam filluar punë në spitalin e Kukësit me 3 janar 1971 dhe punoj edhe sot pa asnjë ndërprerje me përjashtim të viteve 1980-1983 ku kam kryer detyrën e Shefit të Seksionit të Shëndetësisë të rrethit Kukësit. Kuptohet kam punuar dhe në periudhën e eksodit të vitit 1999 kur shqiptarët e Kosovës masivisht u dëbuan me dhunë nga trojet etnike shqiptare dhe kaluan kufirin e dhunshëm shqiptaro-shqiptar për t'u vendosur në Republikën e Shqipërisë. Pa e zgjatur, mjekët, infermierët dhe i gjithë personeli i Pavijonit të Pediatrisë që e lexuan paçavurën e Jurisençit, njëzëri mendojnë se ai është jo vetëm një gënjeshtar pa kufi, por është një i sëmurë mendor me haluçinacione. Është një inatçor i neveritshëm, njeriu me shpirt të zi. Me një fjalë është misionari i djallit, apo më mirë vetë ai.

Pavijoni i Pediatrisë i spitalit të Kukësit në periudhën 27 mars-12 qershor 1999 ka përballuar një ngarkesë pune të jashtëzakonshme, pothuajse të paimagjinueshme. Pavijoni me kapacitet 60 shtretër, i mjaftueshëm vetëm për ngarkesën e zakonshme të planifikuar për numrin e popullsisë që mbulon sipas normave të caktuara, u detyrua të shtronte e të mjekonte një numër dy-tre fish fëmijësh të sëmurë më shumë në të njëjtin mjedis, në të njëjtën hapësirë duke shtuar numrin e shtretërve dhe numrin e personelit të shërbimit dhe pajisur me shtretër, me rroba shtesë, me ilaçe e me materiale mjekimi shtesë nga shteti shqiptar si dhe nga ndihmat dhe kontributi i bashkësisë ndërkombëtare që në atë kohë (sidomos pas muajit të parë të krizës, kur dhe rezervat e spitalit u mbaruan) ishin faktorë shumë të rëndësishëm për

përballimin me sukses të shërbimit mjekësor për fëmijët e sëmurë që shtroheshin në atë kohë në Pavijonin e Pediatrisë.

Kemi pasur dhe dy kolege mjeke pediatre të ardhura nga Anglia që kanë punuar me ne duke dhënë një ndihmesë të çmuar në përballimin me sukses të asaj situate tejet të vështirë. Ato quheshin, njëra Tereza, ndërsa tjetra Lena. Ne i kujtojmë e do t'i kujtojmë me respekt gjithnjë mjekët e vërteta për nivelin e lartë profesional për disiplinën e rreptë profesionale dhe zbatimin e përpiktë të Betimit të Hipokratit. Ne mjekët e pediatrisë patëm me to marrëdhënie mjaft të mira e korrekte në të mirë të punës duke kombinuar përvojën e shkëlqyer të mjedisit cilësor ku ata punojnë në Angli, me përvojën më të gjatë praktike tonën si pediatër, por me kushte më të vështira dhe mangësi të dukshme në pajisje dhe aparatura. Ato vlerësonin me pikë maksimale përkushtimin e mjekëve dhe infermiereve tona në shërbim të fëmijëve të shtruar në pavijon, kurse ne vlerësonim tek ata disiplinën dhe korrektësinë e veçantë profesionale. Në shenjë respekti për moshën shpesh më thërrisnin "*mjeshtër*", ndërsa unë e kundërshtoja atë "*titull*". Ato një ditë më thanë se të respektojmë për moshën dhe përvojën praktike si pediatër, përvojë që e shohim dhe e prekim çdo ditë. Njëra prej tyre më tha një ditë se e kishte ndihmuar shumë këshilla ime për të diagnostifikuar e mjekuar një fëmijë që ato e kishin të shtruar në spitalin e EBA (Emiratet e Bashkuara Arabe).

Pat ndodhur kështu: Duke u konsultuar dhe diskutuar për rastet më të komplikuara në pavijonin e Pediatrisë, dy kolegët anglezë na treguan për rastin e një fëmije kosovar që ishte shtruar në spitalin e Kampit të EBA (një spital modern fushor me aparatura të fjalës së fundit). Fëmija ishte një djalë 8-vjeçar dhe ishte shtruar katër ditë më parë me temperaturë 39-40 C, me dhimbje fyti, vështirësi e dhimbje në gëlltitje, dobësi e dhimbje të lehta të kyçeve. Nga historiku i sëmundjes dilte se fëmija kishte pasur temperaturë dhe

dhimbje fyti edhe një muaj më parë, por qe mjekuar në shtëpi për disa ditë dhe ishte bërë më mirë.

Pas fillimit të mjekimit me antibiotikë gjendja e fëmijës u përmirësua, temperatura ju normalizua, dhimbje fyti e kyçesh nuk kishte më dhe pas shtatë ditë mjekimi u mendua të dilte nga spitali. Por të nesërmen atij fëmije iu shfaqën disa shenja të reja; bënte lëvizje të pakoordinuara të pavullnetshme të këmbëve dhe duarve, nuk e mbante mirë ekuilibrin e trupit dhe ishte më pak i përqendruar. Prandaj u desh përsëritja e analizave dhe ekzaminimeve për të vlerësuar gjendjen dhe për të përcaktuar mjekimin e mëtejshëm të fëmijës.

Unë nga përvoja e mëhershme si pediatër, kur punoja me kolegë më të vjetër mendova se rasti në fjalë mund të dyshohej si Korea Minor (një sëmundje me origjinë reumatizmale që kryesisht shfaqet në cerebelumin apo trurin e vogël). Në fakt ne kishim diganostifikuar e mjekuar dy raste me diagnozë Korea Minor, një rast në vitin 1973 (në spitalin e Kukësit të vjetër) dhe një rast në vitin 1975 (në spitalin e Kukësit të ri në pavijonin ku jemi sot). Për hir të kësaj përvoje u rekomandova dy kolegëve anglezë që fëmijën (që ishte në klasë të dytë) ta vinin të shkruante në një fletore me vija për të parë nëse ai do të shkruante drejt (sipas vizave) apo ka tendencë të shkruajë nga poshtë lart. Theksova se kjo e dyta (tendenca e shkrimit nga poshtë lart) është një shenjë mjaft e rëndësishme klinike për të diagnostifikuar një Korea Minor.

Koleget e nderuara menjëherë shkuan tek kampi i EBA dhe i thanë fëmijës të shkruante në fletore me vija dhe rezultati ishte pak a shumë siç po mundohem ta shkruaj më poshtë:



Kjo mënyrë e të shkuarit bëhej pavarësisht kujdesit që fëmija të shkruante drejt, bëhej në mënyrë të pavullnetshme. Kjo është një dukuri që në mjekësi quhet shenjë ose simptomë patagnomonike që në shqip do të thotë se kjo simptomë apo shenjë që konstatohet flet për diagnozë pothuajse të sigurt për Korea Minor.

Të nesërmen kur erdhën në Pavionin tonë dy koleget ishin të bindura se fëmija vuante nga sëmundja Korea Minor. Analizat e përsëritur laboratorike kishin folur qartë për ndryshime reumatizmale në organizmin e fëmijës. Jo vetëm ky rast por edhe mjaft raste të tjera na lidhën më shumë në punën tonë të përbashkët në shërbim të fëmijëve të sëmurë nëpërmjet këmbimit të përvojës midis nesh. Me të drejtë ky komunikim profesional është një mënyrë mjaft efikase dhe e pakushtueshme për të rritur përgatitjen profesionale të mjekëve. Mjafton vetëm mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe respekti reciprok midis tyre. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ynë më koleget pediatre në dobi të punës ishte mirëfilli mjekësor, teknik dhe profesional midis mjekësh të kualifikuar e të specializuar në këtë drejtim mjekësor. E themi midis mjekësh (atë mirëkuptim e bashkëpunim), e themi me theks, sepse dy javë më vonë, koleget angleze na thanë se nesër do ta vizitonte pavijonin e pediatrisë "*shefi i madh i IMC-s*", njëkohësisht për të na përgëzuar e falënderuar për punën e mirë dhe bashkëpunimin e kënaqshëm me mjekët e ekipit të tij. Të nesërmen "*shefi i madh*" erdhi e vizitoi pavijonin e pediatrisë dhe në fund na ftoi për kafe e për të shkëmbyer mendime.

Riad Paçarizi

U ulëm në kafen e Bujarit, në mjedisin e jashtëm të lokalit. Ishim tetë vetë, zotëria me përkthyesen e tij, dy mjeket angleze, tre mjekët e pavijonit tonë dhe përkthyesja e kolegeve angleze. Gjatë bisedës së lirë për punën dhe vështirësitë që i kishim, "*shefi i madh*" papritur e kaloi cakun e bisedës profesionale midis mjekësh dhe më pyeti mua (siç ma përktheu përkthyesja nga Gjakova). Ai mu drejtua se a mendoni ju se mund të ketë luftë midis Shqipërisë dhe Serbisë? Unë jo vetëm u befasova nga ajo pyetje, por të them të drejtën as nuk e prisja kurrë një pyetje të tillë që ishte jashtë kontekstit! U ndjeva pak ngushtë që t'i përgjigjesha menjëherë atij zotërisë dhe për të fituar pak kohë që të

mendohem i thashë përkthyeses të ma përsërisë edhe një herë pyetjen sepse nuk e kuptova aq mirë duke e mbledhur veten. Mbaj mend i dhashë këtë përgjigje: Unë jam mjek pediatër dhe për 28 vite të punës në këtë spital kam vizituar, shtruar dhe mjekuar vetëm fëmijë. Gjatë kësaj kohe jam marrë edhe me nënat e tyre, sepse në Kukës e kemi një zakon jo të mirë, vërtetë jo të mirë, më shumë për fëmijët kujdesen nënat, më pak baballarët. Pra unë po çuditem që ju zotëri po ma bëni mua këtë pyetje "*luftarake*" mua që nuk merrem me luftën, që e urrej luftën, që merrem vetëm me fëmijët të cilët fjalën luftë nuk e kanë mësuar akoma. Kaluan vetëm disa çaste dhe "*shefi i madh*", që siç duket nuk e priste këtë përgjigje kërkoi leje të largohet sepse kishte një varg punësh për të bërë. "*Shefi i madh*" u largua e ne pas kafes u kthyem në punë duke vazhduar si gjithnjë me përkushtim e me këmbëngulje. Shpirti njerëzor është i njëjtë kudo në botë, nuk njeh shtete, nuk njeh kombe, nuk mund të pengohet as nga largësia e as nga kufijtë.

Një ditë në mëngjes unë u vonova disa minuta për në punë dhe dy koleget angleze ishin interesua të dinin se cili ishte shkaku. Kur u futa në dhomën e mjekut, ato u ngritën në këmbë dhe përshëndetën si çdo ditë.

Fillimisht bëmë vizitën e fëmijëve dhe konsultat e nevojshme pastaj pasi plotësuam kartelat filluam bisedën e lirë mes nesh. U thashë se në shtëpinë time, apartament me 3 dhoma e 1 kuzhinë në katin e katërt të një pallati në qendër të Kukësit që nga dita e parë e eksodit (27 mars 1999 e në vazhdim banojnë 46 të dëbuar shqiptarë të Kosovës. Familja ime përbëhet nga pesë persona: unë, gruaja ime (infermiere), djali Admiri (26 vjeç), vajza e madhe Edlira (21vjeçe) dhe vajza e vogël Delina (14 vjeç). Dy fëmijët e mëdhenj (Admiri e Edlira) janë në Tiranë se studiojnë, djali elektrike dhe vajza gazetari, ndërsa vajza e vogël është nxënëse në klasën e tetë të shkollës "*Bajram Curri*" të qytetit të Kukësit.

Meqenëse familja jonë i ka marrë dhe i ka strehuar me dëshirën e saj 46 shqiptarët e Kosovës jemi të shtrënguar dhe pak në vështirësi, pasi më e keqja është se njëri prej tyre (Rasim Mema nga Zhuri) vuan nga një sëmundje e rëndë dhe ka nevojë për mjekime dhe shërbime të vazhdueshme të cilat ia bëjmë në shtëpi deri më tani. Sot në mëngjes u konsultova me një kolegun tim patolog, prandaj dhe u vonuam për në punë. Besoj se më falet ajo vonesë e vogël sepse kemi detyrime morale, njerëzore dhe profesionale për të gjithë pa asnjë përjashtim e në veçanti për ata njerëz që i kemi në banesë dhe jetojnë me ne.

"*Mjeshtër*" më thonë pothuajse njëkohësisht të dyja koleget angleze dhe u ngritën në këmbë: "*Ju shqiptarët jeni një komb tejet i veçantë në botë. S'gjen askund si ju. Vetëm ju shqiptarët po e bëni këtë sakrificë, po bëni atë që asnjë popull në botë nuk e ka bërë*" - tha Tereza për të vazhduar me Lenën që thotë se "*e gjithë bota i ka kthyer sytë nga Kukësi e nga Shqipëria, shembull humanizmi dhe bujarie të jashtëzakonshme që me një populsi 20 mijë banorë po strehon, po ushqen dhe po shërben për një populsi të ardhur që është mbi pesë herë më e madhe*". Duke vazhduar bisedën unë ju them se shqiptarët janë një nga popujt më të lashtë të Evropës dhe jo vetëm kaq por shqiptarët kanë mbrojtur vetë Europën nga pushtimi osman, sepse në krye kishin legjendarin Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. E sot në nderin e shqiptarëve është mbrojtja e jetës njerëzore, të cilën e vlerësojnë më shumë se çdo gjë sepse Zoti ia ka dhënë jetën njeriut.

Një kontribut të padiskutueshëm në mbrojtjen e jetës njerëzore po jep edhe spitali i Kukësit që me sakrifica të jashtëzakonshme, me ndërgjegje të lartë e me përkushtim të pamatë të mjekëve, të infermierëve, të gjithë punonjësve dhe stafit drejtues po përballon me sukses të plotë një ngarkesë të paimagjinueshme në këta kushte aspak të favorshme duke

fituar admirimin dhe respektin e të gjithë botës, e cila po jep ndihmën e vet të çmuar në forca njerëzore (siç jeni dhe ju kolege të nderuara), me pajisje të aparaturave në shërbim të sëmurëve, me ilaçe e materiale të nevojshme mjekimi duke dhënë kontribut të rëndësishëm në përballimin e situatës paradoksale që kanë krijuar fashistët modernë serbë në fund të shekullin e XX.

Kanë kaluar më shumë se 13 vjet që shqiptarët e Kosovës të dëbuar më dhunë nga trojet e tyre etnike tashmë janë kthyer në shtëpitë e tyre dhe jetojnë të lirë falë luftës çlirimtare të UÇK-së, ndihmës së botës demokratike dhe NATO-s që shpartalluan ushtrinë serbe dhe e çliruan Kosovën nga pushtimi serb. Edhe familja e Rruzhdi Paçarizit atëherë u kthye në shtëpinë e saj në Dragobil të Komunës së Malishevës (më vonë se familjet e tjera sepse shtëpinë ia kishin djegur). Sot ajo familje jeton e lirë në shtëpinë e rindërtuar në fshatin Dragobil së bashku me bashkëfshatarët e tjerë. Ne jemi të lidhur me këtë familje shqiptare të Kosovës që më 21 prill 1999 kur fëmija i tyre i vogël vetëm tri muajsh u shtua në Pavijonin e Pediatrisë të Spitalit të Kukësit në gjendje shumë të rëndë shëndetësore (si dhe shumë të tjerë në atë periudhë).

Me 14 korrik 2012, ditë e shtunë së bashku me një gazetar të televizionit të Kukësit, u nisëm nga Kukësi për të vizituar familjen e Rruzhdi Paçarizit në fshatin Dragobil të komunës së Malishevës në Republikën e Kosovës. Kemi ardhur në këtë familje të takojmë Riadin, një fëmijë që për mua është shumë i veçantë dhe takimi me të pas 13 vjetësh më jep emocione të jashtëzakonshme.

Po kush është Riadi? Është fëmija shqiptar i Kosovës që në vitin 1999, sikurse rreth një milion shqiptarë të tjerë u dëbua me dhunë nga trojet e tij etnike në Dragobil të Malishevës së bashku me familjarët e tij (gjyshin, gjyshen, nënën, motrat dhe vëllanë e tij më të madh) kaluan kufirin e

dhunshëm shqiptaro-shqiptar për të arritur në Kukës me 21 prill 1999. Rrugës për në Kukës Riadi i vogël u sëmurë rëndë dhe kur arriti në Kukës (në orën 01 të natës) me ndihmën e disa vullnetarëve të Kryqit të Kuq Shqiptar u dërgua menjëherë në spital së bashku me nënën e tij. Ndërsa familjarët e tjerë u strehuan në zyrën e përgjegjësit të shërbimeve komunale nga vetë përgjegjësi Qemal Sinamati. Menjëherë fëmijën e sëmurë e sjellin në Pavijonin e pediatrisë (në katin e tretë të spitalit) dhe e shtrojmë. Unë në atë kohë isha në pavijon dhe e vizitova, e diagnostikova dhe i filluam mjekimin e shpejtë me oksigjen. Në atë periudhë mjekët e Kukësit, për arsyje shërbimi ishin "*banorë*" të spitalit, sepse ishin gjatë gjithë kohës në spital.

Fëmija u vendos në dhomën e veçantë dhe i filluam mjekimin intravenoz. U kontrollua gjendja e tij në vazhdimësi. Disa herë është aspiruar për t'i thithur sekrecionet që ia vështirësonin frymëmarrjen seriozisht. U caktua një infermiere në shërbim vetëm të atij fëmije, pasi gjendja e tij ishte shumë e rëndë dhe jeta e tij ishte seriozisht e rrezikuar. Oksigjeni i herëpashershëm, aspirimi i sekrecioneve në rrugët e frymëmarrjes si dhe mjekimi i shpejtë e në kohë i fëmijës e përmirësuan gjendjen e tij. Temperatura iu ul në shifra rreth normales u normalizua ngjyra e buzëve dhe e lëkurës. Iu qetësua relativisht edhe frymëmarrja dhe rreth orës 9 e 30 minuta fëmija filloi të merrte pak gjirin e nënës që nuk e kishte marrë që nga pasditja e djeshme. Personeli u kujdes në veçanti edhe për nënën e fëmijës që ishte jo vetëm e lodhur por edhe frikësuar, e stresuar për jetën e fëmijës së saj. Pas orës dhjetë kur fëmija na u duk relativisht i stabilizuar së bashku me Lemen (nënën e fëmijës) dolëm nga spitali në qytet dhe i gjetëm familjarët e saj në zyrën e Qemal Sinamatit, zyrën e shërbimeve komunale të Bashkisë, i cili i strehoi dy ditë (të shtunë e të dielë) dhe të hënën në mëngjes unë me një furgon

i dërgova në fshatin Nangë (10 km nga Kukësi) në shtëpinë e nipit tonë Haxhi Shehu ku qëndruan derisa Riadi i vogël doli nga spitali i Kukësit dhe së bashku me familjarët e tij u nis për në Tiranë me një furgon të sigurt. Në Tiranë qëndruan derisa u kthyen përsëri në Kosovë (pas mbarimit të luftës) në shtëpinë në Dragobil ku sot ka hapur dyert për të na pritur.

Na pritën në shtëpi nëna e Riadit, kunata e saj, kunati (vëllai i Rruzhdiut), motra e Riadit. Ndërsa Rruzhdiu babai i Riadit na doli përpara me makinën e tij e na priti që në hyrje të fshatit për të na shoqëruar për në shtëpi. Takim mes vëllezërish e motrash. Takim mes shqiptarësh plot gëzim e plot emocione! Duke na uruar mirëseardhjen Rruzhdiu na prezantoi me të gjithë pranishmit. Na njohu me vëllanë që jetonte e punonte në Zvicër së bashku me bashkëshorten të cilët kishin ardhur për pushime në Kosovë. Me vajzat, me djalin e madh, me të gjithë... Por unë po prisja të shihja "*Riadin tri muajsh*" sepse kaq të vogël e kisha përcjellë ndërsa më vonë se kisha parë më. Gazetari i televizionit të Kukësit foli për qëllimin e vizitës tonë në familjen Paçarizi, ndërsa ata na falënderuan ne për kujdesin dhe interesimin tonë për djalin e tyre, për Riadin 13 vjeçar që akoma nuk po e shihnim, megjithëse kishin kaluar shumë minuta që kur kishim hyrë brenda në shtëpinë e tij. Gjatë bisedës për eksodin e vitit 1999, në momentin kur po fliste Lemja (nëna Riadit) u hap dera dhe në dhomë hyri një djalosh i vërtetë, me trup të fuqishëm, me flokë të qethur shkurt, me fytyrë gjithë gëzim. Na përshëndeti me radhë mua dhe gazetarin që kisha me vete. Ky ishte Riadi, Riad Paçarizi! Kishte qenë me shokët në Malishevë, prandaj e takuam të fundit.

Kur u fut në dhomë, pasi na hodhi shikimin me një shenjë që i bëri nëna e tij menjëherë mu hodh në qafë duke më shtrënguar fort. Më uroi mirëseardhjen dhe më falënderoi për kujdesin që kisha treguar për shëndetin e tij kur kishte qenë në spitalin e Kukësit. Nëna më ka thënë se jetën e kam

prej jush, nëna m'i ka thënë të gjitha çfarë keni bërë ju dr. Misini dhe gjithë personeli i pavionit të pediatrisë. Ju faleminderit ju dr. Misini. Ju faleminderit gjithë punonjësve të pavijonit të pediatrisë. Nëna më ka thënë se jetën e kam prej jush. Ju faleminderit edhe një herë, na falënderonte i emocionuar djali. E përqafoi gazetarin dhe u ul pranë nënës së tij, e cila vazhdoi të tregonte për tragjedinë e vitit 1999, ngjarjen më të rëndë qe kishte përjetuar në jetën e vet dhe herë pas here i rridhnin lotët. Por nuk ishin lot hidhërimi. Sot vërtetë i rridhnin lot, por ishin lot të një gëzimi të pamatë.

E kur kamera e gazetarit ishte drejtuar nga Lemja ajo me lot në sy tha: ndoshta nuk mund të shprehem siç ma do zemra dhe shpirti se jam shumë e emocionuar sot, por disa fjalë zemre e shpirti të një nënë shqiptare për të falënderuar dr. Misinin dhe gjithë punonjësit e pavijonit të pediatrisë të spitalit të Kukësit për kontributin e tyre për shpëtimin e jetës së djalit tim Riadit, tremuajsh në vitin 1999 që sot e kam 13 vjeç do t'i them. Unë, nëna e Riadit, ju uroj nga zemra të gjithëve. Jetë të gjatë dhe të lumtur në familjet e tyre dhe i përshëndes të gjithë pa asnjë dallim të gjithë punonjësit e spitalit të Kukësit. Jo vetëm ata por edhe të gjithë vëllezërit dhe motrat e Kukësit, të gjithë shqiptarët ku jetojnë e punojnë. Ju faleminderit dr. Misin! Përshëndes nga zemra dr. Bedrie Axhamin, dr. Hasije Zenelin dhe dr. Nikolin Martinin. Ju faleminderit punonjësve të pavijonit të pediatrisë, suksese në punën tuaj humanitare. Fjalë falënderimi tha edhe Rruzhdiu, babai i Riadit i cili në atë kohë ishte i punësuar në Slloveni dhe i kishte humbur lidhjet me familjarët në Kukës, por që më vonë arriti të komunikonte dhe të informohej për gjendjen shëndetësore të Riadit dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes. Ai tha: "*Ne shqiptarët kemi solidaritet mes vedi, e ndihmojmë njëri-tjetrin si askush tjetër në kohë të vështira. Faleminderit me gjithë zemër*". Edhe vëllai i Rruzhdiut na falënderoi ne që

ishim aty, falënderoi gjithë punonjësit e spitalit të Kukësit për atë që kanë bërë në shërbim të vëllezërve shqiptarë të Kosovës në vitin 1999. Në këtë atmosferë falënderimesh, ndërhyra e thashë se ne populli i Kukësit kemi kryer vetëm detyrën. Nuk kemi bërë asgjë më tepër se detyrën në 1999. Vëllai i Rruzhdiut menjëherë na e ktheu se është e vërtetë se ju keni kryer detyrën, por keni kryer një detyrë tejet të vështirë në kushte dhe rrethana tejet të vështira që jo gjithkush ka arritur ta kryej me sukses të plotë si Kukësi. Riadi u ngrit në këmbë, m'u afrua, më përqafoi dhe një herë fort e më tha: "*E shikon o doktor, jam rritur e jam bërë pothuajse sa ti*". Dhe unë kënaqem pafundësisht duke parë nga gazetari, i cili na fiksoi në aparatin e tij fotografik dhe rrugës për në Kukës më tha: kur e pashë Riadin që u përqafua me ty, të them të drejtën u gëzova pa masë, ai ishte rritur e zhvilluar aq sa të "*hahej*" me ty.

Rrugës ndërsa po ktheheshim përsëri më shkoi mendja te paçavurja e Juriseviçit…

Sa antinjerëzor dhe i pashpirt!

Sa antishqiptar!

Ptuuu, misionar i djallit! Në ferr vafsh…!

Në vend të pasthënies

Të reagosh drejt do të thotë të ruash vlerat që përcaktojnë qenien kombëtare

Diku nga muaji janar apo shkurt i vitit 2012, mora vesh se një mjek australian me origjinë nga Sllovenia me emrin Craig Juriseviç ka shkruar një libër kujtimesh me titullin "*Duart e përgjakura, kirurgu në luftë*" (Blood On My Hands: A Surgeon At War) i botuar nga fundi i vitit 2009 apo fillimi i vitit 2010 në Melburn të Australisë nga enti botues Wild Dingo Press, kurrë nuk më shkoi mendja te një farë burri bjond nga ky vend i largët i para 13 vjetëve që kërkoi të realizonte një intervistë në mikrofonin e radio Kukësit ishte autori. Deri në atë bisedë me doktorin asnjë dijeni nuk kisha se qenka botuar një libër për atë periudhë prej një australiani i ardhur nga "*prapa diellit*" dhe që ai me të gjitha mënyrat e kishte denigruar jo vetëm luftën e drejtë të luftëtarëve tanë të lirisë, por edhe kishte përbaltosë popullin shqiptar.

Para se të gjej librin me kujtime lexova gjithçka në internet rreth këtij libri dhe autorit. I brishtë, delikat, i ndrojtur, frikacak. Këto janë cilësitë që ai pat transmetuar në pamjen e pare tek ata pak njerëz me të cilët ka pasur "*fatin*" të takohet me ta. Një farë tipi i ngjashëm me personazhin komik të Sandër Mafishes te komedia "*Pallati 176*". Duke hulumtuar rreth këtij individi dhe kujtimeve të botuara në shqip te enti botues "*Koha*" në Prishtinë, më çuditi fakti se si reagimet e para mediatike shqip në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni kanë qenë pozitive për këtë libër. Një intervistë në "*Zhurnal Plus*" të Shkupit realizuar nga Rozafa Kelmendi më 26 janar 2010. Pas një muaji në New York (23 shkurt 2010) në revistën shqiptare "*Ilyria*" botohet një shënim me

titullin "*Një film në Holliwod kushtuar UÇK-s*" ku opinioni sqarohet se mbi bazën e këtij libri të shkruar nga Crajg Juriseviç në bashkëpunim me Robert Hillman do të realizohet një film. Madje përmendet edhe aktori që do të luaj rolin kryesor, Sam Worthington që është bërë i famshëm në filmin "*Avatar*", "*Clash of the Titous*" dhe "*Terminador salvation*". Duke vënë re disa artikuj të përciptë dhe pa pasur bazën elementare të njohjes për librin dhe autorin arrita në një fakt të tmerrshëm: mjerisht nga disa gazetarë e publicistë shkruhen artikuj pa njohur materialin apo personin për të cilin flasin. Po nejse, temë tjetër kjo.

Ata që e lexuan me vëmendje librin e autorit kuptuan gjithçka. Kuptuan djallëzinë e tij, qëllimin ogurzi, helmin që përmes një gjuhe të rëndomtë joartistike e jopublicistike kishte hedh, nëpërkëmbjen e zhvlerësimin për këtë epokë të lavdishme të popullit shqiptar dhe për përpjekjet titanike të popullit shqiptar në përballimin e kësaj situate tragjike. Uk Lushi, një luftëtar i pari. Pastaj të tjerë, Besim Muhadri, Behaudin Murati, Ibrahim Hajdarmataj etj.

Por për tu ndalë seriozisht e imtësisht mirë në zbërthimin e librit bazuar në dokumentacion autentik e dëshmi reale është dr. Misin Braha. Ky mjek pediatër shumë i respektuar për humanitetin e tij dhe përvojën e gjatë, realisht ka shteruar pothuajse gjithçka për çka trillon Juriseviçi në librin e tij me kujtime.

Libri i Juriseviçit vërtet është një "*paqavure*" si e quan shpesh autori Misin Braha. Ai vërtet është misionari i djallit. Është i tillë se nga faqja e parë deri kur e mbyll këtë libër nuk ka asgjë të vërtetë. Madje përtej kësaj të pavërtete ka shumë keqdashje e ligësi. Për të arritur synimin e vet autori i paçavures është i paskrupullt; nga skutat e errëta të egërsisë njerëzore buron gjithçka e lig. Gënjen, mashtron, fantazon duke e bërë librin e tij një krijim që i përket një

gjinie krejt të veçantë e specifike që e ka "*shpikur*" vetëm Juriseviçi.

Autori siç apostrofuam më lart aspiron që libri të jetë bazë skenari filmi që ëndërron të luhet prej aktorëve të Holliwudit. Kjo ëndërr e nxit që të jetë i pandalshëm në të pavërtetat që publikon, në shtrembërimin e realitetit, në nxirjen e çdo veprimtarie e përpjekje të popullit shqiptar për të përballuar këtë situatë tragjike dhe për të mbijetuar.

Kështu ky libër-skenar që pas leximit të duket sikur je zgjuar pas një ëndrre të keqe, të lë ndjesinë se autori është ashtu si thotë dr. Misin Braha: jo një mjek, por misionari i djallit, jo një mik, por e kundërta e tij për popullit shqiptar e njerëzit e tij të mirë, jo një human, por një sadist që ka dëshirë të shohë vetëm vuajtje, rënkime, klithma, trupa të kalbur, krahë e koka të prera… Shkurt është ndjellës i vdekjes. Sidomos i vdekjeve të fëmijëve! O zot, çfarë mjeku!

Juriseviçi vërtet ka për mision të arrijë në një pikë; në atë "*që shqiptarët janë më të këqij se serbët!*" Pikërisht këtë fjali dr. Misin Braha qëllimisht e kthen në lajtmotiv të librit prej fillimit e deri në fund. Ashtu sikurse në lajtmotiv e ngre edhe togfjalëshin "*misionari i djallit*" që e ka vënë edhe për titull të librit.

Për Juriseviçin shqiptarët janë njerëz të pacivilizuar kur flet për kulturën, mënyrën e sjelljes, të konceptuarit e jetës, marrëdhëniet me të tjerët etj. Serbët në konceptin e tij janë shumë më të mirë. As në rastin e parë dhe as në të dytin nuk e fakton autori. Nuk jep argumente. Mungojnë faktet. Lind pyetja elementare: ç'dreq libri kujtimesh a libri historik është ky kur i mungojnë komponentët kryesorë!? Sa herë kur ai flet për shqiptarët të duket sikur shtrëngon dhëmbët, prish fytyrën dhe kalon në një gjendje urrejtje dhe anormaliteti. Sepse qëllimi dhe misioni i tij është i tillë.

Për Juriseviçin të gjithë shqiptarët janë të deformuar psikologjikisht, të dhunshëm, pijanecë, të pakulturuar,

vrasës. Serbët edhe nëse veprojnë dhunshëm, sipas tij janë të logjikshëm, i kanë detyruar rrethanat e afërsisë me shqiptarët prej të cilëve kanë përjetuar masakrime të herëpashershme (!). Ç'farë dashakeqësie prej kësaj fare mostre!

Për Juriseviçin shqiptarët janë antihumanë. Jo më kot ai në paçavuren e tij vendos në qendër spitalin e Kukësit. Pikërisht institucionin shëndetësor më të rëndësishëm, i cili përballoi me heroizëm këtë situatë tragjike. Unë personalisht që pata fatin të jem gazetar në atë kohë të vranët për shqiptarët di shumë e shumë gjëra. Di edhe atë që mjekë të spitalit të Kukësit si vetë autori, dr. Mustafë Mustafa, dr. Shaqir Shehu, dr. Mark Nufi, dr. Mehmet Hoxha, dr. Rexhë Sefa, dr. Dashnor Lisha etj., nuk kanë shkuar për ditë të tëra në shtëpitë e tyre. Vetëm për t'u qëndruar problemeve të shumta në spital ata këtë institucion shëndetësor e patën shndërruar në shtëpitë e tyre. Gjithkush e lexon këtë libër nuk mund të mos indinjohet për "*pallavrat*" e një mendje të sëmurë e të çekuilibruar si e Juriseviçit. Kush prej kuksianëve, hasjanëve, tropojanëve, kush prej shqiptarëve të dëbuar dhunshëm nga territoret e veta etnike në atë kohë i beson kësaj mendje dhe trillimeve që ajo pjell!? Spitali i mbushur me vrasës, mjekë mafiozë, infermiere të droguara, njerëz të vdekur në korridore, lopë të ngordhura në oborrin e spitalit që e hanë njerëzit si të jenë kafshë xhungle ku mbisundon i pastër ligji i luftës për ekzistencë…Nuk ka se si të shkruhet me kaq urrejtje patologjike, me kaq mllef për një popull e komb që vetëm këto prirje nuk i ka demonstruar kurrë. Kurrë.

Për Juriseviçin shqiptarët nuk janë as luftëtarë. Kujtoni "*praninë*" e tij brenda radhëve të UÇK-s se si e pasqyron gjendjen aty. Mbretëron kaosi, mungesa e rregullit, mungesa e respektit për eprorin e njëri-tjetrin, konfliktet janë të pranishme deri në shkallën ekstreme të eliminimit mes luftëtarëve. Kujtoni se si një ushtar i bindet atij aq

përulësisht sa që i duket si një kone e vogël që i luan bishtin të zotit. Cili luftëtar i lirisë mund ta mbajë këtë ofendim kaq të rëndë sa guri i Sizifit mbi supe? Mirëpo ja që këtë e bën një mjek kirurg anonim, në fakt krejt i parëndësishëm, i panjohur e i pavlerë në atë kohë të rilindjes së shqiptarëve me emrin Juriseviç.

Pa u futur në detaje unë vlerësoj shumë librin reagues të dr. Misin Brahës. Veçoria kryesore dhe më e rëndësishme e tij është fuqia e argumentimit. Si një hulumtues i palodhur që është autori i "*Misionit të djallit*" nuk ka lënë dokument pa parë e studiuar me kujdes, regjistër pa shfletuar, ditar pa kontrolluar, kartelë pa e qëmtuar. Ka shteruar të gjitha faktet konkrete përmes bisedave me dëshmitarë okularë e faktorë konkretë në ngjarje me emra e mbiemra, me data e ditë, me orë e ngjarje. E jo me ngjarje pa emra, pa data, pa njerëz realë, pa situata të ndodhura siç bën autori i librit "*Duart e përgjakura, kirurgu në luftë*".

Misin Braha thamë që është një mjek pediatër, por në librin "*Misioni i djallit*" performon si një polemist racional shumë bindës. Del i tillë se ka në dorë çelësat me të cilin zhvillohet një polemikë e suksesshme: argumentin e faktin. Ai i ka këto, prandaj i rrjedh fjala e bukur dhe e sinqertë, e besueshme dhe mendjembushëse. Edhe emocioni i fjalës (që në libër është e pranishme) në raste të tilla ka funksionin e vet. Si i tillë ky libër është shumë i vlefshëm, një dokument i rëndësishëm që i bën bllok ndërmarrjes së pistë aventureske të një sharlatani. Nga ana tjetër botimi i "*Misionit të djallit*" u ndal turrin edhe sharlatanëve të tjerë të këtij soji që guxojnë të ndërmarrin misione të tjera shpifëse e trilluese, kriminale dhe antishqiptare për të hedhur baltë në përpjekjet tona atdhetare si ajo e fundshekullit të kaluar.

Unë që e kam lexuar me vëmendje librin e Crajg Juriseviçit, por edhe e kam redaktuar fjalë për fjalë librin e dr. Misin Brahës, habitem me një fakt të dhimbshëm gati

apokaliptik: në heshtjen e mjekut Ylber Vata. Si është e mundur që ai thellësisht i nëpërkëmbur dhe i zhvlerësuar, i keqpërdorur deri në maskarallëk prej autorit të qëndrojë kaq indiferent!? Nuk dimë se ç'emër t'i vëmë këtij veprimi. Po ashtu edhe për përkthyesin dhe shoqëruesin e tij. Ata duhet të prononcohen për të mbrojtur veten të paktën, për të ruajtur dinjitetin, moralin dhe qenien e tyre si shqiptarë. Është një detyrim. Të qenit shqiptarë, por edhe kuksianë duhet t'i bëjë të ndjeshëm në këtë rast. T'i vlerësojnë "*të vërtetat*" juriseviçiane dhe të mbrojnë të paktën personalitetin e tyre, e përmes këtij veprimi, të mbrojnë edhe të drejtën e dinjitetin e popullit shqiptar që aq shumë kontribuoi për të përballuar këtë pragkatastrofë njerëzore.

Libri i dr. Misin Brahës është një ndërmarrje dinjitoze në mbrojtje të vlerave humane të popullit shqiptar. Është një reagim atdhetar kundër mohimit të vlerave tona prej njerëzve dashakëqij si Crajg Juriseviçi.

Jemi të sigurt se ky autor nuk është i vetmi. Djalli ka shumë misionarë. Arritjen e qëllimit të vet nuk e mbështet vetëm tek një. Është akt patriotik që i bën nder vendit të vet, popullit të vet, mundit e gjakut të tij. Është respekt i thellë për luftën e popullit shqiptar për lirinë e tij, për të mbrojtur identitetin. Është nderim për luftën e drejtë e heroike që bëri UÇK-ja dhe gjithë luftëtarët e lirisë, përulje e mirënjohje para dëshmorëve të lirisë.

Besim R Cengu

Pasqyra e lëndës

1. Prolog.....5
2. Hyrja.....7
3. Spitali i Kukësit – shtëpia humane e shqiptarëve.....9
4. Misteri i një ardhje të beftë.....12
5. Misioni i turpit.....14
6. Eksploratori humanist.....24
7. "Njohja" me punën në spitalin e Kukësit.....27
8. Tentativë dëshpëruese vetëm për të "nxirë".....36
9. Po cili është realiteti konkret? 50
10. Dita tragjike e 31 majit 1999.....53
11. Aventura e "kirurgut" vazhdon.....62
12. Drejt portës së shpresës – Morinit.....74
13. Skutat e errëta të një shpirti katran.....84
14. Rëndësia e qytetit të Kukësit në tejkalimin e krizës..... 92
15. Komb vital!.....100
16. Nëpërkëmbja e personalitetit.....103
17. Jo vetëm mjek, por edhe "gazetar".....106
8. Rrenat nuk mbarojnë kurrë.....108
19. Frika e ndjek pas….....112
20. Paradokse pa fund.....116
21. Fakte dokumentare.....127
22. Realitetin nuk e luan as topi.....133
23. Çakallit i dalin kthetrat.....139
24. Ndërmarrja e "guximshme" e misionarit të djallit.....143
25. Epilog.....143
26. Në vend të pasthënies.....174